


STUDIM

DALLIMET GJINORE
NË PRINDËRIM
DHE
NDIKIMI I TYRE
NË MARRËDHËNIEN PRIND – FËMIJË,
NË SHQIPËRI



STUDIM

**DALLIMET GJINORE
NË PRINDËRIM
DHE
NDIKIMI I TYRE
NË MARRËDHËNIEN
PRIND – FËMIJË,
NË SHQIPËRI**



Tiranë, dhjetor 2020

Ky studim mbi dallimet gjinore në prindërim dhe ndikimin e tyre në përditshmërinë e marrëdhënieve prind-fëmijë në Shqipëri, u përgatit nga Qendra “ACT for SOCIETY” me mbështetjen e Zyrës së Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë në Shqipëri (UNFPA) në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe koordinim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara, “Për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave”, i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA në partneritet me Qeverinë e Shqipërisë. Opinionet, gjetjet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë vetëm të autoreve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të UNFPA, Agjensive të Kombeve të Bashkuara apo të Qeverisë së Suedisë.

Përgatitën:	Monika Kocaqi, Irida Agolli
Kontribuan:	Elsona Agolli, Armela Pengili, Holta Koci
Koordinatorë:	Nertila Meçani
Rishikuan raportin:	Brunilda Dervishaj, Përgjegjëse e Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Klodiana Thartori, Drejtore Ekzekutive, Qendra Fëmijët Sot, Suada Hawa, Përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Emira Shkurti, Specialiste e Mbrojtjes së Fëmijëve, UNICEF

@ Qendra “ACT for SOCIETY” dhe Zyra e UNFPA-së Shqipëri
Tiranë, Dhjetor 2020

Ndalohet shitja apo përdorimi i këtij studimi për qëllime përfitimi.



TABELA E PËRMBAJTJES

FJALOR I TERMAVE.....	6
DY FJALËPËRPARA HYRJES.....	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	9
I. ROLET GJINORE, DALLIMET GJINORE DHE PRINDËRIMI.....	13
II. METODOLOGJIA	19
III. GJETJET NGA ANALIZA E TË DHËNAVE SASIORE DHE CILËSORE.....	22
<i>III.1. ANALIZA SASIORE.....</i>	<i>22</i>
<i>III.2. ANALIZA CILËSORE.....</i>	<i>51</i>
IV. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET.....	73
V.REFERENCA.....	77
VI.INSTRUMENTETKËRKIMORË.....	78
VI.a Pyetësi për prindërit.....	78
VI.b Pyetësi për fëmijët.....	87
VI.c Guidat e diskutimeve me grupet e fokusuara.....	96

LISTA E GRAFIKËVE DHE TABELAVE

Grafik 1: Ndarja e prindërve dhe fëmijëve sipas gjinisë.....	20
Grafik 2: Ndarja e prindërve sipas grupmoshës.....	20
Grafik 3: Ndarja e fëmijëve sipas grupmoshës.....	21
Grafik 4: Ndarja e prindërve sipas besimit fetar.....	21
Grafik 5: Niveli arsimor i prindërve.....	22
Grafik 6: Ndarja e prindërve sipas punësimit.....	22
Grafik 7: Klasifikimi i statusit të punësimit të nënës dhe babait pas lindjes së fëmijëve, sipas vetë fëmijëve pjesëmarrës në studim.....	23
Grafik 8: Klasifikimi që i bëjnë prindërit e përfshirë në studim statusit ekonomik të famljeve të tyre.....	23
Grafik 9: Klasifikimi që i bëjnë fëmijët e përfshirë në studim statusit ekonomik të familjeve të tyre.....	24
Grafik 10: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e lidhjes/stili autoritativ/demokratik.....	25
Grafik 11: Perceptimi i baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e lidhjes/stili autoritativ/demokratik.....	26
Grafik 12: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e rregullave/stili autoritativ/demokratik.....	27
Grafik 13: Perceptimi i baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e rregullave/stili autoritativ/demokratik.....	28
Grafik 14: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e pavarësisë / stili autoritativ/demokratik.....	29
Grafik 15: Perceptimi i baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e pavarësisë/stili autoritativ/demokratik.....	30
Grafik 16: Perceptimi i fëmijëve mbi sjelljet që karakterizojnë dimensionin e lidhjes së stilit autoritativ/demokratik të prindërve të tyre.....	32
Grafik 17: Perceptimi i fëmijëve mbi sjelljet që karakterizojnë dimensionin e rregullave të stilit autoritativ/demokratik të prindërve të tyre.....	33
Grafik 18: Perceptimi i fëmijëve mbi sjelljet që karakterizojnë dimensionin e pavarësisë së stilit autoritativ/demokratik të prindërve të tyre.....	33
Grafik 19: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e ndëshkimit fizik / stili autoritar.....	34
Grafik 20: Perceptimi i baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e ndëshkimit fizik / stili autoritar.....	35
Grafik 21: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi dimensionin verbal të konfliktit / stili autoritar.....	36
Grafik 22: Perceptimi i baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi dimensionin verbal të konfliktit / stili autoritar.....	37
Grafik 23: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e ndëshkimit pa shpjegim / stili autoritar.....	38

Grafik 24: Perceptimi baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e ndëshkimit pa shpjegim / stili autoritar.....	39
Grafik 25: Perceptimi i fëmijëve mbi sjelljet që karakterizojnë tre dimensionete stilit autoritar të prindërve të tyre.....	40
Grafik 26: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi stilin lejuet/tolerant.....	41
Grafik 27: Perceptimi i baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi stilin lejuet/tolerant.....	42
Grafik 28: Perceptimi i fëmijëve mbi sjelljet që karakterizojnë stilin lejuet/tolerant të prindërve të tyre.....	43
Grafik 29: Perceptimi i djemve për marrëdhëniet me prindërit e tyre.....	44
Grafik 30: Perceptimi i vajzave për marrëdhëniet me prindërit e tyre.....	45

Tabela 1: Përqindja e nënave dhe baballarëve që e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit si autoritativ/demokratik.....	31
Tabela 2: Perceptimi i fëmijëve mbi stilin autoritativ/demokratik që ushtron nëna dhe babai në rritjen e tyre.....	32
Tabela 3: Përqindja e nënave dhe baballarëve që e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit si autoritar.....	39
Tabela 4: Perceptimi i fëmijëve mbi stilin autoritar që ushtron nëna dhe babai në rritjen e tyre.....	40
Tabela 5: Perceptimi i fëmijëve mbi stilin lejuet/tolerant që ushtron nëna dhe babai në rritjen e tyre.....	43
Tabela 6: Përqindja e prindërve klasifikuar sipas stileve të prindërimit që përdorin, bazuar në perceptimet e tyre dhe të fëmijëve të tyre.....	43

FJALOR I TERMAVE

Në përputhje me përkufizimet e dhëna në nenin 3 të Ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, termat e mëposhtëm të përdorur në këtë studim kanë këtë kuptim:

“Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

“Prind” është personi që e ka lindur ose e ka birësuar fëmijën, çift ose i vetëm, i martuar ose jo, apo që ka njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.

“Dhunë ndaj fëmijës” është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.

“Mbrojtje e fëmijës” është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.

“Ndëshkimi trupor” është çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim te fëmija, nga çdo person ligjërisht përgjegjës për fëmijën. Ndëshkimi trupor përfshin forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja, shtytja, djegia, goditja, pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, tërheqja e flokëve, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim, si dhe çdo veprim i ngjashëm me të.

“Neglizhimi i fëmijës” është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, për kujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës.

“Pjesëmarrje e fëmijës” është një proces i vazhdueshëm i përfshirjes aktive të fëmijës dhe i respektimit të së drejtës së tij për t’u shprehur e për t’u dëgjuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për çështje që lidhen me të.

DY FJALËPËR PARA HYRJES...

Të dashur lexuese dhe lexues,

Studimi që keni në duar synon të përcjellë disa gjetje mbi stilet që karakterizojnë prindërimin në Shqipëri dhe mënyrën se si ato përcaktojnë apo ndikojnë në përditshmërinë e marrëdhënieve prind – fëmijë, duke e analizuar këtë marrëdhënie nga këndvështrimi gjinor. Rekomandimet e formulara nga këto gjetje shpresojmë të jenë të vlefshme për t’u konsideruar jo vetëm nga prindërit, por edhe nga institucionet, organizatat e komuniteti në tërësi.

Ndonëse diskutimet për prindërimin, fëmijërinë, apo rëndësinë e përmirësimit të marrëdhënieve prind – fëmijë në përputhje me zhvillimin aktual të shoqërisë janë të vazhdueshme, duhet të theksojmë se ky është studimi i parë i mirëfilltë në këtë drejtim. Prandaj së bashku me kënaqësinë e prezantimit të gjetjeve të kësaj analize të parë mbarëkombëtare, ne synojmë të përcjellim edhe një bazë të mirë informacioni për të nxitur veprime dhe hapa konkretë drejt një prindërimi të shëndetshëm.

Jetojmë në një shoqëri ku flitet vazhdimisht kundër dhunës ndaj grave e vajzave dhe dhunës në familje, e sërish incidentet e dhunës zenë vend ndjeshëm në faqet e përditshmërisë sonë, në përmasa të trishta e shpesh me përfundime fatale. Sa më shumë thellohem në analizën se përse ndodh kjo gjë, aq më shumë kuptojmë se rrënjët shekullore të qëndrimeve të dëmshme patriarkale dhe stërvitjeve gjinore, vijnë në mbeten, në një masë të konsiderueshme, ushqimi bazë i marrëdhënieve familjare. Pra edhe pse e kundërshtojmë në parim, ne vazhdojmë në të pandërgjegjshmen tonë të mbështetjes rreth vicioz të marrëdhënieve të dhunshme.

Fëmijët vajza dhe djem në familje rriten duke parë modele tipike gjinore si dhe duke kuptuar rëndësinë e pushtetit dhe kontrollit, në shumë raste “të padiskutueshëm e të pakundërshtueshëm” të gjyshërve, baballarëve e vëllezërve kundërshtues gjysheve, nënave e motrave. Në mënyrën se si janë ndërtuar e prirën të funksionojnë marrëdhëniet prind – fëmijë në një numër të konsiderueshëm të familjeve në Shqipëri, figura e babait është më së shumti e distancuar nga aspektet e përditshme të rritjes dhe edukimit dhe pozicionohet kryesisht në sigurimin e të ardhurave. Është nëna ajo që gjendet më shumë pranë fëmijëve, ndonëse kur pyeten, fëmijët vajza e djem dëshirojnë të kalojnë më shumë kohë me babain e nënën së bashku. Nga ana tjetër, jo në pak raste, edhe kur kalojnë kohë bashkërisht me njërin apo të dy prindërit e tyre, kjo kohë jo gjithmonë është produktive dhe diskutime mbi aspekte të caktuara të

rritjes dhe edukimit janë të vakëta, ose edhe mungojnë tërësisht. Në kushte të tilla, së bashku me rritjen brumosen edhe modele apo role gjinore tradicionale, ku komunikimi është i pakët, urdhërat janë të padiskutueshëm, pozicionet e grave dhe vajzave janë qartësisht të konturuara brenda jetës familjare, e ku jo në pak raste “ndëshkimi” merr përmasa edhe fizike. Nuk janë të pakta edhe rastet kur nën pretendimin e të qenit liberalë e bashkëkohorë, ndeshen modele prindërimi të cilat në fakt kalojnë në mungesë vëmendjeje deri në neglizhim të aspekteve të caktuara të rritjes dhe edukimit të fëmijëve të tyre. Paralelisht me modelet e vajzave të mbytura nga kontrolli (sidomos kur flitet për të kaluar kohë jashtë shtëpisë me shoqërinë), nuk mungojnë shembujt e djemve shpesh edhe pa asnjë kontroll për mënyrën se si dhe me kë e kalojnë kohën gjatë ditës dhe orëve të vona të natës. Kjo mungesë ekuilibrash dhe këto diferencime në sjelljen ndaj fëmijëve vajza e djem, e kanë bazën në marrëdhënie të pabalancuara ndërmjet prindërve të tyre, ku shpesh mbizotëron dhuna.

Qendra jonë, është ndër të parat organizata rinore me eksperiencë në aplikimin e qasjes së djemve dhe baballarëve të cilët me dëshirë ndërmarrin përgjegjësitë e tyre për mbarëvajtjen e jetës familjare dhe janë kundër dhunës ndaj grave e vajzave e dhunës në familje. Studimi i modeleve të prindërimit dhe mbështetja për transformimin e tyre në modele të shëndetshme dhe efektive, është pjesë e misionit të veprimtarisë sonë, e cilat nxitet nga energjia dhe pozitiviteti i të rejave dhe të rinjve me të cilët takohemi çdo ditë. Ndonëse e ideuar dhe e filluar përpara situatës së pandemisë, puna jonë padyshim u prek dhe u ndikua prej saj, si çdo aspekt tjetër i jetës sonë. Ndaj dhe me aq sa mund të realizohej, menduam të mos linim jashtë vëmendjes edhe një vlerësim të parë të ndikimit të pandemisë në marrëdhëniet prind fëmijë.

Prezantimi i këtij raporti si pjesë e aktiviteteve tona në kuadër të Fushatës Ndërkombëtare të “16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje”, simbolizon pikërisht kontributin që dëshirojmë të japim në drejtim të krijimit të marrëdhënieve të shëndetshme, familjeve të paqta e në harmoni dhe të një shoqërie që nuk e pranon dhe nuk e toleron dhunën. Për më tepër, mesazhet që përcillen nga gjetjet dhe rekomandimet e dala nga studimi, ndërliken krejt natyrshëm dhe me sloganin që po udhëheq veprimtaritë e fushatës së këtij viti: ***Dëgjo. Beso. Mbështet. #botaportokalli***

Realizimi i këtij studimi dhe përgatitja e këtij raporti janë fryt i punës së palodhur e shumë profesionale të një ekipi me eksperte, punonjëse e punonjës të qendrës sonë dhe Zyrës së UNFPA-së në Shqipëri, të mbështetur edhe nga komentet dhe sugjerimet e dhëna nga profesionistët e profesionistët të cilët u përfshinë në rishikimin e draft raportit dhe validimin e gjetjeve të tij.

Prandaj, gjej rastin që edhe në emër të autoreve, të shpreh falenderimet tona për përfaqësueset dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendrës “Asistencë për Komunitetin në Shqipëri” (ACA), Fakultetit të Shkencave Sociale, si dhe Open Mind Spectrum Albania (OMSA). Falenderime të singerta shkojnë padyshim edhe për Zyrën e UNFPA-së në Shqipëri dhe Qeverinë e Suedisë për mbështetjen dhe financimin e studimit dhe botimit të tij, si dhe për të gjithë mbështetjen e një sërë aktiviteteve pjesë e veprimtarisë sonë ndër vite!

Armela Pengili
Drejtoreshë
Qendra “ACT for SOCIETY”

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Studimi mbi dallimet gjinore në prindërim dhe mënyrën se si ndikojnë ato në përditshmërinë e marrëdhënieve prind-fëmijë në Shqipëri, u përgatit nga Qendra “ACT for SOCIETY” me mbështetjen e Zyrës së Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë në Shqipëri (UNFPA) në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe koordinim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara, “Për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave”, i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA në partneritet me Qeverinë e Shqipërisë.

Ideja për një studim të tillë lindi nga puna e përditshme e Qendrës “ACT for SOCIETY” në kuadër të zbatimit të iniciativës së përfshirjes së djemve dhe të rinjve në veprime që nxitin barazinë dhe drejtësinë gjinore, përmes zbatimit të programit të mbështetur nga CARE International “Young Men Initiative”. Të frymëzuar nga arritjet pozitive të ndryshimeve në sjelljen e djemve të angazhuar në këtë program edukues të zbatuar në disa shkolla të vendit, si dhe të nxitur nga nevoja për të evidentuar rëndësinë që ka trajtimi në mënyrë të barabartë i fëmijëve pavarësisht gjinisë, moshës apo çdo karakteristike tjetër individuale, për një familje të shëndoshë e një shoqëri pa dhunë, vendosëm të hedhim hapin e parë për të hulumtuar sa dhe si zenë vend dallimet gjinore në prindërim në Shqipëri, si konceptohen nga vetë prindërit dhe fëmijët stilet e prindërimit dhe dallimet në sjelljen kundrejt fëmijëve vajza dhe djem në familje, cilët janë faktorët që nxitin këto dallime gjinore, çfarë efektesh kanë ato në procesin e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve vajza e djem, etj. Në përgatitjen e metodologjisë së studimit u bazuam dhe në praktikat ndërkombëtare të vlerësimit të stileve të prindërimit, duke dashur kështu të prezantojmë një produkt sa më të vlefshëm e të përditësuar nga pikëpamja kërkimore.

Pyetjet kërkimore të ngritura për këtë studim ishin:

1. Cilat stile të prindërimit mund të evidentohen në Shqipëri, duke përdorur si mjet kërkimor Pyetësorin ndërkombëtar të Dimensioneve dhe Stileve të Prindërimit (PSDQ)?
2. Si e perceptojnë fëmijët dhe si e perceptojnë prindërit e tyre stilin e prindërimit?
3. A ndryshon ky stil me kalimin e viteve dhe në cilat dimensione?
4. Cilat janë dallimet kryesore në mënyrën e rritjes dhe edukimit të fëmijëve vajza dhe djem dhe çfarë efektesh kanë këto në ndërtimin e marrëdhënieve prind-fëmijë në tërësi?
5. Cilat janë rolet që marrin fëmijët në familje?

Të dhënat dhe informacioni bazë për përgatitjen e studimit janë mbledhur nëpërmjet:

□ **2449 pyetësorëve të vlefshëm** të plotësuar nga 1665 prindër (866 nëna dhe 799 baballarë) dhe 784 fëmijë të këtyre prindërve, nxënëse dhe nxënës të klasave të nënta deri të dymbëdhjeta (422 vajza dhe 362 djem),

□ **28 intervistave të thelluara** me prindër të cilët nuk ishin pjesë e kërkimit sasior, (21 të intervistuar) dhe profesioniste e profesionistë si mësuese/mësues apo psikologe/psikologë në shkolla (7 të intervistuar/intervistuar)

□ **14 diskutimeve në grupe të fokusuara** me afërsisht 70 vajza dhe djem të cilët nuk ishin pjesë e kërkimit sasior, (5 nga diskutimet në grupe të fokusuara synuan të evidentonin ndikimin e pandemisë në ndryshimin ose jo të sjelljes së prindërve ndaj tyre, sidomos gjatë kufizimit/mbylljes së detyruar).

Këto të dhëna janë mbledhur në bashkitë qendër të 12 qarqeve të vendit, duke përfshirë zonë urbane dhe rurale, ndaj dhe bazuar edhe në kampionimin e përdorur, studimi mund të quhet përfaqësues në nivel kombëtar.

Raporti përbëhet nga katër kapituj kryesorë. Në kapitullin hyrës jepet një informacion i përgjithshëm mbi stilet e prindërimit dhe klasifikimin e tyre nga eksperiencia ndërkombëtare, së bashku me karakteristikat dalluese të sjelljes së prindërve në varësi të stilit të prindërimit të zgjedhur për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre. Përshkrimi i metodologjisë dhe instrumentave të përdorur për mbledhjen e të dhënave bazë, jepet në kapitullin e dytë të raportit, ku përshkruhen gjithashtu edhe kufizimet e këtij studimi. Në kapitullin e tretë prezantohen gjetjet nga analiza dhe përpunimi i informacionit sasior dhe cilësor, ndërsa konkluzionet dhe rekomandimet e bazuara në këtë analizë, jepen në kapitullin e katërt të raportit.

Puna në terren për mbledhjen e të dhënave në kuadër të këtij studimi filloi që në shtator 2019, por pati ndërprerje për shkak të dy situatave të papritura me të cilat u ndesh vendi ynë, fillimisht me emergjencën civile të shkaktuar nga tërmeti i nëntorit 2019 e më pas me gjendjen e fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë së COVID-19. Në lidhje me këtë të fundit është bërë edhe një përpjekje fillestare për të mbledhur mendime nga disa fëmijë vajza dhe djem, nëse kanë ndier ndonjë ndryshim në mënyrën e sjelljes dhe stilin e prindërimit të prindërve të tyre, duke e krahasuar me kohën përpara pandemisë, gjatë mbylljes për shkak të saj dhe aktualisht në situatën e kufizimeve të pjesshme dhe të të mësuarit për të bashkëjetuar me virusin. Informacioni për këtë qëllim u mbledh nëpërmjet organizimit të pesë diskutimeve me grupe të fokusuara, gjatë javës së fundit të muajt tetor dhe fillimit të muajit nëntor 2020, në Tiranë, Ibë dhe Krujë. Pandaj nëse të dhënat e tjera janë përfaqësuese në nivel kombëtar, këto të dhëna u menduan të përfshihen vetëm si fillesë e nxitjes së nevojës për hulumtim të mirëfilltë në këtë drejtim.

Në mënyrë të përmbledhur, gjetet kryesore të studimit paraqiten në vijim:

Stilet e prindërimit nuk janë të prera me thikë dhe pavarësisht stilit kryesor që përdoret, prindërimi përmban edhe elementë të stileve të tjera. Po kështu edhe dimensione të caktuara të secilit stil prindërimi ndryshojnë me kalimin e kohës, nisur dhe nga rrethanat dhe eksperiencat jetësore me rritjen e fëmijës dhe me maturimin e vetë prindërve (në varësi të numrit të fëmijëve, moshës së prindërve, përparimit në drejtim të informimit, ndikimit të teknologjisë e mediave sociale, etj.). Kjo thekson nevojën për ripërsëritjen e këtij studimi në mënyrë periodike, si dhe për analiza më të thelluara mbi secilin grup faktorësh kryesorë që ndikojnë në ndryshimin e stileve të prindërimit.

Stili autoritativ/demokratik duket se është mbizotërues në kampionimin e përfshirë në studim (prej 1665 prindërish, 866 nëna dhe 799 baballarë). Nga përgjigjet e pyetjeve të dhëna nga fëmijët dhe vetë prindërit e tyre mbi dimensionet e secilit stil prindërimi siç klasifikohen në literaturën mbarëbotërore, rezulton se:

- 67.6% nëna dhe 58.9% baballarë përdorin *stilin autoritativ/demokratik* të prindërimit;
- 25.05% nëna dhe 21.57% baballarë përdorin *stilin autoritar* të prindërimit;
- 6.55% nëna dhe 7.7% baballarë përdorin *stilin lejues/tolerant* të prindërimit.

Më shumë se gjysma e djemve (60%) dhe gjysma e vajzave (52%) të përfshira në studim, deklarojnë se më së shumti e kalojnë kohën me të dy prindërit. 45% e djemve dhe 44% e vajzave deklarojnë se të dy prindërit janë kujdesur gjatë rritjes së tyre, ndërkohë që 40% e djemve dhe 42% e vajzave deklarojnë se është nëna prindi që është kujdesur më shumë gjatë rritjes së tyre.

Të dy prindërit përdorin ndëshkimin sipas 16% e djemve dhe 18% e vajzave, ndërsa 15% e djemve dhe 12% e vajzave e pohojnë këtë gjë mbi ndëshkimin fizik.

30% e djemve pohojnë se të dy prindërit u kanë folur në fëmijëri për trupin e tyre dhe zhvillimin biologjik, ndërkohë që vetëm 9% e vajzave pohojnë që këtë bisedë ta kenë bërë me të dy prindërit. 64% e vajzave pohojnë se këtë bisedë e ka bërë me to nëna dhe po kështu pohojnë dhe 24% e djemve.

48% e djemve dhe 27% e vajzave pohojnë se nuk diskutojnë me asnjërin nga prindërit mbi shëndetin seksual e riprodhues të tyre. 10% e djemve dhe 49% e vajzave pohojnë se diskutojnë më shumë me nënën, 18% e djemve dhe 11% e vajzave pohojnë se diskutojnë me të dy prindërit.

47% e djemve dhe 52% e vajzave pohojnë se të dy prindërit u japin informacion rreth dhunës që mund të ndodhë në familje apo shoqëri, ndërkohë që 26% e vajzave dhe po aq djem pohojnë se asnjëri nga prindërit nuk u jep informacion mbi këtë çështje.

- Pjesa më e madhe e fëmijëve shprehen se nëna kalon më shumë kohë me ta sepse babai është në punë. Në disa raste fëmijët e justifikojnë mos kalimin e kohës me babain duke u shprehur se ai punon shumë, ndërsa nëna ka më shumë kohë të lirë për të kaluar me fëmijën.
- Baballarët shikohen nga fëmijët si siguresit e të ardhurave dhe që nuk kanë një rol aktiv në rritjen e fëmijëve. Fëmijët shprehen që tek babai drejtohen për pjesën e parave që iu duhen dhe që është ai që shpesh iu plotëson nevojat dhe dëshirat. Në shumë raste edhe pse nëna punon jashtë shtëpisë nuk nxirret në pah kontributi i saj ekonomik që ajo sjell në familje.
- Në shumicën e rasteve si prindërit dhe fëmijët akoma nuk janë gati për të komunikuar së bashku rreth çështjeve të seksualitetit. Duke qenë se komunikimi në familje për këto tema mungon ata zgjedhin që të diskutojnë me bashkëmoshatarët, sepse ata në përgjithësi kanë interes për këto çështje. Komunikimi me bashkëmoshatarët raportohet më i lehtë duke qenë se ata kanë qëndrime më lejuese dhe jo gjykuese. Kur kanë motra apo vëllezër më të mëdhenj në familje, flasin me ata për çështje të tilla dhe kjo kthehet edhe në një lehtësi për prindërit, të cilët nuk ndiehen gati që të diskutojnë me fëmijët.
- Prindërit e kanë më të lehtë që të vendosin ndëshkime për vajzat, djemtë ndëshkohen më rrallë. Vajzat kontrollohen më shumë për orarin dhe prindërit tentojnë që t'i kufizojnë dhe mbajnë nën kontroll më shumë sesa djemtë. Vajzat raportojnë që prindërit janë më të ashpër, kanë rregulla shumë më strikte dhe vendosin kufizime në mënyrë të vazhdueshme ndaj tyre sesa ndaj djemve.
- Situata e izolimit apo kufizimeve për shkak të COVID-19 ka krijuar mundësinë që anëtarët e familjes të shpenzojnë më shumë kohë së bashku dhe të diskutojnë për tema të ndryshme. Komunikimet e prindërve gjatë izolimit kanë qenë të fokusuara edhe në informimin e fëmijëve mbi COVID-19, masat parandaluese dhe të kujdesit që ata duhet të kenë për të mbrojtur veten por dhe anëtarët e tjerë të familjes. Fëmijët pohojnë që prindërit në disa raste kanë shprehur më shumë shqetësim për shëndetin e fëmijëve për shkak të situatës së krijuar nga pandemia.

I. ROLET GJINORE, DALLIMET GJINORE DHE PRINDËRIMI

Për shekuj është besuar se karakteristikat, rolet dhe statuset e ndryshme të burrave dhe grave djemve dhe vajzave në shoqëri, përcaktohen nga biologjia, pra janë të natyrshme dhe si rrjedhim të pandryshueshme. Ky besim është bazuar pikërisht në dallimet seksuale ndërmjet burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, dallime këto që çojnë në diferencime madhore në aksesin dhe mundësitë e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në fusha të ndryshme të jetës. Çështjet që lidhen me dallimet seksuale, që përcaktojnë edhe dallimet gjinore, janë të komplikuar dhe mund të çojnë në mendime stereotipike.

Ne rritemi duke dëgjuar, parë dhe mësuar se si vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat duhet të sillen dhe duhet tëveprojnë në shoqëri. Këto “norma gjinore” mbi atë se çfarë “është e drejtë” apo “lejohet” dhe çfarë “është e gabuar” i mësojmë dhe i brendësojmë që në fillim të jetës. Kjo krijon një cikël jetësor të socializimit gjinor dhe stereotipeve gjinore. Së bashku me normat gjinore natyrshëm zenë vend në jetën tonë edhe rolet gjinore, pra pikërisht normat shoqërore dhe të sjelljes që, brenda një kulture të caktuar, konsiderohen

“Përkatësia gjinore (Gender)” i referohet attributeve shoqërore dhe mundësive që lidhen me të qenit mashkull ose femër, si dhe marrëdhëniet midis grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, por dhe marrëdhëniet midis grave dhe atyre midis burrave. Këto attribute, mundësi dhe marrëdhënie janë të ndërtuara shoqërisht dhe mësohen përmes proceseve të socializimit. Ato janë specifike për kontekstin / kohën dhe të ndryshueshme. Përkatësia gjinore përcakton atë që pritet, lejohet dhe vlerësohet tek një grua ose një burrë në një kontekst të caktuar. Në shumicën e shoqërive ekzistojnë dallime dhe pabarazi midis grave dhe burrave në përgjegjësitë e caktuara, aktivitetet e ndërmarra, aksesin dhe kontrollin mbi burimet, si dhe mundësitë e vendimmarrjes. Përkatësia gjinore është pjesë e kontekstit më të gjerë socio-kulturor. Kriteria të tjera të rëndësishme për analizën socio-kulturore përfshijnë klasën, racën, nivelin e varfërisë, grupin etnik dhe moshën.

të përshtatshme për individët e secilës gjini. Këto shpesh përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrat tradicionale që u janë caktuar burrave, grave, djemve dhe vajzave dhe shihen qartësisht edhe në ndarjen gjinore të punës.

Pa na u dhënë shumë shpjegime se përse ndodh kështu, ne e gjejmë veten tek kemi brendësuar idenë që ka punë të caktuara “për gra” dhe “për burra”, e kur vjen fjala për marrëdhëniet në familje, shohim që rolet dhe ndarja gjinore e

punës i vendosin gratë dhe vajzat më shumë në pozicione të përkujdesjes e të mbarëvajtjes së jetës familjare. Ndërsa burrat dhe djemtë janë ata të cilët kanë rolin parësor në sigurimin e të ardhurave, në mbrojtjen e familjes, në marrjen e vendimeve dhe kanë pushtetin e kontrollin mbi të gjitha burimet në dispozicion. Kjo transmetohet ngjashmërisht edhe në përzgjedhjen e profesioneve, ku gratë shihen më së shumti si mësuese, edukatore, infermiere, specialiste, ndërsa burrat si inxhinierë, specialistë të teknologjisë (IT), biznesmenë, drejtues, e më të përshtatshëm si politikanë e udhëheqës të vendit. Madje duket se këtë pushtet e kontroll e kanë fituar që në lindje, për shkak se i përkasin seksit “mashkull”. Dallimet biologjike, çojnë në dallime gjinore e këto sjellin diferencim në mundësinë apo pamundësinë që ka secila gjini të zhvillohet, të ketë aksesin e duhur në burime e të mund të arrijë qëllime të caktuara në jetë.

Pikërisht diferencime të tilla bëjnë që të ketë ndryshim ndërmjet “barazisë gjinore” - të drejtës së gjithësecilit e gjithësecilës për të qenë të barabartë përpara ligjit, për të gëzuar të gjitha privilegjet, mbrojtjen, shërbimet dhe për të ploësuar nevojat, pavarësisht gjinisë, moshës, apo karakteristikave të tjera dalluese individuale (barazia de-jure), si dhe “drejtësisë gjinore” - mënyrës se si zbatohet në praktikë ajo çfarë është e shkruar në ligj lidhur me barazinë gjinore (barazia de-facto).

Pra ndërmjet barazisë gjinore dhe drejtësisë gjinore ende ekziston një hendek i madh. Po kështu vihet re që, jo në pak raste, një mënyrë e të kundërvënit ndaj atyre që institojnë për të pasur barazi jo vetëm de-jure por edhe de-facto, është tendenca për t’i vendosur gratë në pozicione të pafavorshme dhe për të njëtrajtësuar veprimtarinë ndërmjet tyre dhe burrave: nëse një grua kërkon barazi, atëhere le të përballojë të gjitha punët e krahut që përballon një burrë,

Barazia e grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë dhe një vlerë thelbësore për çdo demokraci. Për t’u arritur kjo e drejtë, duhet që ajo jo vetëm të njihet me ligj, por edhe të zbatohet me efektivitet në të gjitha sferat e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Me gjithë rastet e shumta të njohjes zyrtare dhe përparimin e bërë, barazia e grave dhe burrave në jetën e përditshme ende nuk është bërë realitet. Gratë dhe burrat nuk gëzojnë të drejta të njëjta në praktikë. Ende vazhdojnë të ekzistojnë pabarazitë shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore – për shembull, dallimet në paga dhe përfaqësimi i ulët politik. Këto pabarazi janë rezultat i disa nocioneve shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipeve të shumtë të pranishëm në familje, arsim, kulturë, mjetet e komunikimit, në botën e punës, në organizimin e shoqërisë... Janë të shumta fushat e jetës në të cilat mund të veprohet, përmes përdorimit të një qasjeje të re dhe realizimit të ndryshimeve strukturore.

nëse një grua pretendon se është e aftë, atëhere le ta tregojë këtë aftësi duke u përballur me burrat e duke i zgjidhur situatat ashtu si ata, nëse një grua kërkon të ndihet e respektuar, le të provojë “burrërinë e saj”... pra, barazia ngatërrohet e zëvendësohet me njëtrajtshmërinë.

Ne jemi të ndryshëm e duhet të jemi të barabartë, jo të ngjashëm! Kjo barazi e njëtrajtësuar nuk mundet dhe nuk duhet të zerë vend si normë krahasuese as ndërmjet grave e burrave dhe as ndërmjet vetë grupeve të grave e vajzave apo ndërmjet vetë grupeve të burrave e djemve. Edhe kur i përkasim të njëjtës gjini, nevojat, interesat, mundësitë dhe pritshmëritë tona ndryshojnë dhe lidhen me një sërë karakteristikash individuale.

Reflektimi i të gjitha këtyre dallimeve, roleve e stereotipeve gjinorë në marrëdhëniet prind - fëmijë dhe stilet e prindërimit sigurisht që ka pasojat e tij. Sa më shumë dallime të bëjmë në mënyrën se si komunikojmë, në rregullat që vendosim, në mënyrën se si “shpërblejmë” apo “ndëshkojmë” një sjellje të caktuar tek fëmijët vajza dhe djem, pikërisht bazuar në gjininë e tyre, aq më shumë thellojmë hendekun ndërmjet barazisë dhe drejtësisë gjinore dhe aq më shumë sfida i ngremë zbatimit të parimit të barazisë në praktikë. Prindërimi nuk është i lehtë e për më tepër nuk ka një formulë fikse matematikore, që të mund të aplikohet e të sillte rezultatet e dëshiruara. Këshilla më e mirë për prindërit është që t’i duan fëmijët e tyre dhe të përpiqen maksimalisht që të jenë prindër të mirë, pra të rritin fëmijët e tyre me sa më shumë dashuri, përkujdes dhe udhëzime të qarta e të vlefshme për krijimin e vetëbesimit, në një ambjent familjar sa më të ngrohtë e të sigurt. Kjo nënkupton që komunikimi është baza e marrëdhënieve të tilla të shëndosha ku dhuna nuk ka vend, në asnjë formë të saj. Sigurisht që përsosmëria nuk ekziston dhe sado të përpiqen prindërit mundet edhe të gabojnë, por e rëndësishme është të kuptuarit dhe të mësuarit nga gabimet. Për më tepër, mënyra se si trajtohen fëmijët dhe stili i prindërimit që vendosin të përdorin, duhet të zgjidhet me kujdes dhe të mos lidhet domosdoshmërisht me atë që kanë përjetuar vetë në fëmijërinë e tyre, sidomos kur prindërit e tyre i kanë edukuar përmes ndëshkimit dhe dhunës. “Frika ruan vreshtin!”, “Druri ka dalë nga xheneti”, “Kush të rreh, të do”...etj., janë disa nga shprehjet e përdorura tradicionalisht për të justifikuar sjelljen e dhunshme, të cilat përcillen së bashku me rolet tradicionale gjinore të pozicionit të grave, vajzave dhe burrave, djemve në familje e shoqëri. Por, ky cikël përcjelljeje, duhet tashmë të ndërpritet!

Kënaqësia e të qenit prind shoqërohet në çdo hap edhe me vështirësitë që ka ky rol, vështirësi këto që përshkallëzohen nëse flitet për prindërit me shumë fëmijë, dhe sidomos kur dikush është prind i vetëm. Studiuesit ndër vite kanë arritur në konkluzionin se mënyrat e ndërveprimit të prindërve me fëmijët e tyre mund të grupohen në katër kategori apo stile prindërimi, megjithatë shumica e prindërve kanë një stil parësor prindërimi por edhe elementë të stileve të tjera.

Nëse shfletojmë historinë e kërkimeve mbi stilet e prindërimit, rezulton se modeli i përgjithshëm i sjelljes së prindërve u prezantua për herë të parë

nga Schaefer (1959, 1965) dhe u bazua në tre dikotomi: pranimi kundrejt refuzimit, pavarësia psikologjike kundrejt kontrollit psikologjik dhe kontrolli i qendrueshëm i sjelljes kundrejt kontrollit të dobët të sjelljes. Mbi këtë model, Baumrind (1966, 1968) konceptoi tre prototipa të prindërve: “prindërit autoritativë”, “prindërit autoritarë” dhe “prindërit lejues”, për të përshkruar modelet e kontrollit prindëror dhe socializimin e fëmijëve. Këto tipologji më pas u riklasifikuan bazuar në dimensionet e reagimit dhe kërkueshmërisë, duke shtuar edhe një stil të katërt prindërimi: “prindërit e papërfshirë” (Maccoby & Martin, 1983). Ky stil prindërimi është referuar gjithashtu si “prindërit e paangazhuar” (Baumrind, 1989; 1991), “prindërit që heqin dorë nga angazhimi” (Baumrind, Larzelere, & Owens, 2010), “prindërit neglizhues” (Steinberg et al., 1994) apo edhe si “prindërit refuzues-neglizhues” (Baumrind, 1989; 2013). Që nga kjo kohë, shumë studiues kanë vazhduar të shqyrtojnë stilet e prindërimit dhe karakteristikat specifike që përbëjnë secilën tipologji.

Dimensioni i përgjegjshmërisë i referohet pranimit, mbështetjes, ngrohtësisë dhe përshtatjes së prindërve për nevojat e fëmijës (Maccoby & Martin, 1983; shih gjithashtu Baumrind et al., 2010; Baumrind, 2013). Dimensioni i kërkueshmërisë i referohet kontrollit prindëror ose pohimit të fuqisë prindërore (Maccoby & Martin, 1983). Baumrind (2012) sugjeron që dimensionin e kërkueshmërisë është cilësisht i ndryshëm midis stileve të prindërimit dhe ndryshimet duhet të dallohen. Një lloj kërkese, kontrolli konfrontues, i cili është pohim i fortë dhe i drejtpërdrejtë i fuqisë, i njohur gjithashtu si kontroll i sjelljes, lidhet me rezultate pozitive për fëmijët (Baumrind, 2012; Baumrind et al., 2010). Kontrolli i sjelljes konfrontive është i orientuar drejt qëllimit dhe përdor arsytimin (Baumrind, 2012). Anasjelltas, kontrolli detyrues është një lloj negativ i pohimit të fuqisë që është ndërhyrës, i ashpër dhe ndëshkues dhe lidhet me rezultate negative për fëmijët (Baumrind 2012; Baumrind et al., 2010). Së fundmi, kontrolli psikologjik është i fshehtë, manipulues dhe minon ndjenjën e vetvetes së fëmijës (Barber & Xia, 2013; Baumrind, 2013). Disa aspekte të kontrollit psikologjik përfshijnë detyrimin, manipulimin, respektimin e kushtëzuar dhe mosrespektimin (Barber & Xia, 2013). Në një përmbledhje të kohëve të fundit, Baumrind (2013) sugjeron që në vend të reagimit dhe kërkueshmërisë, dikotomitë e pranimit kundrejt refuzimit, pavarësisë psikologjike kundrejt kontrollit psikologjik dhe kontrollit të qendrueshëm të sjelljes kundrejt kontrollit të sjelljes së dobët, mund të përdoren për të konceptuar secilën nga katër tipologjitë e prindërve.

Përcaktimi i tipologjive prindërore “autoritative”, “autoritare”, “lejuese” dhe “neglizhuese” mund të arrihet duke shqyrtuar nivele të ndryshme të dimensioneve të pranimit dhe refuzimit, kontrollit të sjelljes dhe kontrollit psikologjik, që janë unike për secilin stil.

1. STILI AUTORITATIV/DEMOKRATIK. Prindërit autoritativë ushtrojnë kontroll mbi sjelljen e fëmijës dhe jo kontroll psikologjik (Baumrind 2013; Baumrind et al., 2010). Baumrind (1966) i konceptoi prindërit autoritativë si racionalë, të ngrohtë, inkurajues dhe kontrollues në një mënyrë që promovon pavarësinë e fëmijëve. Në mënyrë të ngjashme, Maccoby dhe Martin (1983) përshkruajnë prindërit autoritativë si prindër të cilët vendosin qartë rregulla dhe përdorin arsyetimin për t'i zbatuar ato, duke inkurajuar komunikimin e hapur, duke mbështetur pavarësinë e fëmijëve dhe duke shprehur dashuri. Stili autoritativ i prindërimit është konsideruar si stili optimal i prindërimit (Baumrind, 1966; Baumrind, 2013; Maccoby & Martin, 1983) dhe lidhet me rezultate pozitive të fëmijëve si vetëbesimi (Baumrind, 1968; 1971), përgjegjësia sociale (Baumrind, 1971), dhe përshtatja (Baumrind et al., 2010). Për këtë mënyrë prindërimi është e përshtatshme thënia “Të ofrosh zgjedhje”. Për të nxitur sjelljen e mirë, prindërit autoritativë i dispiplinojnë fëmijët duke mos i ndëshkuar pa vend dhe njëkohësisht duke mos u dhënë shpërblime të pamerituara. Ata vendosin rregulla dhe kufij për sjelljen e fëmijëve të tyre, por edhe u kushtojnë fëmijëve kohën e duhur për t'u shpjeguar pse duhen ndjekur rregullat. Ata kanë synime të qarta lidhur me mënyrën me të cilën duhet të sillen fëmijët e tyre dhe i ndihmojnë drejt përmbushjes së këtyre synimeve. Prindërit autoritativë u japin fëmijëve mundësinë të zgjedhin por e bëjnë këtë duke pasur në mendje nivelin e zhvillimit të fëmijës. Këta prindër janë të përgjegjshëm ndaj nevojave të fëmijëve dhe dëgjojnë me dëshirë problemet dhe pyetjet e tyre. Kur fëmijët nuk arrijnë të bëjnë atë që u kërkohet, metodat disiplinuese që përdorin këta prindër janë mbështetëse, përqendrohen tek sjellja pozitive e fëmijëve dhe e përforcojnë atë me dashuri. Prindërit autoritativë dëshirojnë që fëmijët e tyre të jenë të sigurt po aq sa dhe të përgjegjshëm në marrëdhëniet shoqërore, si dhe bashkëpunues po aq sa dhe të pavarur.

2. STILI AUTORITAR. Prindërit autoritarë refuzojnë sjelljen dhe kontrollojnë psikologjikisht. (Baumrind, 2013; Baumrind et al., 2010). Ata janë shumë kërkuar dhe shpesh janë ndëshkuar duke i detyruar fëmijët t'i përmbahen një standardi absolut për sjellje (Baumrind, 1966). Kontrolli autoritar i prindërve është detyrues dhe sundues (Baumrind, 2012). Ky lloj prindërimi lidhet me rezultate më pak optimale të fëmijëve, duke përfshirë vetë-efikasitet më të ulët (Baumrind et al., 2010), probleme të jashtme (Maccoby & Martin, 1983) dhe rebelim (Baumrind, 1968). Për këtë mënyrë prindërimi është e përshtatshme thënia “Të japësh urdhra”. Kjo është karakteristika e stilit autoritar. Prindërit që praktikojnë këtë stil prindërimi përpiqen të jenë gjithmonë kontrollues dhe ta ushtrojnë këtë kontroll mbi fëmijët e tyre. Ata u tregojnë fëmijëve çfarë duhet të bëjnë deri në detaje, vendosin rregulla të shumta dhe të ngurta dhe presin që fëmijët t'i zbatojnë ato me përpikëri. Nëse nuk plotësohen kërkesat e tyre, këta prindër janë të gatshëm të përdorin ndëshkimin ose janë shumë kritikë

ndaj fëmijëve. Për më tepër, prindërit autoritarë nuk u shpjegojnë fëmijëve cilat janë arsyet për të cilat duhen zbatuar rregullat dhe nuk u japin mundësi të zgjedhin apo të vendosin vetë për sa i përket ushqimit, lojës, detyrave, etj. Nëse një fëmijë kundërshton një rregull ose urdhër, këta prindër përgjigjen ftohtë: “Kështu them unë dhe pikë!”. Prindërit autoritarë përqendrohen së tepërmi tek sjellja e gabuar e fëmijëve të tyre dhe priren t’i ndëshkojnë me fjalë dhe fizikisht kur fëmijët nuk u binden. Zakonisht këta prindër nuk përpiqen të kuptojnë apo të dëgjojnë me vëmendje këndvështrimin e fëmijëve të tyre. Pasojat e hasuara tek fëmijët janë ankth, paafësi për të filluar ndonjë aktivitet, për të ndërvepruar në mënyrë efektive, etj.

3. STILI LEJUES / TOLERANT. Prindërit lejues promovojnë pavarësinë psikologjike dhe shfaqin kontroll të butë ndaj sjelljes së fëmijëve të tyre (Baumrind, 2013; Baumrind et al., 2010), madje vendosin pak kërkesa kundrejt sjelljes tek fëmija (Baumrind, 1966). Prindërit lejues shmangin praktikat shtrënguese ose konfrontuese sa më shumë që të jetë e mundur (Baumrind, 1989). Për më tepër, prindërit lejues i lejojnë fëmijët të caktojnë rregullat dhe të marrin vendimet e tyre (Maccoby & Martin, 1983). Ky lloj prindërimi lidhet me rezultate të fëmijëve si arritje jo të larta (Baumrind, 1971), mungesa e kontrollit të impulsit (Maccoby & Martin, 1983) dhe pavarësi jo në nivelin e duhur (Baumrind et al., 2010). Për këtë mënyrë prindërimi është e përshtatshme thënia “Të dorëzohesh”. Prindërit që ndjekin këtë stil prindërimi janë e kundërta e prindërve autoritarë. Ata i lejojnë fëmijët të bëjnë çfarë dëshirojnë. Prindërit liberalë vendosin shumë pak rregulla dhe zbatimin e tyre ua lënë në dorë fëmijëve. Ata duan që fëmijët e tyre të ndiehen të lirë dhe ta gjejnë vetë rrugën në jetë, pa ndihmën e askujt. Si rrjedhojë, këta prindër nuk vendosin kufij dhe pritshmëri për sjelljen e fëmijëve të tyre por përpiqen t’i duan e t’i pranojnë ata ashtu siç janë. Prindërit liberalë e përdorin ndëshkimin shumë rrallë dhe në mënyrë të çrregullt. Ata u japin fëmijëve shumë mundësi zgjedhjeje edhe kur fëmija nuk është në gjendje të bëjë zgjedhjen e duhur. Shpeshherë, këta prindër zgjedhin të mos ndikojnë në sjelljen e fëmijëve të tyre edhe kur kjo e fundit mund të jetë e dëmshme për zhvillimin e fëmijës ose për marrëdhënien prind-fëmijë. Fëmijëve që rriten pa kufij bota u duket një vend tepër i vështirë për të jetuar. Prindërit lejues janë komunikues me fëmijët e tyre, interesohen për anën emocionale të fëmijëve, por u kërkojnë fëmijëve pak vetëkontroll dhe maturi. Ata e vendosin veten më tepër në pozitën e një shoku sesa të një prindi.

4. STILI NEGLIZHUES. Prindërit neglizhues / të papërfshirë kanë kontroll të butë të sjelljes (Baumrind, 2013). Ata minimizojnë tërësisht përpjekjet dhe kohën që prindërit mendohet t’u kushtojnë fëmijëve (Maccoby & Martin, 1983). Kështu, prindërit neglizhues mund t’i përgjigjen një fëmije me armiqësi ose mund të mos i përgjigjen fare, duke i lënë pas dore nevojat e fëmijës (Maccoby & Martin, 1983). Baumrind (1989)

zbuloi se stili i prindërve neglizhues ishte i lidhur me përdorimin e praktikave shtrënguese dhe mungesën e monitorimit. Prindërimi neglizhues karakterizohet nga një nivel i ulët i ngrohtësisë prindërore dhe i kontrollit.

Ata janë pothuaj krejtësisht të papërfshirë në jetën e fëmijëve të tyre, me përgjegjësi dhe përkujdesje tepër të kufizuara. Prindërit neglizhues, në rastet më të mira u sigurojnë fëmijëve nevojat bazë si ushqim, fjetje, kanë komunikim të pakët me fëmijët, nuk janë të lidhur me jetën e fëmijëve të tyre. Ata i shpërfillojnë fëmijët, dhe për ta primare janë interesat personale. Fëmijët e rritur prej këtyre prindërve përdorin humbasin vetëkontrollin, kanë nivel të ulët vetëvlerësimi, dhe janë më pak të aftë se bashkëmoshatarët e tjerë.

Sigurisht që stili i prindërimit ndikon në zhvillimin emocional dhe të sjelljes së fëmijëve. Mënyra se si prindërit u përgjigjen

emocioneve negative të fëmijëve ndikon në mënyrën sesi fëmijët përballen me emocionet e tyre në të ardhmen. Prindërit që u përgjigjen emocioneve negative të fëmijëve në një mënyrë që është mbështetëse, nëpërmjet përdorimit të përgjigjeve të përqendruara tek problemi, i ndihmojnë fëmijët të bëhen më të aftë nga ana shoqërore dhe emocionale. Po kështu ka shumë rëndësi atmosfera familjare në tërësi dhe mënyra se si të gjithë anëtarët e familjes

Disa këshilla për prindërimin e mirë:

6. *Prindërimi i mirë përqendrohet në zgjidhjen e problemeve dhe praktikimin e pranimit, faljes dhe dhembshurisë. Kjo ndihmon fëmijën të ndihet i sigurt ndërsa mëson dhe rritet.*
7. *Buzëqeshja është 'ngjithëse' dhe sjell lumturi.*
8. *Mos u mundoni që të keni gjithçka nën kontroll, thjesht qëndroni afër fëmijës tuaj dhe mbështeteni atë.*
9. *Çdo moment i lidhjes me fëmijën tuaj është i vlefshëm, luani dhe kaloni sa më shumë kohë produktive me të.*
10. *Përballoni sukseset dhe dështimet e fëmijës suaj me dashuri të pakushtëzuar.*
11. *Drejtojeni fëmijën tuaj drejt zgjedhjeve më të mira duke qenë të sjellshëm dhe të qartë në lidhje me pritshmëritë tuaja. Vendosja e kufijve të qartë është pjesë e një strategjie të prindërimit të mirë.*
12. *Komunikoni me respekt dhe mos harroni se mënyra se si flisni me fëmijën tuaj, do të ndikojë drejtpërdrejt në atë se si dhe çfarë ata do të besojnë për veten e tyre.*
13. *Kërkoni mundësi, pa marrë parasysh sa të pakëta mund të jenë, për t'u lidhur me të vërtetë me fëmijën tuaj çdo ditë.*
14. *Gjeni kohë për veten tuaj që të keni energji për t'u kujdesur për fëmijën tuaj.*
15. *Me kalimin e viteve 'gjithçka' mund të bëhet më e ndërlikuar dhe stresuese. Besoni se dashuria juaj është e mjaftueshme dhe mos harroni se për fëmijën tuaj, prania dhe mbështetja juaj do të jenë gjithmonë të rëndësishme.*
16. *Dëgjoni, besoni dhe mbështesni fëmijët tuaj në hapat që hedhin në jetë.*

mbështetin apo jo njëri-tjetrin, pra nëse përpiqen apo jo që të gjejnë zgjidhje së bashku, duke i ruajtur të gjitha funksionet dhe mbështetjen pozitive familjare. Në ndërtimin e marrëdhënieve prind – fëmijë ndikojnë gjithashtu edhe elementë të tjerë të lidhur me çështje të mëmësisë dhe (kur përjetohet) të depresionit pas lindjes, praktikat e të ushqyerit të fëmijëve (nëpërmjet kufizimeve, presionit apo monitorimit të mënyrës se si fëmija ushqehet), etj. Ndërsa kur analizojmë të gjitha sa më sipër në mënyrën se si reflektohen apo gjejnë zbatim në praktikë në stilet e prindërimit të prindërve shqiptarë, nuk duhet të harrojmë edhe ndikimin që ka niveli i ulët i komunikimit jo vetëm prind-fëmijë, por edhe ndërmjet vetë prindërve, niveli i lartë i ndëshkimeve dhe përdorimit të dhunës i trashëguar prej vitesh, ndikimin shumë të madh të stereotipeve, roleve dhe ndarjes gjinore të punës, etj.

II. METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij studimi është një kombinim i rishikimit të literaturës dhe studimeve të mëparshme ekzistuese (desk review) me mbledhjen e informacionit sasior e cilësor në terren, nëpërmjet përgatitjes së instrumentave përkatës. Të dhënat sasiore dhe cilësore u mbledhën në të dymbëdhjetë qarqet e vendit. Të dhënat u mbledhën të disagreguara sipas gjinisë, moshës, vendbanimit dhe një tërësi karakteristikash të tjera personale. Për të pasur pjesë të studimit edhe perceptimet e fëmijëve dhe prindërve të klasifikuar sipas disa variablave (p.sh sipas aftësisë së kufizuar, etnisë, orientimit seksual, etj) u bashkëpunua me organizata të tjera për të mos i lënë këto grupe jashtë vëmendjes, pavarësisht se deklarimi ose jo i të gjitha karakteristikave të tyre personale ishte vullnetar.

Kërkimi sasior. Të dhënat sasiore u mbledhën nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar nga prindërit (nëna dhe baballarë) si dhe nga vetë fëmijët e tyre (vajza e djem). Për këtë qëllim u përgatitën edhe dy pyetësorë, përkatësisht për mbledhjen e të dhënave nga prindërit dhe fëmijët.

Përgatitja e pyetësorit për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit nga prindërit, u bazua në instrumentin ndërkombëtar të njohur për këtë qëllim, versionin e shkurtuar të “Pyetësorit për stilet dhe dimensionet e prindërimit” (Parenting Styles and Dimensions Questionnaire – PSDQ, Robinson et al. 2001), i përshtatur për Shqipërinë. Ky pyetësor përmban 12 grupe pyetjesh, 11 nga të cilat synojnë të mbledhin informacion të përgjithshëm demografik, si dhe mbi mënyrën e jetesës familjare (pra nëse flitet për familje të mëdha tradicionale me disa kurorë, apo familje më të vogla, të përbëra vetëm nga prindërit dhe fëmijët e tyre). Kurse pyetja 12 përmban rreth 27 variabla të cilat synojnë të eksplorojnë dimesione të ndryshme kryesisht të sjelljeve “autoritative”, “autoritare” dhe “lejuese” të prindërve, të klasifikuara këto përmes një shkallë matjeje të shpeshtësisë së përdorimit që varion nga 1 (gjithmonë) në 4 (asnjëherë). Secili person që plotëson pyetësorin, pra si nëna ashtu edhe babai i fëmijës u është përgjigjur këtyre 27 variablave për sjelljen / stilin e saj / tij dhe të bashkëshortit / bashkëshortes apo bashkëjetuesit / bashkëjetueses. Të dhënat sasiore nga prindërit u mbledhën në të 12 qarqet e vendit, në një grup prej ***1665 prindërisht, nga të cilët 866 nëna dhe 799 baballarë.***

Paralelisht me prindërit, të dhëna sasiore u mbledhën edhe nga fëmijët vajza dhe djem, kryesisht nxënës të klasave të nënta deri të dymbëdhjeta. Në fakt kampioni i prindërve u zgjodh me logjikën e përzgjedhjes së prindërve të fëmijëve të përfshirë në studim, me qëllim që të mund të bëhej një krahasim i rezultateve mbi stilet e prindërimit në mënyrën se si i perceptojnë fëmijët

stilet e prindërve të tyre, me mënyrën se si këto stile perceptohen edhe nga vetë prindërit. Për mbledhjen e të dhënave nga fëmijët vajza e djem u përgatit një instrument i veçantë (pyetësor) i cili përmban 22 grup pyetjesh nga të cilat 8 të fokusuara tek të dhënat demografike dhe mbi përbërjen e situatën familjare, 6 të fokusuara në eksplorimin e marrëdhënieve që fëmijët deklarorin se kishin me prindërit e tyre dhe 8 të fokusuara në inventarin e lidhjes prindërore, pra të eksplorimit të qëndrimeve dhe sjelljeve të prindërve të fëmijëve gjatë rritjes së tyre, mënyrës së komunikimit, shprehjes së dashurisë, vendosjes së kufijve, ndëshkimit, etj. Ky grup pyetjesh përmban 28 variabla që maten përmes një shkallë matjeje të shpeshtësisë së përdorimit që varion nga 1 (gjithmonë) në 4 (asnjëherë). Të dhënat sasiore nga fëmijët u mbledhën nga **784 pyetësorë të vlefshëm të plotësuar nga nxënëse dhe nxënës të klasave të nënta deri të dymbëdhjeta (422 vajza dhe 362 djem)**.

Në përfshirjen e fëmijëve në studim u mbajtën në konsideratë të gjitha çështjet etike dhe rregullat e nevojshme për këtë qëllim. Kështu, së pari pyetësi i përgatitur për mbledhjen e të dhënave nga fëmijët, u rishikua dhe u miratua nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ndërkohë që për çështjet që lidheshin me të dhënat personale u komunikua dhe u dakordësua edhe me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Me të dy këto institucione është mbajtur korrespondencë e rregullt me shkrim dhe paralelisht me dërgimin e draft pyetësorit për miratim, u dërgua në mënyrë të detajuar edhe përllogaritja e kampionimit të fëmijëve jo vetëm me formulë, por edhe shpërndarja në nivel prefekturë dhe numër nxënësish për çdo grupmoshë, të ndarë edhe sipas gjinisë e zonës urbane apo rurale. Pas miratimit të pyetësorit, u përgatit dhe trajnuar ekipi që do të mblidhte të dhënat në terren, i cili u pajis me të gjitha njohuritë e domosdoshme për tematikën, pyetjet delikate dhe mënyrën e adresimit të tyre, rregullat në intervistimin e një fëmije (të detajuara deri tek rëndësia e intervistimit në një ambjent ku të ndihet i sigurt dhe i lirshëm për të biseduar), etj. Po kështu vëmendje e veçantë iu kushtua paapërgatitjes së ekipit të terrenit për të ditur se si të reagonin nëse do të ndesheshin me një rast të një fëmijë të abuzuar në nevojë për ndihmë dhe se si duhet të adresonin këtë rast. Gjatë gjithë kohës së punës në terren ekipi kishte me vete edhe një informacion të shkruar me numrat e kontaktit të Specialisteve të Mbrojtjes së Fëmijëve në secilën bashki ku u mbledhën të dhënat, të Koordinatorëve Vendorë kundër dhunës në familje, si dhe një listë me numra kontakti të shërbimeve kryesore mbështetëse për trajtimin e rasteve të fëmijëve apo grave të dhunuara. Përpara mbledhjes së të dhënave nga fëmijët, u ndoq dhe procedura e marrjes së miratimit me shkrim të përfshirjes së fëmijës në studim, nga ana e prindërve të tyre, të cilët u sqaruan fillimisht për qëllimin, objektivat dhe metodologjinë e studimit, si dhe për çështje të konfidencialitetit dhe privatësisë në mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe përdorimit të gjetjeve nga të dhënat. Këto sqarime u bënë edhe me vetë

fëmijët pas marrjes së lejes nga prindërit dhe në studim u përfshinë vetëm ata fëmijë që u ndien të gatshëm dhe patën dëshirë, pa u kushtëzuar nga fakti që prindi e kishte miratuar përfshirjen e tyre paraprakisht. Pëlqimi me shkrim për përfshirjen në studim u mor edhe nga të rriturit/riturat për pjesën e të dhënave të mbledhura prej tyre.

Përlllogaritja e kampionimit u bë sipas formulës së Slovin, duke u bazuar tek të dhënat e INSTAT për grupmoshën në fokus (fëmijë të moshës 15 – 19 vjeçare) me një marzh gabimi prej 3.5% dhe nivel konfidence 96.5%. Edhe për mënyrën e shpërndarjes së kampionimit nëpër qarqe u bazuam në të dhënat zyrtare të INSTAT për numrin e popullsisë dhe të fëmijëve të kësaj grupmoshe për vitin 2018, publikuar në janar 2019 (duke qenë se përlllogaritja e kampionimit dhe e gjithë puna filloi në vitin 2019).

Kërkimi cilësor u fokusua specifikisht në intervistat që u zhvilluan me prindërit (të cilët nuk u përfshinë në kërkimin sasior) dhe profesionistët e profesionistët të cilat/cilët punojnë në shkollë me fëmijët, si dhe fokus grupet e zhvilluara me fëmijët (të cilët sërish nuk ishin të përfshirë në kërkimin sasior). Kombinimi i metodës sasiore me atë cilësore ishte i domosdoshëm pasi studimi fokusohet në përshkrimin dhe kuptimin e eksperiencave, perspektivave, mendimeve dhe përjetimeve të grupit të synuar (Creswell, 2003). Për të garantuar thellësi dhe gjerësi në eksplorimin e të gjitha perspektivave, u përdor një kombinim i teknikave të mbledhjes së të dhënave cilësore, përmes intervistave të thelluara (gjysëm të strukturuar) si dhe diskutimeve në grupe të fokusuar. Gjithsej u zhvilluan **28 intervista të thelluara** nga të cilat 21 me prindër dhe 7 me profesioniste e profesionistë si mësuese/mësues apo psikologe/psikologë në shkollë. Po kështu, u zhvilluan **14 diskutime me grupe të fokusuar** me afërsisht 70 vajza dhe djem, të grupmoshës 16 – 18 vjeçare, 5 nga të cilat synuan të evidentonin ndikimin e pandemisë në ndryshimin ose jo të sjelljes së prindërve ndaj tyre, sidomos gjatë kufizimit/mbylljes së detyruar.

Instrumentat e Studimit. Në tërësinë e tyre janë përdorur si instrumenta të studimit dy pyetësorë për mbledhjen e të dhënave sasiore, një strukturë e intervistave dhe një protokoll i detajuar për përmbajtjen dhe strukturën e diskutimeve në grupe të fokusuar. Ekipi i profesionistëve për mbledhjen e të dhënave u trajnuar për moderimin dhe lehtësimin e takimeve përkatëse. Të gjithë instrumentat e përdorur për qëllime të studimit (pyetësorët, struktura e intervistave dhe guida e diskutimit në grupe të fokusuar) u testuan paraprakisht dhe u përmirësuan në bazë të rezultateve të testimit në terren. Në të gjitha rastet janë zbatuar rregullat e etikës në kërkim, duke plotësuar dhe formularin paraprak të pëlqimit për përfshirjen në studim, konform rregullave në varësi të moshës së të intervistuarave/intervistuarve. Të gjithë pjesëmarrëset / pjesëmarrësit në studim u informuan qartë lidhur me qëllimin

dhe objektivat e studimit dhe vendimin për të marrë pjesë vullnetarisht në studim e morën pas informimit të hollësishëm mbi të gjitha aspektet e lidhura me anonimatën dhe konfidencialitetin e studimit.

Kufizimet e studimit. Si çdo studim, edhe ky ka kufizimet e veta, ndër të cilat mund të përmendim:

□ Vështirësitë e krijuara në mbledhjen e të dhënave në kushtet e dy emergjencave të pësura në rang vendi, siç ishin emergjenca civile për shkak të tërmetit të nëntorit 2019 dhe gjendja e fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë së COVID-19, ndikuan drejtpërsëdrejti në nivelin e thellësisë së informacionit dhe arritjes së grupeve të dëshiruara, paralelisht edhe me vonesën në tërësi të zhvillimit të studimit.

□ Ndryshimi që mund të pësojnë sjellje të caktuara të cilat përfshihen sipas studuesve (ndër vite) në katër grupet e stileve të prindërimit.

□ Fakti që versioni i përshtatur i pyetësorit të mbledhjes së informacionit sasior nga prindërit, edhe pse i bazuar në model ndërkombëtar të unifikuar, nuk përmban set pyetjesh të veçanta për të eksploruar edhe stilin e prindit “neglizhues” (që gjithsesi është eksploruar në aspektin cilësor dhe nëpërmjet pyetjeve të drejtuara fëmijëve gjatë mbledhjes së të dhënave sasiorë përmes instrumentit përkatës, ndonëse nuk evidentohen nga fëmijët raste të përdorimit të këtij stili prindërimi)


□ Niveli i ulët i informacionit edhe për grupe të veçanta fëmijësh e prindërisht (të tilla si për personat me aftësi të kufizuara, për minoritetet Rome dhe Egjiptjane, për komunitetin LGBTI+, etj)

□ Niveli i sinjeritetit dhe besueshmërisë së përgjigjeve të dhëna nga të intervistuarat / intervistuarit pavarësisht profesionalizmit të treguar nga intervistueset / intervistuesit.

III. GJETJET NGA ANALIZA E TË DHËNAVE SASIORE DHE CILËSORE.


III.1. ANALIZA SASIORE.

a) Të dhëna të përgjithshme demografike




Grafik 1: Ndarja e prindërve dhe fëmijëve sipas gjinisë

Të dhënat sasiore në lidhje me këtë studim (shih grafikun 1) u mblodhën nga 2449 pyetësorë të vlefshëm të plotësuar nga 1665 prindër (52% nëna dhe 48% baballarë) dhe 784 fëmijë (54% vajza dhe 46% djem).



Grafik 2: Ndarja e prindërve sipas grupmoshës


Në numrin e përgjithshëm të prindërve të intervistuar (grafiku 2), përqindjen më të madhe e zenë prindërit e grupmoshës 35-39 vjeçare (19%) ndjekur nga grupmosha 40-44 vjeçare (16%) dhe 30-34 vjeçare (14%).



Grafik 3: Ndarja e fëmijëve sipas grupmoshës


Në lidhje me fëmijët e përfshirë në studim (grafiku 3), përqindjen më të madhe e zenë ata të grupmoshës 17 vjeçare (36%) të pasuar nga grupmosha 16 vjeçare (30%) dhe 18 vjeçare (20%).

Të pyetur në lidhje me besimin fetar (grafiku 4), 44% e prindërve deklarojnë se janë myslimanë, 21% katolikë, 18% ortodoksë, 5% bektashij, 4% ateistë dhe 8% nuk kanë dhënë përgjigje mbi këtë pyetje.




Grafik 4: Ndarja e prindërve sipas besimit fetar

Përsa i takon etnisë, prindërit pjesëmarrës në studim kanë deklaruar në 92% të tyre se janë shqiptarë, ndërkohë që në një përqindje minimale ka prindër që i përkasin minoritetit Egjiptjan (1%) apo Rom (1.2%). Ndërsa në lidhje me aftësinë e kufizuar vetëm 4.3% e prindërve deklarojnë se kanë problem me shikimin dhe mbajnë lente dhe 1.3% e prindërve kanë vështirësi në dëgjim. 4.4% e prindërve kanë gjithashtu vështirësi në ecje, sidomos në ngjitje, 4.5% e prindërve kanë vështirësi për të mbajtur mend gjërat, si dhe 2.8% e prindërve kanë vështirësi në komunikim.



Grafik 5: Niveli arsimor i prindërve


Përqindja e prindërve të përfshirë në studim (grafiku 5), të pa arsimuar apo me arsim fillor, është e papërfillshme, ndërkohë që 48% e prindërve janë me arsim të mesëm, 39% kanë përfunduar arsimin e lartë, 10% arsimin tetë vjeçar dhe 3% kanë kryer edhe studimet pasuniversitare (64% e të cilëve janë nëna dhe 36% baballarë, të cilët jetojnë më së shumti në zonën urbane të qarqeve Tiranë dhe Durrës).



Grafik 6: Ndarja e prindërve sipas punësimit


Përqindjen më të madhe të prindërve të përfshirë në studim e zenë ata të punësuar me kohë të plotë (46% dhe këtu ka një ndarje thuajse të barabartë si për nënat e punësuar – 49% edhe për baballarët e punësuar – 51%). 27% e prindërve deklarojnë se janë të vetëpunësuar (këtu 59% janë baballarët me këtë status punësimi), ndërsa në totalin e 17% të prindërve që deklarojnë se janë të papunë, 75% janë nëna (grafiku 6).

Ndërsa kur pyeten fëmijët mbi statusin e punësimit të nënës dhe babait të tyre që nga momenti i lindjes së tyre (grafiku 7), rezultojnë se janë nënat më së shumti se baballarët (40% krahasuar me 5%) të cilat kthehen në statusin “të papuna” menjëherë pas lindjes së fëmijëve dhe po kështu janë nënat, të cilat kalojnë më shumë në statusin e punësimit me kohë të pjesshme, që pas lindjes së fëmijëve të tyre.



Grafik 7: Klasifikimi i statusit të punësimit të nënës dhe babait pas lindjes së fëmijëve, sipas vetë fëmijëve pjesëmarrës në studim.

90% e prindërve të përfshirë në studim, në kohën e mbledhjes së të dhënave rezultojnë të martuar, 2.5% bashkëjetojnë, 2.6% janë të divorcuar dhe 3.4% të ve. Vetëm 0.24% (të ndarë përkatësisht në 50% nëna dhe 50% baballarë) deklarojnë se janë të divorcuar dhe bashkëjetojnë me një burrë/grua tjetër.




Grafik 8: Klasifikimi që i bëjnë prindërit e përfshirë në studim statusit ekonomik të familjeve të tyre

52% e prindërve të përfshirë në studim (grafiku 8) i konsiderojnë të ardhurat që fitojnë si të mjaftueshme në aspektin ekonomik të familjeve të tyre, 27% i klasifikojnë familjet e tyre si me të ardhura të pakëta, 12% me të ardhura të pamjaftueshme dhe vetëm 9% me të ardhura të shumta.

Ndërkohë që të pyetur për të njëjtin qëllim, pra për klasifikimin e statusit ekonomik të familjeve të tyre (grafiku 9), fëmijët e përfshirë në studim kanë dhënë këtë opinion: 74% e tyre e përshkruajnë statusin ekonomik të familjeve të tyre si familje me të ardhura të mjaftueshme, 15% me të ardhura të shumta,

7% me të ardhura të pakëta dhe 4% me të ardhura të pamjaftueshme. Sigurisht që ky klasifikim në këndvështrimin e tyre bazohet në plotësimin ose jo nga prindërit të kushteve dhe kërkesave që fëmijët kanë gjatë rritjes, zhvillimit, edukimit, argëtimit, etj., por edhe nga përfshirja që mund t'u jetë bërë nga prindërit në diskutime të tilla të lidhura me situatën financiare të familjes, apo të qenit rastësisht prezentë në diskutimet mes prindërve për situatën e tyre ekonomike.



Grafik 9: Klasifikimi që i bëjnë fëmijët e përfshirë në studim statusit ekonomik të familjeve të tyre

44% e prindërve të përfshirë në studim deklarojnë se familjet e tyre përbëhen nga 4 anëtarë, 35% deklarojnë se familjet e tyre përbëhen nga më shumë se 4 antarë, 19% deklarojnë se familjet e tyre përbëhen nga 3 antarë dhe vetëm 1.2% deklarojnë se familjet e tyre aktualisht përbëhen nga dy antarë (pra momentalisht dy bashkëshortët jetojnë vetëm, pasi fëmijët tashmë të rritur kanë familjet e tyre, ose në 61% të rasteve të këtij totali janë nënat me fëmijët e tyre). Ndërsa në familjet me katër apo më shumë anëtarë, në 10% të tyre prindërit deklarojnë se jetojnë edhe me prindërit e tyre apo të bashkëshortit/ bashkëshortes, ose me nuset e djemve (pra janë familje me disa kurorë).


b) Perceptimet rreth stileve të prindërimit

Eksplorimi i perceptimeve rreth stileve të prindërimit është bërë duke listuar sjellje të ndryshme që karakterizojnë secilin stil prindërimi, si dhe duke pyetur nënat dhe baballarët nëse e kryejnë apo jo një sjellje të tillë ato/ata vetë dhe bashkëshortët apo bashkëshortet e tyre. Kjo ka krijuar mundësinë edhe të një krahasimi rreth mënyrës se si e percepton prindi vetë dhe se si e percepton

bashkëshorti apo bashkëshortja stilin e sjelljes së gjithësecilit/gjithësecilës kundrejt fëmijëve të tyre. Paralelisht janë pyetur edhe fëmijët si në lidhje me marrëdhëniet me prindërit e tyre, ashtu edhe mbi inventarin e lidhjes prind-fëmijë (pra aspekte të ndryshme të sjelljeve të prindërve kundrejt fëmijëve të tyre, përcaktuese në llojin e stilit të prindërimit që përdorin). Gjetjet nga analiza e këtyre të dhënave paraqiten në vijim.


b/1) Eksplorimi mbi stilin autoritativ/demokratik

Vlerësimi mbi perceptimet që kanë prindërit rreth përdorimit ose jo të stilit autoritativ / demokratik si stil prindërimi, është bërë duke i pyetur ata lidhur me tre aspekte karakterizuese të këtij stili: dimensionit të lidhjes (ngrohtësia dhe mbështetja), dimensionit të rregullave (arsyetimi/ndikimi) dhe dimensionit të pavarësisë së dhënë (pjesëmarrja/vendimmarrja demokratike).




Grafik 10: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e lidhjes/stilin autoritativ/demokratik

Sikurse vihet re në grafikun 10, në lidhje me dimensionin e parë të stilit autoritativ, pra dimension i lidhjes: 47% e nënave të përfshira në studim deklarojnë se u përgjigjen “gjithmonë” shqetësimeve dhe nevojave të fëmijëve dhe 42% e tyre mendojnë se edhe babai i fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. 43% e nënave të përfshira në studim deklarojnë se i mirëkuptojnë dhe u krijojnë “gjithmonë” fëmijëve një mjedis të përshtatshëm dhe 32% e tyre mendojnë se edhe babai i fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. 50% e nënave të përfshira në studim deklarojnë se kalojnë momente të ngroha me fëmijët “gjithmonë” dhe 30% e tyre mendojnë se edhe babai i fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. Po kështu, 45% e nënave të përfshira në studim deklarojnë se i inkurajojnë “gjithmonë” fëmijët të flasin dhe 24% e tyre mendojnë se edhe babai i fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në këtë dimension, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh”, si dhe kushtin që konkluzioni mbi aplikimin ose jo të dimensionit të sjelljes të stilit autoritativ përfshin masën e aplikimit të të pesë sjelljeve të eksploruara siç paraqiten të plota në grafikun 10, rezulton se 57.8% e nënave të përfshira në studim, e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit në përputhje me sjelljet e parashikuara në dimensionin e lidhjes së këtij stili dhe 53.63% e nënave të përfshira në studim, vlerësojnë se edhe sjellja e baballarëve të fëmijëve të tyre është në sinkron me sjelljen e tyre, brenda ta njëjtit dimension të stilit autoritativ/demokratik.




Grafik 11: Perceptimi i baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e lidhjes/stili autoritativ/demokratik

Nëse analizojmë të njëjtin dimension të sjelljes por nga këndvështrimi i baballarëve, siç paraqitet edhe në grafikun 11, rezulton se: 32% e baballarëve të përfshirë në studim deklarojnë se u përgjigjen “gjithmonë” shqetësimeve dhe nevojave të fëmijëve dhe 34% e tyre mendojnë se edhe nëna e fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. 28% e baballarëve të përfshirë në studim deklarojnë se i mirëkuptojnë dhe u krijojnë “gjithmonë” fëmijëve një mjedis të përshtatshëm dhe po aq mendojnë se edhe nëna e fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. 29% e baballarëve të përfshirë në studim deklarojnë se kalojnë momente të ngroha me fëmijët “gjithmonë” dhe 31% e tyre mendojnë se edhe nëna e fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. Po kështu, 25% e baballarëve të përfshirë në studim deklarojnë se i inkurajojnë “gjithmonë” fëmijët të flasnin dhe 31% e tyre mendojnë se edhe nëna e fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në këtë dimension, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” rezulton se 56.2% e baballarëve e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit në përputhje me sjelljet e parashikuara në dimensionin e lidhjes së këtij stili dhe 64.2% e baballarëve të përfshirë në studim, vlerësojnë se edhe sjellja e nënave të fëmijëve të tyre është në përputhje me sjelljet e parashikuara në dimensionin e lidhjes të stilit autoritativ/demokratik.




Grafik 12: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e rregullave/stili autoritativ/demokratik

Nga analiza e përgjigjeve të dhëna nga nënat përse i takon mënyrës se si i klasifikojnë ato sjelljet e tyre duke i krahasuar me sjelljet e përfshira në dimensionin e rregullave të stilit autoritativ (gafiku 12), rezultojnë se: 45% e nënave të përfshira në studim deklarojnë se u shpjegojnë “gjithmonë” fëmijëve pasojat e sjelljes dhe 28% e tyre mendojnë se edhe babai i fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. 42% e nënave të përfshira në studim deklarojnë se i sqarojnë “gjithmonë” fëmijët dhe 23% e tyre mendojnë se edhe babai i fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. 42% e nënave të përfshira në studim deklarojnë se “gjithmonë” u shpjegojnë fëmijëve se si ndjehen për shkak të sjelljes së tyre dhe 25% e nënave mendojnë se edhe babai i fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. Po kështu, 32% e nënave të përfshira në studim deklarojnë se u theksojnë “gjithmonë” fëmijëve arsyet se përse vendosin rregulla të caktuara dhe 18% e tyre mendojnë se edhe babai i fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në këtë dimension, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” rezultojnë se 80.6% e nënave e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit në përputhje me sjelljet e parashikuara në dimensionin e rregullave të këtij stili dhe 55% e nënave të përfshira në studim, vlerësojnë se edhe sjellja e baballarëve të fëmijëve të tyre është në sinkron me sjelljen e tyre, brenda të njëjtit dimension të stilit autoritativ/demokratik.




Grafik 13: Perceptimi i baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e rregullave/stili autoritativ/demokratik.

Ndërsa, siç paraqitet në grafikun 13 më sipër, 25% e baballarëve të përfshirë në studim deklarojnë se u shpjegojnë “gjithmonë” fëmijëve pasojat e sjelljes dhe 34% e tyre mendojnë se nëna e fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. 29% e baballarëve të përfshirë në studim deklarojnë se i sqarojnë “gjithmonë” fëmijët dhe po aq mendojnë se edhe nëna e fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. 28% e baballarëve të përfshirë në studim deklarojnë se “gjithmonë” u shpjegojnë fëmijëve se si ndjehen për shkak të sjelljes së tyre dhe 30% e baballarëve mendojnë se edhe nëna e fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. Po kështu, 22% e baballarëve të përfshirë në studim deklarojnë se u theksojnë gjithmonë “fëmijëve” arsyet se përse vendosin rregulla të caktuara dhe 18% e tyre mendojnë se edhe nëna e fëmijës sillet në të njëjtën mënyrë. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në këtë dimension, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” rezulton se 67.6% e baballarëve e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit në përputhje me sjelljet e parashikuara në dimensionin e rregullave të këtij stili dhe 68.8% e baballarëve të përfshirë në studim, vlerësojnë se edhe sjellja e nënave të fëmijëve të tyre është në sinkron me sjelljet e dimensionit të rregullave të stilit autoritativ/demokratik.



Grafik 14: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e pavarësisë / stili autoritativ/demokratik

Nga analiza e të dhënave të marra mbi dimensionin e pavarësisë të stilit autoritativ dhe mënyrën se si i klasifikojnë nënat sjelljet e tyre në përputhje me parashikimet për sjelljet brenda këtij dimension (grafiku 14), rezulton se: 36% e nënave tregojnë “gjithmonë” respekt për opinionet e fëmijëve të tyre dhe 25% e nënave të përfshira në studim mendojnë se edhe baballarët e fëmijëve të tyre sillen “gjithmonë” në të njëjtën mënyrë. Po kështu, 22% e nënave të përfshira në studim deklarojnë se e lejojnë “gjithmonë” fëmijën të japë kontribut në vendosjen e rregullave dhe 15% e tyre mendojnë se edhe baballarët e fëmijëve sillen “gjithmonë” në të njëjtën mënyrë. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në këtë dimension, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” rezulton se 63% e nënave e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit në përputhje me sjelljet e parashikuara në dimensionin e pavarësisë të këtij stili dhe 50.6% e nënave të përfshira në studim, vlerësojnë se edhe sjellja e baballarëve të fëmijëve të tyre është në sinkron me sjelljet e dimensionit të pavarësisë së stilit autoritativ/demokratik.



Grafik 15: Perceptimi i baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e pavarësisë/stili autoritativ/demokratik


Siç shihet edhe në grafikun 15, nga analiza e përgjigjeve të baballarëve mbi sjelljet e përfshira në dimensionin e pavarësisë së stilit autoritativ rezulton se: 27% e baballarëve tregojnë “gjithmonë” respekt për opinionet e fëmijëve të tyre dhe 26% e baballarëve të përfshirë në studim mendojnë se edhe nënat e fëmijëve të tyre sillen “gjithmonë” në të njëjtën mënyrë. Po kështu, 13% e baballarëve të përfshirë në studim deklarojnë se e lejojnë “gjithmonë” fëmijën të japë kontribut në vendosjen e rregullave dhe 12% e tyre mendojnë se edhe nënat e fëmijëve sillen “gjithmonë” në të njëjtën mënyrë. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në këtë dimension, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” rezulton se *60% e baballarëve e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit në përputhje me sjelljet e parashikuara në dimensionin e pavarësisë të këtij stili dhe 60.2% e baballarëve të përfshirë në studim, vlerësojnë se edhe sjellja e nënave të fëmijëve të tyre është në sinkron me sjelljet e dimensionit të pavarësisë së stilit autoritativ/demokratik.*

STILI AUTORITATIV/ DEMOKRATIK					
Aplikimi i secilit dimension nga nëna dhe babai		Dimensioni i lidhjes	Dimensioni i rregullave	Dimensioni i pavarësisë	
Nëna	Perceptimi i vetë nënës mbi sjelljen e saj	57.8%	80.6%	63%	% e nënave që përdorin stilin autoritativ
	Perceptimi i babait mbi sjelljen e saj	64.2%	68.8%	60.2%	
	<i>% e nënave që respektojnë këtë dimension</i>	61%	74.7%	61.6%	65.7%
Babai	Perceptimi i vetë babait mbi sjelljen e tij	56.2%	67.6%	60%	% e baballarëve që përdorin stilin autoritativ
	Perceptimi i nënës mbi sjelljen e tij	53.6%	55%	50.6%	
	<i>% e baballarëve që respektojnë këtë dimension</i>	54.9%	61.3%	55.3%	57.1%

Tabela 1: Përqindja e nënave dhe baballarëve që e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit si autoritativ/demokratik

Bazuar në gjetjet nga analiza e tre aspekte karakterizuese të stilit autoritativ, konkretisht: dimensionit të lidhjes (ngrohtësia dhe mbështetja), dimensionit të rregullave (arsyetimi/ndikimi) dhe dimensionit të pavarësisë së dhënë fëmijëve (pjesëmarrja/vendimmarrja demokratike), rezulton se **65.7% e nënave dhe 57.1% e baballarëve të përfshirë në studim e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit si stil autoritativ.**

Sa më sipër është eksploruar më tej edhe nga përgjigjet e dhëna nga fëmijët në analizën e inventarit të lidhjes prindërore, mbi sjelljet dhe qëndrimet e prindërve karshi tyre, për ata elementë që më së shumti përkojnë me stilit autoritativ të prindërimit, duke pasur parasysh të tre dimensionet e këtij stili, siç u analizuan më sipër. Nga analiza e të dhënave sasiore, rezulton se dimensionin e lidhjes së stilit autoritativ aplikohet nga 74.6% e nënave dhe 65.2% e baballarëve. Kjo gjetje bazohet në frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në këtë dimension, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” të të pesë pyetjeve të paraqitura në grafikun 16 në vijim.




Grafik 16: Perceptimi i fëmijëve mbi sjelljet që karakterizojnë dimensionin e lidhjes së stilit autoritativ/demokratik të prindërve të tyre


Me të njëjtën logjikë si më sipër, për dimensionin e rregullave të stilit autoritativ, nga përgjigjet e dhëna nga fëmijët rezulton se 74.5% e nënave dhe 67.5% e baballarëve sillen në përputhje me dimensionet e këtij stili (shiko për detaje grafikun 17) dhe përsa i takon dimensionit të pavarësisë, 59.5% e nënave dhe 49.5 % e baballarëve sipas përgjigjeve të fëmijëve të tyre sillen në përputhje me këtë dimension të stilit autoritativ (shiko grafikun 18). Të përmbledhura të tre rezultatet jepen në tabelën 2 më poshtë:

STILI AUTORITATIV/DEMOKRATIK				
Aplikimi i secilit dimension nga nëna dhe babai	Dimensioni i lidhjes	Dimensioni i rregullave	Dimensioni i pavarësisë	% e prindërve (nëna/babai) që përdorin stilin autoritativ
Nëna	74.6%	74.5%	59.5%	69.5%
Babai	65.2%	67.5%	49.5%	60.7%

Tabela 2: Perceptimi i fëmijëve mbi stilin autoritativ/demokratik që ushtron nëna dhe babai në rritjen e tyre



Grafik 17: Perceptimi i fëmijëve mbi sjelljet që karakterizojnë dimensionin e rregullave të stilit autoritativ/demokratik të prindërve të tyre




Grafik 18: Perceptimi i fëmijëve mbi sjelljet që karakterizojnë dimensionin e pavarësisë së stilit autoritativ/demokratik të prindërve të tyre

Pra nga përgjigjet e fëmijëve dhe mënyra se si e perceptojnë ata stilin e prindërimit të nënave dhe baballarëve, rezultojnë se 69.5% e nënave (përkundëjt 65.7% e nënave sipas rezultatit të përgjigjeve nga prindërit) dhe 60.7% e baballarëve (përkundëjt 57.1% e baballarëve sipas rezultatit të përgjigjeve nga prindërit) përdorin stilin autoritariv të prindërimit me fëmijët e tyre.

b/2) Eksplorimi mbi stilin autoritar


Vlerësimi mbi perceptimet që kanë prindërit rreth përdorimit ose jo të stilit autoritar si stil prindërimi, është bërë duke i pyetur ata lidhur me tre aspekte karakterizuese të këtij stili: dimensionin e ndëshkimit fizik, dimensionin verbal të konfliktit dhe dimensionin e ndëshkimit pa shpjegim. Gjetjet nga analiza e të dhënave sasiore në këtë drejtim, jepen në vijim.



Grafik 19: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e ndëshkimit fizik / stili autoritar

Sikurse paraqitet edhe në grafikun 19, vetëm **10% e nënave** pohojnë se e përdorin ndëshkimin fizik si mënyrë të disiplinimit të fëmijëve të tyre “gjithmonë” ose “shpesh” dhe 9% e nënave pohojnë se edhe baballarët e fëmijëve të tyre e përdorin të njëjtin ndëshkim me fëmijët. Ndërkohë që 35% e nënave deklarojnë se e përdorin ndëshkimin fizik “rrallë” dhe në të njëjtën përqindje janë nënat që pohojnë se edhe baballarët e fëmijëve të tyre sillen në të

njëjtën mënyrë. Kur detajohet më pas se çfarë përfshihet në ndëshkimin fizik, vihet re se “një shuplakë vitheve” përdoret “gjithmonë” ose “shpesh” nga 17% e nënave dhe 10% e tyre pohojnë se këtë veprim e kryejnë edhe baballarët e fëmijëve të tyre. Po kështu, “ca shpulla të mira” përdoren “gjithmonë” ose “shpesh” nga 11% e nënave dhe sipas pohimit të 8% të nënave edhe nga baballarët e fëmijëve të tyre, ndërsa 6% e nënave “e mbërthejnë/shkundin fëmijën kur nuk bindet” dhe 5% e nënave pohojnë se këtë sjellje e bëjnë edhe baballarët e fëmijëve të tyre. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në këtë dimension, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” rezulton se *10.75% e nënave e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit në përputhje me sjelljet e parashikuara në dimensionin e ndëshkimit fizik të stilit autoritar të prindërimit dhe 8% e nënave të përfshira në studim, vlerësojnë se edhe sjellja e baballarëve të fëmijëve të tyre është në sinkron me sjelljet e dimensionit të ndëshkimit fizik të stilit autoritar.*




Grafik 20: Perceptimi i baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e ndëshkimit fizik / stili autoritar

Nga grafiku 20 shihet se, vetëm **9% e baballarëve** pohojnë se e përdorin ndëshkimin fizik si mënyrë të disiplinimit të fëmijëve të tyre “gjithmonë” ose “shpesh” dhe 18% e baballarëve pohojnë se edhe nënat e fëmijëve të tyre e përdorin të njëjtin ndëshkim me fëmijët. Ndërkohë që 41% e baballarëve deklarojnë se e përdorin ndëshkimin fizik “rrallë” dhe 47% e baballarëve pohojnë se edhe nënat e fëmijëve të tyre sillen në të njëjtën mënyrë. “Një


shuplakë vitheve” përdoret “gjithmonë” ose “shpesh” nga 17% e baballarëve dhe 8% e tyre pohojnë se këtë veprim e kryejnë edhe nënat e fëmijëve të tyre. Po kështu, “ca shpulla të mira” përdoren “gjithmonë” ose “shpesh” nga 8% e baballarëve dhe sipas pohimit të 9% të baballarëve kjo përdoret edhe nga nënat e fëmijëve të tyre. 4% e baballarëve “e mbërthejnë/shkundin fëmijën kur nuk bindet” dhe 5% e baballarëve pohojnë se këtë sjellje e bëjnë edhe nënat e fëmijëve të tyre. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në këtë dimension, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” rezulton se *9.25% e baballarëve e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit në përputhje me sjelljet e parashikuara në dimensionin e ndëshkimit fizik të stilit autoritar të prindërimit dhe 9.75% e baballarëve të përfshirë në studim, vlerësojnë se edhe sjellja e nënave të fëmijëve të tyre është në sinkron me sjelljet e dimensionit të ndëshkimit fizik të stilit autoritar.*

Në lidhje me dimensionin verbal të konfliktit të stilit autoritar, nga përpunimi të dhënave rezulton se (grafiku 21): **10% e nënave** pohojnë se shpërthejnë me zemërim kundrejt fëmijëve të tyre “gjithmonë” ose “shpesh” dhe 6% e nënave pohojnë se edhe baballarët e fëmijëve të tyre kanë të njëjtën sjellje. 30% e nënave bërtasin ose ulërijnë kur fëmija sillet keq “gjithmonë” ose “shpesh” dhe 26% e tyre pohojnë se këtë veprim e kryejnë edhe baballarët e fëmijëve të tyre. 81% e nënave pohojnë se e kritikojnë fëmijën që të përmirësojë sjelljen “gjithmonë” ose “shpesh” dhe sipas pohimit të 59% të nënave kjo mënyrë përdoret edhe nga baballarët e fëmijëve të tyre. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në këtë dimension, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” rezulton se *50% e nënave e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit në përputhje me sjelljet e parashikuara në dimensionin verbal të konfliktit të stilit autoritar të prindërimit dhe 37% e nënave të përfshira në studim, vlerësojnë se edhe sjellja e baballarëve të fëmijëve të tyre është në sinkron me sjelljet e dimensionit verbal të konfliktit të stilit autoritar.*




Grafik 21: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi dimensionin verbal të konfliktit / stili autoritar

Në lidhje me po të njëjtin dimension të stilit autoritar, nga përpunimi i të dhënave sasiore nga përgjigjet e baballarëve (grafiku 22) rezulton se: **7% e baballarëve** pohojnë se shpërthejnë me zemërim kundrejt fëmijëve të tyre “gjithmonë” ose “shpesh” dhe në të njëjtën përqindje baballarët pohojnë se edhe nënat e fëmijëve të tyre kanë të njëjtën sjellje. 29% e baballarëve bërtasin ose ulërijnë kur fëmija sillet keq “gjithmonë” ose “shpesh” dhe 23% e tyre pohojnë se këtë veprim e kryejnë edhe nënat e fëmijëve të tyre. 77% e baballarëve pohojnë se e kritikojnë fëmijën që të përmirësojë sjelljen “gjithmonë” ose “shpesh” dhe sipas pohimit të 70% të tyre, kjo mënyrë përdoret edhe nga nënat e fëmijëve të tyre. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në këtë dimension, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” rezulton se 46.5% e baballarëve e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit në përputhje me sjelljet e parashikuara në dimensionin verbal të konfliktit të stilit autoritar dhe 42% e baballarëve të përfshirë në studim, vlerësojnë se edhe sjellja e nënave të fëmijëve të tyre është në sinkron me sjelljet e dimensionit verbal të konfliktit të stilit autoritar.



Grafik 22: Perceptimi i baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi dimensionin verbal të konfliktit / stili autoritar


Në lidhje me dimensionin e tretë të stilit autoritar që ka të bëjë me ndëshkimin pa dhënë shpjegim, gjetjet nga përpunimi i të dhënave sasiore evidentojnë se (grafiku 23): 18% e nënave pohojnë se e ndëshkojnë fëmijën duke i hequr privilegje “gjithmonë” ose “shpesh” dhe po aq përqind e tyre pohojnë se edhe baballarët e fëmijëve të tyre kanë të njëjtën sjellje. 40% e nënave përdorin kërcënimin si ndëshkim “gjithmonë” ose “shpesh” dhe 42% e tyre pohojnë se këtë veprim e kryejnë edhe baballarët e fëmijëve të tyre. 6% e nënave pohojnë se e mbyllin fëmijën diku vetëm, si ndëshkim “gjithmonë” ose “shpesh” dhe po në të njëjtën përqindje janë nënat që pohojnë se kjo mënyrë përdoret edhe nga baballarët e fëmijëve të tyre. 17% e nënave përdorin frazën “Se kështu them unë!” “gjithmonë” ose “shpesh” nëse fëmija i tyre kërkon shpjegim përse duhet të bierë dakord me diçka dhe në të njëjtën përqindje janë nënat që pohojnë përdorimin e të njëjtës frazë edhe nga baballarët e fëmijëve të tyre. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në këtë dimension, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” rezultojnë se 20.25% e nënave e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit në përputhje me sjelljet e parashikuara në dimensionin e ndëshkimit pa shpjegim të stilit autoritar të prindërimit dhe 20.5% e nënave të përfshira në studim, vlerësojnë se edhe sjellja e baballarëve të fëmijëve të tyre është në sinkron me sjelljet e dimensionit të ndëshkimit pa shpjegim të stilit autoritar.



Grafik 23: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e ndëshkimit pa shpjegim / stili autoritar

Siç paraqitet edhe në grafikun 24 në vijim, 13% e baballarëve pohojnë se e ndëshkojnë fëmijën duke i hequr privilegje “gjithmonë” ose “shpesh” dhe 11% e tyre pohojnë se edhe nënat e fëmijëve të tyre kanë të njëjtën sjellje. 37% e baballarëve përdorin kërcënimin si ndëshkim “gjithmonë” ose “shpesh” dhe 38% e tyre pohojnë se këtë veprim e kryejnë edhe nënat e fëmijëve të tyre. 6% e baballarëve pohojnë se e mbyllin fëmijën diku vetëm, si ndëshkim “gjithmonë” ose “shpesh” dhe 3% e tyre pohojnë se kjo mënyrë përdoret edhe nga nënat e fëmijëve të tyre. 15% e baballarëve përdorin frazën “Se kështu them unë!” “gjithmonë” ose “shpesh” nëse fëmija i tyre kërkon shpjegim përse duhet të bierë dakord me diçka dhe 13% e tyre pohojnë përdorimin e të njëjtës frazë edhe nga nënat e fëmijëve të tyre. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në këtë dimension, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” rezulton se 17.75% e baballarëve e

klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit në përputhje me sjelljet e parashikuara në dimensionin e ndëshkimit pa shpjegim të stilit autoritar të prindërimit dhe 16.25% e baballarëve të përfshirë në studim, vlerësojnë se edhe sjellja e nënave të fëmijëve të tyre është në sinkron me sjelljet e dimensionit të ndëshkimit pa shpjegim të stilit autoritar.



Grafik 24: Perceptimi baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi dimensionin e ndëshkimit pa shpjegim / stili autoritar


Bazuar në gjetjet nga analiza e të dhënave sasiore mbi sjelljet që përdorin prindërit në të tre dimensionet e stilit autoritar, konkretisht në dimensionin e ndëshkimit fizik, dimensionin verbal të konfliktit dhe dimensionin e ndëshkimit pa shpjegim, rezulton se **24.8% e nënave dhe 23.15% e baballarëve të përfshirë në studim përdorin stilin autoritar të prindërimit.**

STILI AUTORITAR					
Aplikimi i secilit dimension nga nëna dhe babai		Dimensioni i ndëshkimit fizik	Dimensioni verbal i konfliktit	Dimensioni i ndëshkimit pa shpjegim	% e nënave që përdorin stilin autoritar
Nëna	Perceptimi i vetë nënës mbi sjelljen e saj	10.75%	50%	20.25%	
	Perceptimi i babait mbi sjelljen e saj	9.75%	42%	16.25%	
	% e nënave që respektojnë këtë dimension	10.25%	46%	18.25%	
					24.8%

Babai	Perceptimi i vetë babait mbi sjelljen e tij	9.25%	46.5%	17.75%	% e baballarëve që përdorin stilin autoritar
	Perceptimi i nënës mbi sjelljen e tij	8%	37%	20.5%	
	<i>% e baballarëve që respektojnë këtë dimension</i>	<i>8.6%</i>	<i>41.75%</i>	<i>19.1%</i>	<i>23.15%</i>

Tabela 3: Përqindja e nënave dhe baballarëve që e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit si autoritar

Nga përgjigjet e fëmijëve të përfshirë në studim, në lidhje me pyetjet mbi të tre dimensionet e stilit autoritar të prindërimit, rezultoi se 9% e nënave dhe 11% e baballarëve i godasin fëmijët e tyre “gjithmonë” ose “shpesh” kur fëmijët sillen keq; 22% e nënave dhe 17% e baballarëve dhunojnë privatësinë e fëmijëve “gjithmonë” ose “shpesh” dhe 45% e nënave e 32% e baballarëve mundohen të kontrollojnë çdo gjë që fëmijët bëjnë “gjithmonë” ose “shpesh”.



Grafik 25: Perceptimi i fëmijëve mbi sjelljet që karakterizojnë tre dimensionet e stilit autoritar të prindërve të tyre

Nga përgjigjet e fëmijëve dhe mënyra se si e perceptojnë ata stilin e prindërimit të nënave dhe baballarëve (tabela 4), rezultojnë se 25.3% e nënave (përkundëjt 24.8% e nënave sipas rezultatit të përgjigjeve nga prindërit) dhe 20% e baballarëve (përkundëjt 23.15% e baballarëve sipas rezultatit të përgjigjeve nga prindërit) përdorin stilin autoritar të prindërimit me fëmijët e tyre.

STILI AUTORITAR				
Aplikimi i secilit dimension nga nëna dhe babai	Dimensioni i ndëshkimit fizik	Dimensioni verbal i konfliktit	Dimensioni i ndëshkimit pa shpjegim	% e prindërve (nëna/babai) që përdorin stilin autoritar
Nëna	9%	22%	45%	25.3%
Babai	11%	17%	32%	20%


Tabela 4: Perceptimi i fëmijëve mbi stilin autoritar që ushtron nëna dhe babai në rritjen e tyre

c) Eksplorimi mbi stilin lejues/tolerant

Stili lejues/tolerant i prindërimit është vlerësuar përmes pyetjeve mbi sjelljet e caktuara që përmbajnë dimensionin e lejimit apo tolerancës së pamasë. Gjetjet nga përgjigjet e prindërve dhe të fëmijëve në lidhje me këtë stil prindërimi renditen në vijim.

Siç shihet dhe nga grafiku 26 më poshtë, 10% e nënave “gjithmonë” ose “shpesh” vendosin apo më saktë artikulojnë ndëshkime për fëmijët e tyre por në të vërtetë nuk i zbatojnë ato dhe 6% e nënave pohojnë se në të njëjtën mënyrë sillen edhe baballarët e fëmijëve të tyre. 7% e nënave “gjithmonë” ose “shpesh” kërcënojnë me shumë më tepër ndëshkim sesa u japin në të vërtetë fëmijëve dhe 6% e nënave pohojnë se po kështu sillen edhe baballarët e fëmijëve të tyre. 7% e nënave pohojnë se “gjithmonë” ose “shpesh” dorëzohen përpara fëmijëve kur ata rebelohen dhe 6% e nënave pohojnë të njëjtën mënyrë sjelljeje edhe të baballarëve të fëmijëve të tyre. 7% e nënave pohojnë se e kanë shumë të vështirë të disiplinojnë fëmijët e tyre në më të shumtën e kohës dhe 5% e nënave pohojnë se në të njëjtën situatë janë edhe baballarët e fëmijëve të tyre. 16% e nënave pohojnë se “gjithmonë” ose “shpesh” i mësojnë keq fëmijët me llastimet që u bëjnë dhe 18% e nënave pohojnë se të njëjtën sjellje kanë edhe baballarët e fëmijëve të tyre. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në stilin lejues, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” rezultojnë se 9.4% e nënave e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit lejues/tolerant dhe 8% e


nënave të përfshira në studim, vlerësojnë se edhe sjellja e baballarëve të fëmijëve të tyre është në sinkron me stilin lejues/tolerant



Grafik 26: Perceptimi i nënave për sjelljet e tyre dhe të baballarëve të fëmijëve të tyre mbi stilin lejues/tolerant

12% e baballarëve siç shihet dhe në grafikun 27 në vijim, “gjithmonë” ose “shpesh” artikulojnë ndëshkime për fëmijët e tyre por nuk i zbatojnë ato dhe 6% e baballarëve pohojnë se në të njëjtën mënyrë sillen edhe nënat e fëmijëve të tyre. 8% e baballarëve “gjithmonë” ose “shpesh” kërcënojnë me shumë më tepër ndëshkim sesa u japin në të vërtetë fëmijëve dhe 6% e baballarëve pohojnë se po kështu sillen edhe nënat e fëmijëve të tyre. 6% e baballarëve pohojnë se “gjithmonë” ose “shpesh” dorëzohen përpara fëmijëve kur ata rebelohen dhe 5% e tyre pohojnë të njëjtën mënyrë sjelljeje edhe të nënave të fëmijëve të tyre. 5% e baballarëve pohojnë se e kanë shumë të vështirë të dispijnojnë fëmijët e tyre në më të shumtën e kohës dhe 4% e tyre pohojnë se në të njëjtën situatë janë edhe nënat e fëmijëve të tyre. 18% e baballarëve pohojnë se “gjithmonë” ose “shpesh” i mësojnë keq fëmijët me llastimet që u bëjnë dhe 18% e tyre pohojnë se të njëjtën sjellje kanë edhe nënat e fëmijëve të tyre. Duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të sjelljeve të përfshira në stilin lejues, bazuar në variablat “gjithmonë” dhe “shpesh” rezulton se 12% e baballarëve e klasifikojnë stilin e tyre të prindërimit lejues/tolerant dhe 10.6% e baballarëve të përfshirë në studim, vlerësojnë se edhe

sjellja e nënave të fëmijëve të tyre është në sinkron me stilin lejues/tolerant.




Grafik 27: Perceptimi i baballarëve për sjelljet e tyre dhe të nënave të fëmijëve të tyre mbi stilin lejues/tolerant

Bazuar në gjetjet nga analiza e të dhënave sasiore mbi sjelljet që përdorin prindërit rezulton se **8.6% e nënave dhe 8.9% e baballarëve të përfshirë në studim përdorin stilin lejues/tolerant të prindërimit.**

STILI LEJUES/TOLERANT			% e nënave që përdorin stilin lejues / tolerant
Nëna	Perceptimi i vetë nënës mbi sjelljen e saj	9.4%	
	Perceptimi i babait mbi sjelljen e saj	7.8%	
	% e nënave që respektojnë këtë dimension		
Babai	Perceptimi i vetë babait mbi sjelljen e tij	9.8%	% e baballarëve që përdorin stilin lejues / tolerant
	Perceptimi i nënës mbi sjelljen e tij	8%	
	% e baballarëve që respektojnë këtë dimension		8.9%

Tabela 5: Perceptimi i fëmijëve mbi stilin lejues/tolerant që ushtron nëna dhe babai në rritjen e tyre

Ndërsa vetë fëmijët kanë dhënë këto përgjigje për pyetjet mbi sjelljet e prindërve që përkojnë më shumë me stilin lejues të prindërimit: 4% e nënave dhe 6% e baballarëve “gjithmonë” ose “shpesh” u kanë dhënë atyre aq liri sa kanë dashur dhe 5% e nënave e 7% e baballarëve i kanë lënë fëmijët “gjithmonë” ose “shpesh” të dalin sa herë ata kanë dashur (grafiku 28).



Grafik 28: Perceptimi i fëmijëve mbi sjelljet që karakterizojnë stilin lejues/tolerant të prindërve të tyre


Pra, nga përgjigjet e fëmijëve dhe mënyra se si e perceptojnë ata stilin e prindërimit të nënave dhe baballarëve rezulton se 4.5% e nënave (përkundrejt 8.6% e nënave sipas rezultatit të përgjigjeve nga prindërit) dhe 6.5% e baballarëve (përkundrejt 8.9% e baballarëve sipas rezultatit të përgjigjeve nga prindërit) përdorin stilin lejues/tolerant të prindërimit me fëmijët e tyre.

Nga sa më sipër, të dhënat sasiore të mbledhura për efekt studimi na tregojnë se perceptimi që kanë vetë prindërit për stilin e prindërimit që përdorin në edukimin e fëmijëve të tyre, si dhe perceptimi që kanë fëmijët e tyre për stilet e prindërimit që aplikojnë prindërit e tyre, sugjerojnë këtë grupim sipas stileve të prindërimit:

Stilet e prindërimit	Perceptimi sipas vetë prindërve			Perceptimi sipas fëmijëve të tyre		
	Autoritativ/demokratik	Autoritar	Lejues/tolerant	Autoritativ/demokratik	Autoritar	Lejues/tolerant
Nëna	65.7%	24.8%	8.6%	69.5%	25.3%	4.5%
Babai	57.1%	23.15%	8.9%	60.7%	20%	6.5%

Tabela 6: Përqindja e prindërve klasifikuar sipas stileve të prindërimit që përdorin, bazuar në perceptimet e tyre dhe të fëmijëve të tyre


Duke përmbledhur perceptimet e prindërve dhe të vetë fëmijëve, rezulton se në kampionimin e përfshirë në studim prej 1665 prindëris (866 nëna dhe 799 baballarë) janë **67.6% nëna dhe 58.9% baballarë të cilët përdorin stilin autoritativ/demokratik të prindërimit; 25.05% nëna dhe 21.57% baballarë të cilët përdorin stilin autoritar të prindërimit; si dhe 6.55% nëna dhe 7.7% baballarë të cilët përdorin stilin lejues/tolerant të prindërimit.**



Grafik 29: Perceptimi i djemve për marrëdhëniet me prindërit e tyre

Grafikët 29 dhe 30 paraqesin dallimet në marrëdhëniet prind – fëmijë për shkak të diferencave gjinore. Siç vihet re, këto dallime bëhen më të dukshme kur flitet për çështje sensitive apo deri diku edhe ende “tabu” siç është

diskutimi mbi shëndetin seksual e riprodhues. Këto marrëdhënie dhe dallimet gjinore përkatëse, eksplorohehen më tej dhe në analizën e të dhënave cilësore të mbledhura për efekt të këtij studimi.



Grafik 30: Perceptimi i vajzave për marrëdhëniet me prindërit e tyre

60% e djemve dhe 52% e vajzave deklarojnë se më së shumti e kalojnë kohën me të dy prindërit.

Pothuajse gjysma e fëmijëve të përfshirë në studim deklarojnë se janë ndier

njëlloj të afërt me të dy prindërit e tyre gjatë rritjes (52% e djemve dhe 50% e vajzave), 45% e djemve dhe 44% e vajzave gjithashtu deklarojnë se të dy prindërit janë kujdesur gjatë rritjes së tyre (pavarësisht se eksplorimi i mëtejshëm i llojit të përkujdesit të ofruar është bërë në pjesën e kërkimit cilësor, ku evidentohen më mirë se cilat detyra dhe përgjegjësi kanë mbuluar secili prind në familje për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve).

50% e djemve dhe 48% e vajzave deklarojnë se kanë luajtur me të dy prindërit në fëmijëri. 50% e djemve dhe 46% e vajzave deklarojnë se kalojnë kohë me të dy prindërit dhe 60% e djemve e 62% e vajzave dëshirojnë të vijnë të kalojnë kohë me të dy prindërit.

Gjithashtu, 59% e djemve dhe 57% e vajzave pohojnë se të dy prindërit kanë kaluar kohë cilësore me ta. Të gjitha këto pohime shkojnë pak a shumë në linjë me gjetjet e mësipërme ku mbi gjysma e prindërve u klasifikuan se përdorin stilin autoritativ/demokratik të prindërimit.

Kur diskutohet mbi ndëshkimin (në tërësi), 16% e djemve dhe 18% e vajzave pohojnë se të dy prindërit i ndëshkojnë, ndërkohë që 24% e vajzave dhe 15% e djemve pohojnë se i ndëshkon më shumë nëna dhe 8% e vajzave e 12% e djemve pohojnë se i ndëshkon më shumë babai. Kurse në lidhje me përdorimin e ndëshkimit fizik, 15% e djemve dhe 12% e vajzave pohojnë se këtë lloj ndëshkimi e përdorin të dy prindërit, 3% e djemve dhe po aq e vajzave pohojnë se ndëshkimin fizik e përdor më shumë nëna dhe 6% e djemve e 1% e vajzave pohojnë se ndëshkimin fizik e përdor më shumë babai.

Ndërsa 42% e djemve pohojnë se ndihen të afërt me të dy prindërit për të diskutuar mbi shqetësimet e tyre personale, kjo afërsi me të dy prindërit bie në 27% tek vajzat. 26% e djemve dhe 53% e vajzave ndihen më të afërt/afërta të diskutojnë mbi shqetësimet e tyre personale me nënën dhe 11% e djemve e 5% e vajzave ndihen më të afërt/afërta për të diskutuar me baballarët për shqetësimet e tyre personale.

30% e djemve pohojnë se të dy prindërit u kanë folur në fëmijëri për trupin e tyre dhe zhvillimin biologjik, ndërkohë që vetëm 9% e vajzave pohojnë që këtë bisedë ta kenë bërë me të dy prindërit. 64% e vajzave pohojnë se këtë bisedë e ka bërë me to nëna dhe po kështu pohojnë dhe 24% e djemve. 3% e vajzave dhe 11% e djemve pohojnë se më shumë për zhvillimin e tyre u ka folur babai ndërkohë që 14% e vajzave dhe 21% e djemve pohojnë se asnjëri nga prindërit nuk e ka hapur këtë temë gjatë rritjes e zhvillimit të tyre.

Diferenca në ndarjen apo mosdhënien e informacionit nga ana e prindërve për fëmijët e tyre, rritet veçanërisht kur flitet për të diskutuar mbi shëndetin seksual e riprodhues të tyre. Kështu 48% e djemve dhe 27% e vajzave pohojnë

se nuk diskutojnë me asnjërin nga prindërit mbi këtë tematikë, 10% e djemve dhe 49% e vajzave pohojnë se diskutojnë më shumë me nënën, 18% e djemve dhe 11% e vajzave pohojnë se diskutojnë me të dy prindërit ndërsa 3% e vajzave dhe 12% e djemve pohojnë se diskutojnë më shumë me babain mbi shëndetin e tyre seksual e riprodhues.

47% e djemve dhe 52% e vajzave pohojnë se të dy prindërit u japin informacion rreth dhunës që mund të ndodhë në familje apo shoqëri, ndërkohë që 26% e vajzave dhe po aq djem pohojnë se asnjëri nga prindërit nuk u jep informacion mbi këtë çështje.

III.2. ANALIZA CILËSORE

Siç u përshkrua dhe në kapitullin përkatës të metodologjisë së këtij studimi, analiza cilësore u përqendrua në përpunimin e të dhënave të mbledhura nga realizimi i 14 diskutimeve me grupe të fokusuara me afërsisht 70 vajza dhe djem, të grupmoshës 16 – 18 vjeçare dhe 28 intervista të thelluara nga të cilat 21 me prindër dhe 7 me profesioniste e profesionistë si mësuese/mësues apo psikologe/psikologë në shkolla. Gjetjet nga përpunimi i të dhënave cilësore paraqiten në vijim.

a) Analiza e të dhënave të mbledhura nga fëmijët

Koha që prindërit kalojnë me fëmijët

Një pjesë e fëmijëve raportojnë që prindërit nuk kalojnë kohë të mjaftueshme me ata. Veçanërisht baballarët shpenzojnë shumë më pak kohë me fëmijët sesa nënat. Pjesa më e madhe e fëmijëve shprehen se nëna kalon më shumë kohë me ata sepse babai është në punë. Në disa raste fëmijët e justifikojnë mos kalimin e kohës me babain duke u shprehur se ai punon shumë, ndërsa nëna ka më shumë kohë për të kaluar me fëmijën. Edhe në rastet kur nëna punon, përsëri ajo kalon më shumë kohë me fëmijët. Nëna përfshihet shumë më tepër në aktivitete të ndryshme në familje dhe që lidhen kryesisht me rolet që nëna perceptohet se ka në familje, si pastrim, gatim, kujdes për fëmijët më të vegjël. Në përgjithësi babai kalon kohë me fëmijët në darkë vonë ose në fundjavë. Koha që kalojnë me babain është më e pakët dhe më shumë e fokusuar në aktivitete që mund të bëjnë jashtë familjes të gjithë së bashku: të shikojnë një film, ndeshje, të dalin shëtitje. Fëmijët përshkruajnë si kohë të zakonshme (si p.sh. vaktet e darkës dhe koha që bëjnë mësimet, që shikojnë televizor) dhe kohë të veçantë (të tilla si festimet e ditëlindjeve dhe pushimet) të kaluara së bashku. Koha e veçantë, të tilla si festimet familjare ose pushimet, janë cilësuar nga fëmijët si më të bukurat duke qenë se ata kalojnë më shumë kohë me të dy prindërit dhe kanë një ndërveprim më relaksues me njëri-tjetrin.

“Unë kaloj kohë me nënën time sepse ajo nuk punon aq shumë sa babai im” (vajzë, 18 vjeç, Fier)

“Orari i kthimit nga puna i të dy prindërve është i njëjtë, por më shumë kohë kaloj me mamin” (vajzë, 16 vjeç, Durrës)

“Me mamin, pasi nuk jam rritur me babin se ka qenë jashtë shtetit” (djalë, 16 vjeç, Kukës)

Në përgjithësi fëmijët e justifikojnë kohën më të madhe që nëna kalon me ata me faktin që ajo qëndron më shumë në shtëpi. Ata shprehen që ajo është më e lirë edhe pse të gjithë pranojnë që ajo plotëson në mënyrë të vazhdueshme nevojat e të gjithë anëtarëve të familjes. Duke kaluar më shumë kohë me nënën kanë mundësi që të diskutojnë më në thellësi problematika të ndryshme. Nëna në disa raste zgjedh se cilat problematika, çështje të diskutojë me babain duke e përfshirë në vendimmarrje për ato çështje që ajo i konsideron më të vështira që të marrë vetë vendimin. Nënat perceptohen nga fëmijët si më kërkuese sepse megjithë përfshirjen në rritje të baballarëve në arsimimin e fëmijëve, detyrat e shkollës ende perceptohen si më shumë të lidhura me rolin e nënës në familje.

Pak fëmijë shprehen se kalojnë më shumë kohë me babain dhe kjo ndodh më së shumti në rastet kur ai është i papunë. Edhe kur fëmijët kalojnë më shumë kohë me babain në familje pjesën e komunikimit të vazhdueshëm e ndërtojnë me nënën duke qenë se me të e kanë më të lehtë që të diskutojnë.

Shumë nga pjesëmarrësit shprehen për një nevojë të madhe që të kalojnë më shumë kohë me babain. Mungesa e prezencës dhe angazhimit në mënyrë aktive e babait në familje është shumë e dukshme dhe del në disa raste gjatë diskutimeve me fëmijët. Fëmijët shprehen që në përgjithësi ata duan një baba që të jetë shumë më pranë nevojave të tyre për t’i kuptuar më mirë ata. Komunikimet e rralla që kanë me babain bën që gjërat midis tyre të mos jenë gjithmonë të lehta për t’u kuptuar dhe për t’u diskutuar më tej. Babai nuk zhvillon shprehitë e nevojshme të komunikimit me fëmijët dhe kjo e mban larg situatave të përditshme që kalojnë fëmijët.

“Babi të gjente pak më shumë kohë të rrinte me ne, babai të ishte pak më mendjehapur” (vajzë, 16 vjeç, Tiranë)

“Me babin të shpenzoj më shumë kohë dhe të kisha shpenzuar më shumë kohë kur isha e vogël që ta kisha më shumë idenë e familjes” (vajzë, 18 vjeç, Tiranë)

Fëmijët raportojnë që babai në përgjithësi merr role që nuk krijojnë atë lidhjen e vazhdueshme dhe të qëndrueshme me fëmijën dhe që nuk lejojnë fëmijën që të kuptojë dimensionet e plota të prindërimit nga të dy prindërit. Fëmijët ndiejnë që fëmijëria e tyre ka shumë mungesa për atë se çfarë babai duhet të kishte ofruar si prind për fëmijët. Edhe pse ka një përpjekje që nëna të kompensojë atë rol për fëmijët, kjo shpesh konsiderohet si një mungesë me kalimin e viteve.

Koha e kaluar së bashku shihet si një vlerësim i rëndësisë së kësaj marrëdhënieje. Koha e kaluar me prindërit shikohet si një mundësi që fëmijët të mund të shprehen e të marrin vëmendjen dhe kujdesin maksimal të prindërve. Gjetja e kohës për të kaluar së bashku në mes të angazhimeve të tjera u pa si një shprehje e përparësisë ose e vlerësimit të veçantë të kësaj marrëdhënie. Përveç kësaj, koha që kalohet së bashku me anëtarët e familjes duket se merr një rëndësi të shtuar kur fëmijët rriten, për shkak të zgjedhjes që tashmë bëjnë fëmijët për mënyrën sesi ata do ta kalojnë kohën.

Disa nga fëmijët shprehen që në disa raste ata organizojnë aktivitete të ndryshme që të kalojnë së bashku si familje, si udhëtime, lojëra të ndryshme, të shohin ndonjë film së bashku, shëtitje në natyrë sipas mundësive që kanë familjet.

Në përgjithësi raportohet që fëmija më i vogël i familjes është ai që përkëdhelet më shumë nga prindërit dhe që nuk përfshihet njësoj si fëmijët e tjerë për të ndihmuar në familje. Ka dhe raste kur prindërit tentojnë që fëmijën që ka patur më shumë probleme të shëndetit ta kenë më shumë në vëmendje dhe kujdes. Jo në të gjitha raste fëmijët më të rritur në familje e pranojnë kujdesin dhe vëmendjen e diferencuar të prindërve edhe në rastet kur vëllai/motra është më i vogël. Kjo lidhet me nevojën e madhe që ata kanë për të qenë nën kujdesin e vazhduar të prindërve por tashmë në raporte të reja si midis të rriturve.

“Duan t’ia plotësojnë të gjitha, se është e vogël, ne të mëdhenjve s’është se na e venë dhe shumë veshin” (djalë, 17 vjeç, Durrës)

Fëmijët më të rritur shprehen se në disa raste ata fajësohen edhe për gabimet që bëjnë fëmijët më të vegjël. Roli i kujdesit për fëmijët më të vegjël shpesh i atribuohet fëmijëve më të rritur në familje duke qenë se prindërit janë të ngarkuar, kjo lidhet edhe me rolet dhe eksperiencat e tyre të fëmijërisë. Kjo jo gjithmonë pranohet nga fëmijët më të rritur edhe pse në shumë raste ata ndihen të detyruar për ta përmbushur këtë rol. Fëmijët më të mëdhenj marrin rolet e prindit për vëllain/motrën më të vogël dhe tentojnë të mos ruajnë raportet motër-vëlla, vëlla-vëlla apo motër-motër.

Në pak raste fëmijët raportojnë një kujdes më të madh të prindërve për fëmijët djem. Kjo lidhet dhe me çfarë prindërit kanë trashëguar dhe kanë modeluar nga fëmijëria e tyre. Djemtë shihen si trashëgimtarë të familjes.

“Tani i preferuari në familje është vëllai se është i vetmi djalë në familje dhe besoj se ai është i preferuari nga mami dhe babi” (vajzë, 16 vjeç, Kukës)

Fëmijët më të mëdhenj marrin më shumë përgjegjësi dhe ndihmojnë më shumë familjen, ndërsa më të vegjëlit përfshihen më pak. Prindërit kërkojnë që fëmijët të kryejnë detyra të ndryshme ndihmuese për familjen si angazhimi i vajzave në pastrim, kujdes për fëmijët me të vegjël, angazhimi i djemve në detyra jashtë shtëpisë. Nga ana tjetër kjo jo gjithmonë shoqërohet me marrjen e mendimeve të tyre dhe pjesëmarrje më të madhe në vendimmarrjet e familjes. Disa nga djemtë shprehen se tentojnë që të përfshihen në familje kryesisht në pjesën e gatimit. Në përgjithësi vihet re që nënat tentojnë që të afrojnë më shumë vajzat në role të ngjashme që kanë të bëjnë me pastrimin, kujdesin për anëtarët e familjes, etj., ndërsa djemtë tentohet që të shtyhen më shumë drejt roleve që kryejnë baballarët në familje. Për fëmijët kjo duket se vjen natyrshëm duke qenë se në shumicën e rasteve këto janë modelet që ata shikojnë në familje dhe tentojnë që të mbeten në të njëjtën kornizë. Disa nga fëmijët që kanë më shumë informacione për rolet gjinore, për barazinë midis vajzave dhe djemve tentojnë që ta ndajnë dhe diskutojnë këtë gjë në familje, duke refuzuar që t'i shërbejnë vëllait, duke kërkuar që edhe ai të kontribuojë në detyrat e familjes.

Rolet e prindërve

Baballarët shikohen nga fëmijët si siguresit e të ardhurave dhe që nuk kanë një rol aktiv në rritjen e fëmijëve. Fëmijët shprehen që tek babai drejtohen për pjesën e parave që u duhen dhe që është ai që shpesh iu plotëson nevojat dhe dëshirat. Në shumë raste edhe pse nëna punon jashtë shtëpisë nuk nxirret në pah kontributi i saj ekonomik që ajo sjell në familje. Pothuajse të gjithë fëmijët e konsiderojnë pjesën e sigurimit të të ardhurave në familje si një kontribut të babait. Rolet e tjera që nënat kanë në familje e zbehin rolin që ajo ka për sigurimin e të ardhurave. Roli i siguresit të të ardhura lidhet edhe me kohën më të gjatë të qëndrimit jashtë shtëpisë dhe në përgjithësi, janë burrat ata të cilët shpenzojnë më shumë kohë në rolet prodhuese dhe komunitare (pra jashtë shtëpisë).

“Babi siguron të ardhurat e familjes, siguron vazhdimësinë e pothuajse gjithë familjes, sepse nëse nuk ka familja babain është njësoj si të mos ketë familja shtyllën” (vajzë, 16 vjeç, Lezhë)

Në disa raste baballarët shikohen si më të rreptë, indiferentë për gjërat e përditshme të fëmijëve, të mbyllur, autoritarë, që nuk ofrojnë atë ngrohtësinë e nënës dhe që u mungon durimi për të kuptuar drejt nevojat e fëmijëve. Baballarët kryesisht përfshihen në çështjet që ata i shikojnë më të rëndësishme për t'u diskutuar si familje por nuk ndjekin problematikat e përditshme që ndjekin nënat. Edhe pritshmëritë e fëmijëve janë të tilla që babai ndërhyr në situata më të rralla dhe që konsiderohen të rëndësishme për prindin dhe fëmijët. Duke qenë se mungon përfshirja e vazhdueshme e babait, fëmijët ndihen në disa raste në pozita jo shumë të rehatshme kur komunikojnë me babain, duke e cilësuar ndonjëherë si të vështirë dhe të rëndë. Disa nga djemtë tentojnë që ta shikojnë babain si në një rol më edukues të djemve dhe nënën në rolin edukues më shumë të vajzave. Në përgjithësi të gjithë fëmijët e pranojnë që babai ka më shumë peshë në familje dhe dëgjohet më shumë në marrjen e vendimeve.

“Babi është më autoritari, ndërsa nëna merret me gjërat e vogla të përditshme” (djale, 17 vjeç, Durrës)

“Po babi është ai me më shumë maturi në familje dhe në sjellje dhe fjala e tij ka gjithmonë vlera dhe ne gjithmonë duhet ta dëgjojmë” (djale, 17 vjeç, Lezhë)

“Tek gjërat që janë më problematike, është babi që flet dhe e vulos muhabetin” (vajzë, 16 vjeç, Peshkopi)

Në pak raste fëmijët shprehen për një rol më tolerant të babait dhe që shpesh ndjehen të lirshëm dhe tentojnë që të diskutojnë me të. Por kryesisht në këto raste kërkohet leje nga babai për aktivitete që nënat nuk i kanë lejuar. Kjo lidhet shumë me rolet që baballarët zgjedhin që të kenë më shumë në familje si plotësues të dëshirave të fëmijëve.

“Me babin se është me mendje hapur, kurse mami nuk ndryshon mendim” (vajzë, 16 vjeç Peshkopi)

Fëmijët në përgjithësi i shikojnë prindërit midis stilit autoritar dhe pak liberal (lejues). Ata shprehen që më shumë i shohin në stilin autoritar dhe kjo lidhet me eksperiencat e fëmijërisë së tyre, rolet dhe modelet që ata kanë mësuar. Ndryshimet në stilin e prindërimit janë diktuar nga faktorë të jashtëm disa forca shtrenguese që nuk janë në kontrollin e tyre dhe që jo gjithmonë pranohen lehtë nga prindërit. Fëmijët shprehen që shpesh herë prindërit i referohen me nostalgji fëmijërisë së tyre dhe kontrollit të rreptë të prindërve ndaj fëmijëve, por që koha e sotme nuk ua lejon një formë të tillë autoriteti ndaj fëmijëve për sa kohë që flitet më shumë për të drejtat e fëmijëve.

Edhe disa nga fëmijët që i gjejnë prindërit më shumë në stilin liberal (lejues) nuk ndjehen të kënaqur pasi mendojnë që prindërit nuk janë të përfshirë mjaftueshëm në jetën e tyre të përditshme. Fëmijët kërkojnë një vëmendje dhe kujdes më të madh nga ana e prindërve dhe jo gjithmonë e shikojnë pozitive lirinë shumë të madhe të prindërve.

“Kanë qenë shumë liberal duhet të më kishin kufizuar. Të ishin pak më të përfshirë dhe kontrollues në jetën e fëmijëve” (vajzë, 18 vjeç, Kukës)

Nëna është ajo që ka një rol shumë të madh të përkujdesjes për fëmijët për të përmbushur të gjitha nevojat e përditshme. Nëna është ajo që ofron më shumë mbështetje emocionale çdo ditë dhe që komunikon në mënyrë të vazhdueshme për nevojat që kanë fëmijët kryesisht me shkollën, shoqërinë, problematikat e jetës së përditshme. Në disa raste fëmijët raportojnë që nënat tentojnë që të rregullojnë ekuilibrat në familje kur fëmijët duan diçka dhe baballarët nuk janë dakord, siç ndodh edhe e kundërta që nënat nuk duan dhe baballarët tentojnë që të mbrojnë kërkesat e fëmijëve.

“Mami merret me rregullat parësore në lidhje me mua, ndërsa me babin kemi pothuajse një marrëdhënie të ftohtë” (vajzë, 17 vjeç, Durrës)

“Unë më shumë kohë kaloj me mamin pasi e di se çfarëdo gjëje që të them do e kuptoj ndërsa babi ndoshta do e keqkuptojë çdo fjali” (vajzë, 16 vjeç, Kukës)

Ajo çfarë ata do të donin të ndryshonin tek prindërit lidhet me nevojën që të mirëkuptohen më shumë nga të dy prindërit për të gjitha ato që fëmijët po kalojnë sot. Prindërit duhet të pranojnë që gjërat janë shumë të ndryshme nga fëmijëria e tyre. Në disa raste fëmijët shprehen se nuk ndihen të gjykuar drejt nga prindërit dhe jo gjithmonë dëgjojnë mjaftueshëm për këndvështrimet dhe nevojat e ndryshme që ata kanë në ditët e sotme. Trajtimi i fëmijëve si të vegjël në familje është një shqetësim që shprehet herë pas here duke qenë se kjo e vështirëson komunikimin me prindërit dhe ata nuk ndihen në pozita të barabarta për të diskutuar.

“Duhet të kenë më shumë besim te ne, që kur dalim të mos na thonë direkt jo” (vajzë, 18 vjeç, Ibë)

Mungesa e besimit të prindërve i shqetëson fëmijët duke qenë se ata janë në një moshë që kërkojnë tjetër vëmendje dhe angazhim në familje. Mungesa e mirëkuptimit nga ana e prindërve bën që të krijohen keqkuptime, përplasje të vazhdueshme dhe rezistencë nga të dyja palët. Fëmijët kërkojnë që prindërit të jenë më tolerantë dhe të ndryshojnë mentalitetin e tyre pasi situatat janë shumë të ndryshme nga fëmijëria e tyre.

“Mami të jetë pak më mendjehapur, më e kohës” (vajzë, 15 vjeç, Peshkopi)

Prindërit në përgjithësi kanë pritshmëri të larta për fëmijët. Kryesisht duan që fëmija të mbarojë shkollën e lartë pasi e shikojnë si një siguri për një të ardhme më të mirë. Disa nga prindërit kanë një pritshmëri të lartë që fëmija të edukohet jashtë Shqipërisë dhe i shtyjnë fëmijët që ta konsiderojnë si një alternativë për të ardhmen. Ka dhe disa prindër që i shikojnë djemtë më shumë tek shkollat profesionale dhe kjo lidhet me rezultatet jo shumë të larta në mësim. Në disa raste ka dhe prindër që kanë pritshmëri për djemtë që të emigrojnë dhe të largohen nga Shqipëria. Disa nga fëmijët shprehen që jo në të gjitha rastet pritshmëritë e prindërve përputhen me pritshmëritë e fëmijëve për veten. Prindërit në disa raste tentojnë që t’i orientojnë drejt profesioneve sipas gjinisë së tyre apo sipas asaj që ata e konsiderojnë më fitimprurëse por që jo gjithmonë është ajo që fëmija pëlqen apo ka menduar për veten. Zgjedhjet e arsimit të lartë/profisioni në disa raste i lihen momentit të fundit kur fëmija duhet të bëjë një zgjedhje patjetër dhe jo gjithmonë fëmija është mjaftueshëm i bindur për zgjedhjen që ka bërë.

“Babi do të bëhem kirurg ndërsa mami jurist si ajo vetë po unë do bëhem dizanjer. Kanë shumë pritshmëri po më thonë vetëm kamarier mos përfundo” (djalë, 17 vjeç, Tiranë)

“Pritshmëria e vetme është që të mësoj gjermanisht, të iki në Gjermani dhe të shpëtoj” (djalë, 17 vjeç, Krujë)

Në disa raste fëmijët vihen në pozitat që duhet të ndjekin shembullin, rrugën e motrës/vëllait më të madh. Kjo është kufizuese dhe shqetësuese për fëmijët duke qenë se ndihen mjaftueshëm konkurues në një fushë që nuk është pikë e fortë për ata. Fëmijët shprehen që nuk lejohen dhe nuk kuptohen mjaftueshëm që kanë prirje dhe aftësi të ndryshme.

“Më krahasojnë me motrën që ka mësuar më shumë, se duan që dhe unë të jem si ajo, të eci në shembullin e saj. Duan që të vazhdoj një shkollë, të mësoj dhe nuk e di, t’ua kaloj të gjithëve” (vajzë, 16 vjeç, Krujë)

Komunikimi me prindërit

Fëmijët komunikojnë më shumë me nënën duke qenë se ajo është më shumë prezente në familje por nga ana tjetër e kanë më të lehtë që të flasin me të sepse ndihen të mirëkuptuar. Nënata janë dëgjuese më të mira dhe ofrojnë këshilla të vazhdueshme për fëmijët që lidhen me frekuentimin e shkollës, sjelljen, rezultatet në mësim, shoqërinë, disiplinën në shkollë. Komunikimi

i vazhdueshëm që fëmijët kanë me nënën e bën më të lehtë diskutimin e çështjeve të ndryshme me atë dhe më të vështirë diskutimin me babain. Fëmijët preferojnë që të flasin me nënën për temat e përditshme dhe jo vetëm për problematikat dhe në përgjithësi nënat janë të përfshira në diskutime të tilla.

“Si vajzë unë preferoj të flas për problemet e mia me mamanë time sepse ndihem sikur ajo është shoqja ime dhe unë mund të flas për gjëra të ndryshme, ndërsa babai shumicën e kohës e kalon duke punuar, kështu që edhe kur përpiqemi të flasim për diçka, thjesht ndihem në siklet” (vajzë, 17 vjeç, Fier)

Djemtë në disa raste tentojnë që të flasin më shumë me baballarët duke qenë se edhe rolet që ata marrin në familje i shikojnë të ngjashme me ata. Në përgjithësi ata tentojnë që të kryejnë aktivitete të përbashkëta me baballarët, orientohen nganjëherë dhe në fusha të ngjashme interesi, si futboll, makinat, shkolla, këshilla për jetën, etj. Komunikimet që kanë djemtë me baballarët kryesisht lidhen me çështje që kanë të bëjnë me hobet/aktivitetet e përbashkëta, informacione të përgjithshme që lidhen me mësimet, shokët. Megjithatë kjo nuk do të thotë që mungon komunikimi me nënën e cila zvogëlon barrierat në komunikim me fëmijët djem dhe vajza duke kuptuar nevojat e tyre dhe duke ofruar ndihmën e saj në çdo situatë. Nëna me komunikimin e saj të vazhdueshëm tenton që të identifikojë, kuptojë shqetësimet e fëmijëve. Një pjesë e fëmijëve shprehen se nuk duan të flasin me prindërit për shumë nga çështjet që kanë të bëjnë me shkollën, shokët/shoqet. Përdorimi më i madh i teknologjisë dhe rrjeteve sociale e ka kufizuar dhe zvogëluar komunikimin edhe në familje. Fëmijët në disa raste e shikojnë si një lehtësi më të madhe shpenzimin e një pjesë të konsiderueshme të ditës online duke refuzuar të shprehen me prindërit ose duke u ndalur në çështje shumë të përgjithshme dhe duke anashkaluar thelbin në komunikimet me ta. Edhe kur kthehen në familje vazhdon komunikimi me shokët/shoqet përmes rrjeteve online më shumë sesa me prindërit.

“Realisht me asnjërin nga prindërit nuk kam qejf të kaloj kohë, ndoshta është moshë. Thjesht s’ka qenë pjesë shumë interesante për mua. Kam qenë shumë i angazhuar me internetin dhe shoqërinë. Them se kur ka ndonjë eveniment ose ditëlindje kam kaluar kohë me to por në jetën e përditshme jo” (djalë, 17 vjeç, Kukës)

Fëmijët ndihen më mirë kur diskutojnë me bashkëmoshatarët duke qenë se është një diskutim mes të barabartësh ku mungojnë kritikë, fajësimet, gjykimet. Tendencat që kanë prindërit në disa raste për të fajësuar fëmijët, për të ndërprerë bisedën, për t’i paragjykuar si të vegjël dhe jo të aftë, për të bërë

moral dhe për të dhënë këshilla në mënyrë të vazhdueshme, bën që fëmijët të jenë selektivë në informacionet që ndajnë me ata. Disa nga fëmijët raportojnë që zgjedhin që të mos ndajnë me prindërit gjërat për të cilat ata mendojnë që prindërit mund të mërziten.

Prindërit jo gjithmonë ndalen që të vlerësojnë dhe inkurajojnë fëmijët për arritjet e tyre. Ky aspekt kthehet në një shqetësim për fëmijët duke qenë se duket sikur prindërit nuk kënaqen asnjëherë por gjithmonë kërkojnë më shumë pavarësisht mundësive dhe kapaciteteve që kanë fëmijët.

Kur fëmijët pyeten për pikën e dobët të prindërve, disa prej tyre shprehen për nënat që të mos merakosen aq shumë, të kenë më shumë besim tek ata, të jenë më të hapura dhe të shprehin frikërat që kanë. Meraku i madh që kanë nënat zakonisht bëhet edhe shkak për kufizimet që ato u venë fëmijëve duke mos qenë gjithmonë bindëse për fëmijën.

Pikë të dobët tek baballarët shikojnë besimin më të madh që duhet t'u japin fëmijëve, të komunikojnë më shumë, të tregojnë më shumë afeksion ndaj fëmijëve, të jenë më shumë të përfshirë në angazhimet e fëmijëve, të jenë më realistë për kërkesat që kanë për fëmijët e tyre nëse vërtet i kanë njohur ashtu siç duhet.

*“Pikë e dobët te babi është afeksioni se nuk ma tregon mua që më do”
(vajzë, 16 vjeç, Tiranë)*

*“Babi e kërkon gjithçka të përkryer do të doja të ishte pak më ndryshe”
(djalë, 17 vjeç, Berat)*

Prindërit tentojnë në disa raste të mos shfaqin afeksion ndaj fëmijëve pasi mendojnë që kjo do të ndikonte në autoritetin dhe raportet që ata duhet të ruajnë në marrëdhëniet me fëmijët. Nga ana tjetër disa nga fëmijët shprehen se presin që prindërit të shprehin më shumë dashuri, vëmendje, të komunikojnë sa më shumë edhe atëherë kur mendohet që ata janë më shumë të dhënë pas bashkëmoshatarëve.

Në të njëjtën kohë që fëmijët adoleshentë kërkojnë më shumë autonomi, shumë prindër kanë vështirësi të heqin dorë nga kontrolli, duke rezultuar në rrugë që ndërpresin komunikimin prind-adoleshent, ku mungon komunikimi, prindërit që delegojnë urdhëra dhe krijojnë barrierë akoma më të pakapërcyeshme në komunikimin që ndërtojnë me fëmijët.

Diskutimi i çështjeve që kanë të bëjnë me seksualitetin dhe marrëdhëniet intime

Shumica e fëmijëve raportojnë që nuk flasin me prindërit për çështje që kanë të bëjnë me seksualitetin dhe marrëdhëniet intime. Në disa raste ata mendojnë që këto nuk janë çështje që duhet të diskutohen me prindërit, në raste të tjera ata e kanë shumë të vështirë që të flasin me prindërit për këto tema, veçanërisht me babain. Disa fëmijë të tjerë mendojnë që këto tema duhen diskutuar me familjen që ata të jenë të mirë informuar dhe të kenë informacione të sakta. Fëmijët presin që prindërit të flasin për çështje të tilla. Mungesa e komunikimit për çështje të tilla krijon disa zona të errëta që tentojnë që të mos eksplorojnë, kuptohen më pas mjaftueshëm edhe nga fëmija.

Pak nga fëmijët shprehen se diskutojnë me nënën por që kryesisht informacionet që ndajnë janë shumë sipërfaqësore nga të dyja palët. Pra edhe në pak raste kjo temë në përgjithësi tenton të trajtohet shkarazi, të anashkalohet dhe të mos qëndrohet mjaftueshëm për të diskutuar për të. Vajzat në pak raste psh., kur pëlqejnë ndonjë djalë edhe mund ta ndajnë këtë informacion me nënën por jo me babain, ndërkohë që djemtë tentojnë që të flasin me shokët ose me vëllezërit më të mëdhenj. Në përgjithësi kur kanë vëllezër apo motra më të mëdha në familje ata flasin me ata/ato për çështje të tilla dhe kjo kthehet edhe në një lehtësi për prindërit që nuk ndihen gati që të dikutojnë me fëmijët.

“Me asnjërin për këtë temë, por mami është ajo që më thotë të gjej një vajzë të mirë” (djalë, 17 vjeç, Peshkopi)

“Jo nuk është se flas me mamin, por më thotë “Bëj gafë e u lidhe! Se fundja e bën moshë këtë gjë jo ti” (vajzë, 17 vjeç, Kukës)

Edhe në rastet kur prindërit bisedojnë me fëmijët, duket se përqendrohen më shumë në rezultatet negative të marrëdhënieve seksuale dhe seksualitetit dhe më pak në ato që adoleshentët duhet të dinë për të kuptuar më plotësisht se si po rriten dhe zhvillohen. Disa nga pjesëmarrësit shprehen se kanë pritur që prindërit ta hapnin diskutimin për temat e seksualitetit, por në përgjithësi prindërit tentojnë më shumë që ta mbyllin komunikimin me paralajmërimet e ndryshme që u japin fëmijëve, me kufizimet e ndryshme që marrin ndaj tyre, me qëndrimet ekstreme kur diskutohet për çështje të tilla. Ka një hezitim si nga ana e fëmijëve dhe e prindërve për të diskutuar për seksualitetin. Ka disa fëmijë që mendojnë që ndoshta në të ardhmen do të flasin pasi mendojnë që është shpejt diskutimi i këtyre temave dhe tani nuk ndihen gati për t'i ndarë këto informacione me prindërit. Një pjesë e fëmijëve dëshirojnë që të komunikojnë më lirshëm për shëndetin seksual dhe riprodhues me prindërit. Por nga ana tjetër prindërit janë ata që e kufizojnë diskutimin.

“Personalisht, si vajzë, unë kurrë nuk do të shkoj tek babai im për të folur në lidhje me këtë temë, ashtu si nuk e shikoj etike që ai të flasë me mua, në lidhje me këtë...” (vajzë, 18 vjeç, Lezhë)

Duket që në shumicën e rasteve si prindërit dhe fëmijët akoma nuk janë gati për të komunikuar së bashku rreth çështjeve të seksualitetit. Fëmijët i referohen edhe mentalitetit si një pengesë për diskutimin mbi marrëdhëniet intime dhe ata shprehen që pritët edhe nga prindërit që vajzat të mos e bëjnë këtë diskutim. Duke qenë se komunikimi në familje për këto tema mungon ata zgjedhin që të diskutojnë me bashkëmoshatarët sepse ata në përgjithësi kanë interes për këto çështje. Komunikimi me bashkëmoshatarët raportohet më i lehtë duke qenë se ata kanë qëndrime më lejuese dhe jo gjykuese.

Ndëshkimet e prindërve

Prindërit kryesisht ndëshkojnë fëmijët për sjelljen që kanë në familje dhe shkollë, për notat që marrin, mungesat, problemet e ndryshme që krijojnë me shoqërinë në shkollë. Nëna është ajo që ndëshkon më shumë duke qenë se ajo është në kontakt të vazhdueshëm me fëmijët problematikat dhe nevojat e tyre. Disa nga ndëshkimet që përdoren më shpesh me fëmijët janë mos lejimi i përdorimit të telefonit për periudha të caktuara, mos dalja me shokët/shoqet, kufizimi për të parë televizor, kufizimi i internetit. Baballarët ndëshkojnë më rrallë fëmijët por kanë më shumë autoritet dhe peshë për ndëshkimet që japin. Fëmijët në përgjithësi tentojnë që t’u shpëtojnë sa më shumë ndëshkimeve të baballarëve pasi ndihen shumë më tepër të lënduar nga ndëshkimet e tyre.

“Po me thënë të drejtën babait ia kam më shumë frikën dhe nuk dua ta kaloj atë cakun” (vajzë, 16 vjeç Durrës)

Konfliktet e prindërve në lidhje me përdorimin e telefonit, kufizimin e kohës që shpenzojnë me shokët/shoqet, mund të përfaqësojnë përpjekjet e prindërve për të kufizuar dhe kontrolluar djemtë dhe vajzat e tyre adoleshente. Planet e prindërve mund të bien ndesh me dëshirat e fëmijëve dhe shpesh këto janë situata që krijojnë tensione në familje. Konflikte të tilla në dukje të zakonshme mund të jenë “sinjale” për shqetësime mbi çështje më komplekse dhe të ndjeshme që përfshijnë besimin, pavarësinë, modelet e prindërimit, ndikimet e bashkëmoshatarëve.

Prindërit e kanë më të lehtë që të vendosin ndëshkime për vajzat, djemtë ndëshkohen më rrallë. Vajzat kontrollohen më shumë për orarin dhe prindërit tentojnë që t’i kufizojnë dhe mbajnë nën kontroll më shumë sesa djemtë. Prindërit kanë pritshmërinë që vajzat duhet të jenë shumë korrekte dhe të mos krijojnë probleme në familje, prandaj dhe tentojnë që të mos e falin sjelljen e tyre të gabuar.

“Vajzës i thonë hiqe telefonin, kurse djalit nuk ja marrin dot” (vajzë, 16 vjeç, Peshkopi)

“Motrave u flasin më shumë se çunave” (djalë, 17 vjeç, Berat)

Vajzat raportojnë që prindërit janë më të ashpër, kanë rregulla shumë më strikte dhe vendosin kufizime në mënyrë të vazhdueshme ndaj tyre sesa ndaj djemve. Disa nga vajzat janë më pranuese ndaj rregullave të ndryshme që prindërit vendosin për djemtë dhe vajzat, dhe duket sikur ato i kanë brendësuar dhe konsiderohet normale që kërkesat, ndëshkimet të jenë të ndryshme. Ka dhe disa vajza të tjera që tentojnë që të rebelohen më shumë dhe të kërkojnë që të konsiderohen të barabarta me djemtë, pasi e shikojnë dhe si një mungesë besimi të prindërve tek ato. Djemtë e pranojnë që prindërit në përgjithësi janë më pak kërkuar dhe ndëshkuar ndaj tyre.

Duke qenë se vajzat në përgjithësi tentojnë që t'i pranojnë kërkesat e prindërve të tyre për më shumë kontroll dhe kufizime kjo mund të çojë në një qëndrim tolerant ndaj marrëdhënieve kontrolluese që partnerët e tyre mund të kenë në momentin që ato do të krijojnë familje.

Disa nga fëmijët raportojnë që prindërit i kanë ndëshkuar më shumë kur kanë qenë të vegjël dhe në disa raste kanë përdorur goditje, shuplaka e shoqëruar edhe me presion psikologjik apo kërcënime, por që kanë ardhur duke u zbehur duke qenë se fëmijët tani janë më të rritur. Por edhe prindërit janë më shumë të informuar që nuk duhet t'i dhunojnë fëmijët dhe nga ana tjetër edhe fëmijët flasin dhe diskutojnë më shumë për të drejtat që ata kanë në familje dhe shkollë.

Koha e kaluar me prindërit gjatë karantinës

Gjatë karantinës shumë nga fëmijët shprehen se kanë kaluar kohë më shumë me të dy prindërit, por ka dhe shumë raste kur baballarët kanë punuar dhe ata kanë kaluar përsëri me shumë kohë me nënën. Koha e izolimit ka krijuar mundësinë që antarët e familjes të shpenzojnë më shumë kohë së bashku dhe të diskutojnë për tema të ndryshme. Fëmijët shprehen se gjatë izolimit kanë patur kohë më shumë që të luajnë letra, domino, lojë mos u nxehtë, të shohin televizor së bashku, të gatuajnë. Disa nga fëmijët shprehen se ndihen pak më të afërt me prindërit por përsëri nëna është ajo që e shohin më afër dhe që diskutojnë më lehtë. Pjesa tjetër shprehen që marrëdhëniet që kanë me prindërit nuk kanë ndryshuar si para dhe pas izolimit për shkak të COVID-19. Një pjesë e fëmijëve shprehen se qëndrimi në karantinë ka bërë që të rritet komunikimi me babain dhe të kalojnë më shumë kohë së bashku. Ata janë të kënaqur që e kanë patur këtë mundësi që ta shohin babain edhe në role të tjera në familje dhe të kenë mundësi që të diskutojnë më shumë me të.

“Për mua është e kundërta sepse me babin jam i distancuar ndërsa me mamin çdo lloj teme, në karantinë u afruam edhe me babin dhe shyqyr kjo marrdhënie ka ngelur dhe nuk është zhdukur as pas karantinës” (djalë, 19 vjeç, Tiranë)

Situata e pandemisë ka qenë tema kryesore që familjet kanë diskutuar gjatë karantinës por edhe në muajt në vazhdim. Komunikimet e prindërve gjatë izolimit kanë qenë të fokusuara në informimin e fëmijëve mbi COVID-19, masat parandaluese dhe të kujdesit që ata duhet të kenë për të mbrojtur veten por dhe anëtarët e tjerë të familjes. Fëmijët shprehen që prindërit në disa raste kanë shprehur më shumë shqetësim për shëndetin e fëmijëve për shkak të situatës së krijuar nga pandemia. Kujdesin e shtuar të prindërve në lidhje me ushqyerjen dhe shëndetin fëmijët e lidhin me situatën e vështirë që po kalojnë për shkak të pandemisë COVID-19. Disa nga fëmijët shprehen që prindërit janë përpjekur që të jenë të kujdesshëm në diskutimet me fëmijët dhe të luajnë një rol mbrojtës dhe informues në raport me lajmet që mediat kanë ndarë në lidhje me situatën e krijuar nga COVID-19.

“Kanë qenë të dy që vazhdojnë thonë rregullat, maskën, dezinfektant, etj., edhe me ligjet vazhdojnë thonë ki kujdes. Diskutojmë edhe sesi mund të kujdesemi më mirë përveç lajmërimeve” (djalë, 16 vjeç, Tiranë)

Gjatë karantinës ka patur disa baballarë që kanë marrë role të kujdesit për familjen por që nuk i kanë vazhduar më tej pas përfundimit të izolimit. Pjesën e ndarjes së roleve në familje dhe e të punuarit së bashku, fëmijët duket që e kanë shijuar, pasi kanë ndihmuar njëri-tjetrin, kanë kaluar më shumë kohë së bashku.

“Në rastim tim mami ka qënë shtëpiake ndërsa babi sillte te ardhurat. Ndërsa gjatë karantinës babi u bë nënë se bënte punët e shtëpisë. Punët i kishim të ndara. Pas karantinës babi nuk e lante më shtëpinë” (vajzë, 17 vjeç, Krujë)

Disa nga fëmijët shprehen që kanë marrë më shumë role mbështetëse dhe ndihmuese në familje dhe kryesisht djemtë janë përfshirë më shumë në guzhinë duke gatuar, ndërkohë vajzat më shumë në pastrimin e shtëpisë por edhe në gatim.

b) Analiza e të dhënave të prindërve dhe profesionistëve (psikolog/punonjës social shkollorë, mësues)

Perceptimet e prindërve dhe profesionistëve për stilet e prindërimit

Prindërit shprehen në përgjithësi që nuk kanë përdorur vetëm një stil prindërimi

por e gjejnë veten midis stilit autoritar dhe liberal (lejues). Stilin autoritar e shikojnë më shumë si të trashëguar nga prindërit e tyre duke qenë se kështu janë edukuar dhe shpesh herë e gjejnë si shumë të rëndësishëm dhe shumë efektiv sepse mendojnë që me ata ka funksionuar shumë mirë. Prindërit në moshën e rritur të mesme tentojnë që të mbështeten dhe ta vlerësojnë si më efektiv stilin autoritar. Ndryshe nga prindërit më të rinj që kanë fëmijë më të vegjël dhe që e shohin si kufizues dhe jo efektiv stilin autoritar.

Ka një tendencë në përgjithësi që prindërit të trashëgojnë në prindërimin e tyre elementë të caktuar të prindërve të tyre. Sa më të mëdhenj të jenë prindërit në moshë aq më shumë elementë të trashëguar gjen në stilet e tyre të prindërimit. Gjatë procesit të rritjes dhe të edukimit të fëmijëve prindërit e gjejnë veten në disa situata duke kërkuar dhe duke vepruar në mënyrë të ngjashme me prindërit e tyre. Pavarësisht se disa prindër e pranojnë që janë të ngjashëm me prindërit e tyre ata shprehen se me kalimin e kohës kanë ndryshuar. Ndryshimet që shohin tek vetja i lidhin me ndryshimet që dikton koha dhe gjithë situata që po jetojnë që i ka bërë që të jenë më tolerantë. Prindërit shprehen që situata për fëmijët e tyre është shumë më e mirë krahasuar me fëmijërinë e tyre.

*“Prindërit tanë merrnin vendime pa na pyetur neve. Ndërsa sot prindërimi ynë është që ne i marrim vendimet së bashku, duke i pyetur vajzat tona”
(baba, Vlorë)*

“Ne kemi qenë në një stil prindërimi autoritar, kur vinte babi në shtëpi duhet të ngriheshim në këmbë, kur vinte miku duhet të ngriheshim. Stili ynë ka një ndryshim me prindërimin më përpara në lidhje me lirinë që u kemi dhënë fëmijëve, ndërkohë që atëherë nuk ekzistonte fjala liri” (nënë, Fier)

Disa prindër shprehen se marrëdhënia prindër-fëmijë sot është më e fortë, se atëherë vendoste prindi, ndërsa sot fëmija komunikon me shumë me prindërit dhe marrëdhënia e tyre është më dinamike duke qenë se edhe fëmijët në disa raste kanë mundësinë të shprehin mendimet e tyre.

“Në rastim tim mami ka qënë shtëpiake ndërsa babi sillte te ardhurat. Ndërsa gjatë karantinës babi u bë nënë se bënte punët e shtëpisë. Punët i kishim të ndara. Pas karantinës babi nuk e lante më shtëpinë” (vajzë, 17 vjeç, Krujë)

Niveli i edukimit të prindërve, eksperiencat e ndryshme jetësore, moshë e prindërve por edhe i gjithë mjedisi dhe zhvillimet që kanë ndodhur gjatë këtyre viteve kanë ndikuar në stilin e prindërimit që kanë prindërit sot. Shumë nga prindërit e pranojnë që edhe pse kanë trashëguar nga stilet e prindërimit të prindërve të tyre ata janë shumë më të ndryshëm në mënyrën se si kujdesen dhe edukojnë fëmijët e tyre sot. Ndryshimet në stilet e prindërimit ata i

shikojnë shpesh herë edhe të lidhura me kohën dhe situatat që po jetojnë ose sepse mendojnë që në disa raste ato kanë qenë stile të gabuara që nuk e kanë ndihmuar fëmijën të zhvillohet, kanë qenë kufizuese dhe jo pjesëmarrëse.

Sipas disa prej prindërve të intervistuar, prindërimi i fëmijëve djem dhe vajza është i ndryshëm. Prindërit në përgjithësi e pranojnë që janë më kufizues me vajzat sesa me djemtë. Shpesh herë kjo vjen edhe për shkak të mentalitetit me të cilin janë rritur apo kulturës, normave në zonat ku ato jetojnë. Presioni i komuniteteve për rolet e vajzave dhe djemve është shumë i madh për familjet që jetojnë në qytete të vogla apo zona rurale. Prindërit nuk janë gjithmonë të barabartë me fëmijët djem dhe vajza. Në përgjithësi frikërat më të mëdha janë për fëmijët vajza që tentojnë t'i kontrollojnë dhe të mos i lejojnë që të dalin me shokë/shoqe, apo të qëndrojnë jashtë deri vonë, si djemtë.

“Jam sjell egër me vajzën se më kërkonte leje me shku me shoqet edhe unë nuk e kam lënë, nuk e di a kam bërë gabim, jam pendu faktikisht tani. Djemtë i kam lënë me dal me shokët” (nënë, Lezhë)

“Po ka ndryshim, se për shembull djali mund të ketë një shoqe ndërsa vajza nuk mund të ketë një shok” (mësuese, Berat)

Disa nga prindërit mendojnë që edhe mësuesit në shkollë tentojnë që të jenë më tolerantë ndaj djemve duke qenë se janë më impulsivë dhe të jenë më kufizuese ndaj vajzave duke qenë se edhe nga natyra vajzat shikohen si më të brishta, të dobëta.

Prindërit i tremben shumë asaj se çfarë do mendojë komuniteti për vajzën më shumë sesa për djalin duke qenë se dhe komuniteti pret që vajzat të jenë të përkryera dhe të mos gabojnë. Pritshmëri të tilla bëjnë që prindërit të vendosin rregulla më të forta dhe të jenë më autoritarë me vajzat sesa me djemtë. Kufizimet për vajzat vijnë edhe për shkak të pasigurisë që perceptojnë prindërit në komunitetet ku jetojnë, frikës dhe merakut shumë të madh që ata kanë për fëmijën. Në rastet e situatave problematike që krijohen nga fëmijët vajza prindërit në disa raste janë ekstrem në kufizimet që vendosin, qëndrimet apo sjelljet që ata shfaqin ndaj tyre. Kjo vjen për shkak të asaj që prindërit presin që vajzat të mos gabojnë.

“Kemi patur raste të shumta të shantazheve të djemve në rrjetet sociale ndaj vajzave. Kur prindërit vinin shqetësimi i tyre ishte në atë fazën sa i thonin djalit do të të vras dhe mënyra e konceptimit ishte dramatike. Nuk konceptoj sesi ndikon kjo emocionalisht tek vajza, por si e shikon shoqëria. Prindi ishte dhunues i dyfishtë. Nuk fokusohet tek zgjidhja por tek fajësimi i fëmijës” (psikologe, Tiranë)

Frikërat që prindërit perceptojnë për djemtë lidhen me shoqërimin me fëmijë problematikë, si i shpenzojnë lekët që marrin në familje, shoqëria në shkollë, nëse lënë orët e mësimi, mos konsumojnë cigare apo drogë, rezultat në mësim që lidhen me atë që fëmija të marrë një shkollë, një zanat. Frikërat që prindërit perceptojnë për vajzat lidhen me atë që vajza të mos marrë rrugë të keqe, merakun që të mos përflitet në komunitet, mos ka një sjellje të keqe, shoqëria dhe disiplina në shkollë.

Sipas profesionistëve prindërit vazhdojnë të interesohen për fëmijët për notat, sjelljen, frekuentimin në shkollë dhe nuk tentojnë të zbresin edhe në nivele të tjera të nevojave dhe situatave me të cilat mund të përballen fëmijët, si marrëdhënie të hershme seksuale, rreziku i shfrytëzimit apo trafikimit të fëmijëve, shantazhet në rrjetet sociale, rreziku i bullizmit midis bashkëmoshatarëve, përdorimi i rrjeteve online të sigurta dhe rreziqeve që lidhen me internetin. Në rastet kur profesionistët tentojnë që të diskutojnë me prindërit çështje të tilla justifikimi më zakonshëm është që “kjo gjë nuk i ndodh fëmijës sim”.

Sipas profesionistëve stilet e prindërimit kanë ndryshuar ndër vite dhe gjithmonë e më shumë po përdoren edhe format më të reja dhe bashkëkohore të edukimit të fëmijëve. Ka dhe shumë prindër të tjerë që dashje pa dashje trashëgojnë dhe elementë të prindërimit të prindërve të tyre duke qenë se ato tashmë janë modeluar në sjelljet, të menduarit, qëndrimet dhe përdoren edhe në jetën e përditshme. Ka prindër që janë shumë të preokupuar për fëmijën në një masë të tillë që nuk e lë fëmijën të rritet apo të aftësohet për të zgjidhur nevojat, problemet e tij. Ka dhe prindër që i qëndrojnë stilit autoritar por që është zbutur disi por që përsëri e kanë shumë të lehtë që ta disiplinojnë fëmijën duke e ndëshkuar fizikisht, siç ka dhe prindër që mund të jenë më tepër seç duhet liberalë (lejuar), duke mos vendosur kufizime dhe rregulla për disiplinimin e fëmijëve, duke plotësuar çdo dëshirë të fëmijëve dhe duke mos thënë jo për asgjë. Stili autoritar vazhdon që të mbetet më shumë dominant edhe pse prindërit përpiqen të mos e pranojnë por në edukimin e fëmijëve ky stil u vjen më natyrshëm. Baballarët janë ata që tentojnë që të përdorin më shumë stilin autoritar. Marrëdhëniet e prindërve me fëmijët janë sot më fleksibël dhe bashkëpunuese, nuk janë të ngurta dhe të mbyllura. Pikë e fortë është që në shumicën e rasteve ruhen lidhjet e forta familjare, traditat e familjes së shëndetshme, edhe pse po shtohen gjithmonë e më shumë rastet e fëmijëve që jetojnë në familje më një prind.

“Në të gjitha rastet e këshillimit kemi hasur që mbizotëron stili autoritar, që do të thotë ngrohtësi dhe disiplinë, vazhdon ai mentaliteti që kush të rreh të do” (psikologe, Tiranë)

Deklaratat e disa prej prindërve gjatë intervistave tregojnë se ata shpesh janë

të ngujuar midis vlerave tradicionale (të cilat ata vetë i kanë adoptuar gjatë fëmijërisë së tyre) dhe asaj që po imponohet në shoqërinë moderne si standard kur bëhet fjalë për prindërit dhe rritjen e fëmijëve. Nga njëra anë, ekziston presioni për të vazhduar mënyrat tradicionale të sjelljes, besimeve, vlerave dhe qëndrimeve të ushqyera në familje për breza, por nga ana tjetër, prindërit duhet të miratojnë modele të reja të sjelljes në përputhje me prirjet shoqërore. Prindërit gjithashtu duket sikur janë jo të qartë në lidhje me vlerat që duhet të promovohen dhe ndërtohen tek adoleshentët që po perceptojnë ndryshime të rëndësishme midis brezave. Shoqëria pret shumë nga prindërit në lidhje me rolet që ata kanë në edukimin e fëmijëve, ndërsa nuk u siguron mundësinë për të forcuar/përmirësuar kapacitetet e tyre me qëllim që edhe prindërit të dinë sesi të udhëheqin fëmijët në një shoqëri ku dinamikat e zhvillimeve janë shumë të shpejta.

Rolet e prindërve në familje

Nënat në përgjithësi pranojnë që rolet e tyre janë më shumë të lidhura me kujdesin për fëmijën, gatimin, pastrimin, ndjekjen për shkollën dhe mësimet. Nënat janë ato që ndjekin dhe edukojnë më shumë fëmijët për sjelljen. Një pjesë e nënave i lidhin rolet e tyre në familje më shumë me atë se çfarë u kanë mësuar prindërit dhe çfarë i kanë këshilluar në momentin që kanë krijuar familjen. Prindërit shpesh u kanë mësuar që të durojnë dhe të ulin kokën, gjë që ato sot nuk e duan tek fëmijët e tyre.

“Kur jam martuar unë dhe kemi shkuar në shtëpi me qera kemi patur një furnelë të vogël. Ishte dimër dhe kisha djalë të vogël. Qepën e kisha vënë të skuqej në zjarr. Harrova ta shikoja qepën por e dija që burri ishte aty dhe e shifte, se ishte duke u nxehtë në furnelë. Ai e dogji mu përpara syve të mi, me mentalitetin që burri nuk merret me atë punë. E dogji sepse ai mendonte që ajo ishte puna ime” (nënë, Lezhë)

Baballarët, nënat dhe fëmijët në shumë raste besojnë se roli i baballarëve në familje përqendrohet në sigurimin e nevojave themelore. Këto perceptime janë të lidhura me rolin tradicional mashkullor brenda familjes, në të cilin babai përfaqëson figurën e autoritetit dhe siguresit të të ardhurave ekonomike.

Fëmijët kalojnë pjesën më të madhe të kohës me nënën. Baballarët perceptohen si më autoritarë në familje dhe në disa raste tentojnë që t'u qëndrojnë larg fëmijëve pasi kjo sipas tyre ruan më shumë autoritetin. Në rastet kur nënat nuk arrijnë ta disiplinojnë fëmijën dhe kjo bëhet më e vështirë me djemtë tentohet që baballarët të rrisin rolin e tyre në disiplinimin e fëmijëve, në respektimin e rregullave në familje. Nënat shprehen se flasin dhe komunikojnë më shumë me fëmijët. Baballarët perceptohen si më të kufizuar në komunikim, më hijerëndë me fëmijët. Edhe në rastet e baballarëve që qëndrojnë kohë më

të gjatë në shtëpi me fëmijët nuk kanë një komunikim më të fortë me fëmijët sesa nëna. Duket sikur ata e konsiderojnë një detyrë që duhet ta realizojë nëna dhe nuk tentojnë që të zhvillojnë biseda më interaktive dhe më të afërta me fëmijët duke qenë se nuk kanë zhvilluar shprehje të tilla me fëmijën.

“Për momentin jam i papunë dhe jam më shumë prezent në familje. Por fëmijët vazhdojnë të flasin më shumë nënën për problemet që kanë” (baba, Dibër)

Më shumë se gjysma e prindërve mendojnë që kanë më shumë komunikim me fëmijët e tyre sot krahasuar me kohë më parë. Ata i lenë më shumë fëmijët të lirë dhe u plotësojnë më shumë dëshirat. Disa nga prindërit shprehën se tentojnë që ta konsiderojnë veten në disa raste si shok të fëmijës pasi mendojnë që kjo do t'i afrojë më shumë me ata. Por nga ana tjetër fëmijët janë gjithmonë e më të kufizuar, minimalistë në informacionet që ndajnë me prindërit veçanërisht djemtë duke qenë se mendojnë që prindërit mund të mërzhiten, ose të merakosen. Në disa raste prindërit me rolet që marrin në familje dhe mënyrat e tyre të komunikimit më shumë vetë kufizohen sesa afrohen me fëmijët.

Sipas profesionistëve koha që prindërit kalojnë me fëmijët po vjen duke u zvogëluar, sepse vëmendja dhe nevoja më e madhe për plotësimin e kushteve financiare të familjes ka zvogëluar kohën cilësore që familja kalon së bashku. Kjo mungesë vëmendjeje nga ana e prindërve shoqërohet edhe me kohën shumë të madhe që fëmijët kalojnë me telefonat dhe pajisjet teknologjike ose me kohën që kalojnë me shokët jashtë familjes (kryesisht për djemtë).

“Fëmija kishte dy javë që nuk vinte në shkollë dhe kur mësuesi e merr në telefon, prindi thotë që nuk ishte në dijeni të kësaj situate” (psikologe, Lezhë)

Prindërit shprehën që pritshmëritë për fëmijët kanë qenë gjithmonë të larta dhe kanë kërkuar që të vazhdojnë shkollën, të bëjnë kurse të ndryshme si të gjuhëve të huaja, sporte të ndryshme. Prindërit në disa raste shprehën se tek fëmijët kanë projektuar edhe disa nga gjërat që kanë dashur që ata vetë t'i realizojnë në jetë. Vazhdimi i shkollës së lartë mbetet në përgjithësi një nga kërkesat që prindërit kanë për fëmijët. Kjo lidhet me pjesën e sigurisë për të ardhmen që prindërit shikojnë nëse fëmija është i arsimuar.

Disa nga prindërit ankohen se duke qenë se janë pjesën më të madhe të kohës në punë tentojnë që t'u plotësojnë fëmijëve çdo dëshirë. Plotësimi i çdo dëshire nuk e kompenson nevojën që ka fëmija për të kaluar kohë me prindin, për të komunikuar për të ndarë shqetësimet dhe gëzimet e ditës. Nga ana tjetër

fëmijët bëhen më arrogantë në sjellje dhe në kërkesat e vazhdueshme që kanë ndaj prindërve, të fokusuar kryesisht vetëm në anën monetare. Prindërit e shikojnë që kjo vjen për faj të tyre dhe pastaj bëhet e vështirë për ta kufizuar apo për ta frenuar në disa raste.

Sipas profesionistëve të intervistuar prindërit flasin pak ose nuk flasin fare për rolet gjinore dhe seksualitetin. Informacionet dhe modelet mbi të cilat prindërit edukojnë fëmijët në familje nuk mbështeten mbi rolet e barabarta gjinore. Fëmijët i transmetojnë në përditshmërinë e tyre, në mjediset e shkollës, në aktivitete të ndryshme diferencat gjinore që familja edukon dhe që mjedisi ku jetojnë përforcon. Familja vazhdon të edukojë që vajzat dhe djemtë janë të ndryshëm dhe kjo përkthehet edhe në rolet e ndryshme që ato/ata kanë në familje, pritshmëritë e prindërve dhe format e edukimit dhe komunikimit të ndryshme për djemtë dhe vajzat.

“Janë të prirur që t’i japin më shumë liri djemve t’i lënë të lirë pa kontroll dhe mënyra sesi edukohet një vajzë dhe një djalë është ndryshe. Vajza e percepton veten që 16 vjeç që unë e kam për detyrë të rri në shtëpi, të laj enët, të kujdesem për familjen pra e ka bindur veten që e ka për detyrë ta privojë veten nga liritë dhe aktivitetet e tjera si bashkëmoshatarët dhe mua kjo më shqetëson” (psikologe, Lezhë)

Rolet që fëmijët mësojnë në familje janë rolet që ata shohin çdo ditë tek prindërit e tyre. Duke u rritur fëmijët fillojnë dhe e gjejnë veten në rolet e prindërve të tyre, vajza në rolet e nënës dhe djali në rolet e babait.

Përfshirja e prindërve në aktivitete të ndryshme

Shumica e prindërve shprehen që nuk flasin me fëmijët për çështje që kanë të bëjnë me seksualitetin, shëndetin seksual dhe riprodhues. Arsytet që ata përmendin lidhen me atë që e kanë të vështirë që të hapin tema të tilla me fëmijën, edhe prindërit e tyre nuk kanë diskutuar për çështje të tilla, janë çështje për të cilat fëmijët duhet ta marrin informacionin nga shkolla, mësuesit, fëmijët nuk kanë probleme të tilla, etj. Disa nga prindërit e intervistuar shprehen se mësuesit, organizatat duhet të punojnë më shumë për informimin e fëmijëve mbi seksualitetin, ndërkohë që rolin e tyre e shohin më të vogël.

Diskutimet që kanë të bëjnë me dhunën në familje janë më shumë të fokusuara tek këshillat që u japin fëmijëve për të mos u zënë me njëri-tjetrin, për të mos ngacmuar fëmijët e tjerë. Në rastet kur dëgjojnë për raste të dhunës në komunitet, diskutimi me fëmijët është më shumë në nivelin e shprehjes së keqardhjes sesa në edukimin e tyre. Një pjesë e prindërve raportojnë që nuk janë të informuar që të diskutojnë për fenomenin e dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore. Fëmijët i marrin më shumë këto informacione nga shkolla dhe rrjete të ndryshme sociale. Profesionistët e ndryshëm të shkollave

shprehen që këto tema janë me interes për fëmijët dhe ata kanë mungesë informacioni. Akoma më e madhe bëhet nevoja për të diskutuar dhe për të marrë informacion mbi tema që kanë të bëjnë me seksualitetin, marrëdhëniet intime, shëndetin riprodhues.

Format e disiplinimit që prindërit përdorin me fëmijët janë nga më të ndryshmet. Pak nga prindërit shprehen se kanë tentuar që t'i displinojnë fëmijët edhe nëpërmjet goditjes por që nuk ka funksionuar dhe janë ndjerë keq që kanë vepruar ashtu. Prindërit jo gjithmonë janë të informuar për teknikat e ndryshme të disiplinimit që mund të përdorin me fëmijët.

“Qëllon ku nuk ke nerva dhe e godet, por nuk funksionon sepse vetëm i rrit agresivitetin, ai mësohet me drurin dhe...” (nënë, Tiranë)

Ka dhe një grup më të madh prindëresh që përdorin si formë disiplinimi heqjen e të drejtës për të ndjekur kursin e preferuar për një periudhë të caktuar, mos dhënien e parave të vogla të xhepit, marrjen e telefonit, etj. Ndërkohë që shprehen se janë totalisht kundër formave ndëshkuese të dhunës fizike.

“Nuk funksionon të vënit dorë sikurse edhe t'i shkulësh veshin, varet dhe nga temperamentin e fëmijës. Nëse ti e bën ai ta kthen në të njëjtën mënyrë. E kam bërë njëherë dhe më tha siç ma bën do ta bëj” (nënë, Korçë)

Perceptimi i autoritetit midis shumicës së prindërve lidhet me stilin tradicional autoritar të prindërimit të ushtruar nga prindërit e tyre, i cili përgjithësisht shihet si pozitiv sepse lidhet me punën, disiplinën dhe respektin ndaj të rriturve. Megjithatë, rezultatet tregojnë se disiplina ndërtohet rrallë mbi konceptin e ndëshkimit, edhe disa nga prindërit aktualisht, besojnë se ndëshkimi do të bllokonte komunikimin dhe do të krijonte një marrëdhënie në të cilën fëmijët do të mbyllen dhe do të fshehin fakte që potencialisht mund t'i çojnë ata në sjellje të rrezikshme.

Profesionistët dhe një pjesë e prindërve treguan se modelet e marrëdhënies prind-fëmijë dhe koha që kalojnë ndryshon kur fëmija fillon dhe rritet. Jeta familjare, pritshmërit e prindërve dhe angazhimi i fëmijëve në jetën e tyre të përditshme duket se janë të organizuara rreth asaj që ata do të kalojnë më pak kohë me njëri-tjetrin. Pjesëmarrja dhe kontributi i prindërve në shkollë vjen duke u zvogëluar me rritjen e fëmijës, duke qenë se mendojnë që fëmija është më i rritur dhe mund të përballet vetë me situata të ndryshme në shkollë. Interesi i prindërve për fëmijën në shkollë fokusohet në elementë që kanë të bëjnë me sjelljen, mbarëvajtja në mësim dhe shokët/shoqet e fëmijës. Këto janë dhe çështjet për të cilat pyesin dhe tentojnë që të kontrollojnë fëmijët. Në përgjithësi komunikimi me fëmijët, edhe pse prindërit mendojnë që është

rritur krahasuar me fëmijërinë e tyre, tenton që të mbetet sipërfaqësor dhe jo i fokusuar edhe në çështje të tjera që janë me interes për fëmijët në moshën e adoleshencës apo rinisë. Në përgjithësi prindërit nuk ndalen në komunikime të thelluara me fëmijën që të përshtaten me nevojat, problematikat, moshën e fëmijës apo edhe çështje aktuale për të cilat fëmijët duhen testuar herë pas here se çfarë mendojnë, ndjejnë apo perceptojnë.

Sipas profesionistëve mungesa e këtij komunikimi të thelluar dhe të vazhdueshëm, mos ndalimi për të trajtuar trauma të fëmijërisë, të mos kushtuarit vëmendje shëndetit mendor dhe gjendjes emocionale të fëmijës për t'i njohur, shprehur dhe për t'i trajtuar emocionet, bën që fëmijët të zhvillojnë problematika të ndryshme. Vajzat të krijojnë një gjendje më të rëndë emocionale, më shumë gjendje ankthi, depresioni apo fshehje të problemit dhe djemtë që ta shprehin shqetësimin e tyre duke u bërë më agresivë, më të dhunshëm.

Fëmijët tentojnë që të krijojnë lidhje të forta me shoqërinë dhe kjo konsiderohet nga prindërit dhe si një mungesë interesi apo vëmendjeje për familjen. Megjithëse adoleshenca është një periudhë e shënuar nga një dëshirë më e madhe për autonomi dhe pavarësi, fëmijët kanë nevojë për monitorimin/ ndjekjen efektive të prindërve që është një faktor i rëndësishëm i besimit reciprok në marrëdhënien prind-fëmijë. Rrjetet e ndryshme sociale e kanë rritur akoma më shumë shqetësimin e prindërve duke qenë se koha që fëmijët kalojnë aty po vjen duke u shtuar. Të gjitha këto bëjnë që fëmijët të përfshijnë gjithmonë e më pak prindërit në aktivitetet e tyre, si dhe të komunikojnë vetëm për gjërat më thelbësore të përditshme.

Disa nga prindërit fajësojnë shkollën për problematikat e ndryshme që shfaqin fëmijët. Ata në përgjithësi nuk arrijnë t'i kontrollojnë fëmijët për pjesën e mësimave duke qenë se edhe programet e fëmijëve kanë ndryshuar ndër vite apo janë prindër me pak vite arsimim. Shumë nga problematikat me të cilat përballen fëmijët shikohen si çështje që duhet të adresohen nga shkolla.

“Në shkollë fëmijët duhet të marrin 80% të dijeve. Se prindërit vijnë në darkë të lodhur” (baba, Lezhë)

Disa nga prindërit e shikojnë kontributin e tyre në lidhje me edukimin e fëmijëve në shkollë shumë të vogël. Tentojnë që të zvogëlojnë pjesëmarrjen dhe prezencën e tyre në shkollë dhe janë jo tolerantë ndaj ankesave dhe shqetësimeve që shfaqin mësuesit për fëmijët e tyre.

Disa nga prindërit e pranojnë që fëmijët modelojnë sjelljet që shohin në familjet e tyre dhe prindërit janë ata që edukojnë fëmijët me veprimet, komunikimet,

sjelljet, rolet që ata kanë në familje. Edukata dhe angazhimi i prindërve në familje reflektohet në sjelljen dhe në qëndrimet që fëmijët shfaqin vit pas viti. Në rastet kur mungon komunikimi dhe angazhimi i prindërve në familje është minimal, fëmijët tentojnë që të humbasin kontrollin e prindërve dhe të drejtohen drejt sjelljeve dhe eksperiencave të bashkëmoshatarëve. Disa nga prindërit ndihen fajtorë që nuk kanë mundur të jenë ashtu siç duhet pranë fëmijëve edhe kur ata janë rritur. Në përgjithësi nga prindërit tentohet që të plotësohen nevojat bazike të fëmijëve për ushqim, veshmbathje, strehim, shkollim dhe dëshira të ndryshme që kanë fëmijët. Ndërkohë që neglizhohen nevoja të tjera që kanë fëmijët.

Sipas profesionistëve edukimi gjinor dhe edukimi seksual i fëmijëve duhet të fillojë më herët me qëllim që fëmija ta përvetësojë gradualisht. Dhënia e këtij informacioni në mënyrë të organizuar nga shkolla do të ndihmojë në informimin dhe ndërgjegjëgjësimin e atyre fëmijëve që u mungon informacioni i prindërve. Fëmijët do të kenë mundësi që të marrin një informacion të saktë dhe do të edukohen mbi barazinë gjinore, stereotipet gjinorë, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje, seksualitetin, marrëdhëniet e shëndetshme.

c) Gjetjet nga fokus grupet e realizuara me fëmijët

Koha që prindërit kalojnë me fëmijët

- Pjesa më e madhe e fëmijëve shprehen se nëna kalon më shumë kohë me ata sepse babai është në punë. Në disa raste fëmijët e justifikojnë mos kalimin e kohës me babain duke u shprehur se ai punon shumë, ndërsa nëna ka më shumë kohë të lirë për të kaluar me fëmijën.
- Më shumë se gjysma e fëmijëve raportojnë se kanë nevojë të madhe që të kalojnë më shumë kohë me babain. Komunikimet e rralla që kanë me babain bëjnë që gjërat midis tyre të mos jenë gjithmonë të lehta për t'u kuptuar dhe për t'u diskutuar më tej.
- Koha e kaluar së bashku me prindërit shihet si një vlerësim i rëndësishëm së marrëdhënies prind-fëmijë dhe si një mundësi që fëmijët të mund të shprehen e të marrin vëmendjen dhe kujdesin maksimal të prindërve. Gjetja e kohës për të kaluar së bashku në mes të angazhimeve të tjera u pa si një shprehje e përparësisë ose e vlerësimit të veçantë të kësaj marrëdhënieje.
- Fëmijët më të mëdhenj marrin më shumë përgjegjësi dhe ndihmojnë më shumë familjen, ndërsa më të vegjël përfshihen më pak. Disa nga prindërit presin që fëmijët të kryejnë detyra të ndryshme ndihmuese për familjen si angazhimi i vazhës në pastrim, kujdes për fëmijët më të vegjël, angazhimi i djemve në detyra jashtë shtëpisë. Nga ana tjetër

kjo jo gjithmonë shoqërohet me marrjen e mendimeve të tyre dhe pjesëmarrje më të madhe në vendimmarrjet e familjes.

Rolet e prindërve

- Baballarët shikohen nga fëmijët si siguresit e të ardhurave dhe që nuk kanë një rol aktiv në rritjen e fëmijëve. Fëmijët shprehen që tek babai drejtohen për pjesën e parave që iu duhen dhe që është ai që shpesh u plotëson nevojat dhe dëshirat. Në shumë raste edhe pse nëna punon jashtë shtëpisë nuk nxirret në pah kontributi i saj ekonomik që ajo sjell në familje.
- Në disa raste baballarët shikohen si më të rreptë, indiferentë për gjërat e përditshme të fëmijëve, të mbyllur, autoritarë, që nuk ofrojnë atë ngrohtësinë e nënës dhe që iu mungon durimi për të kuptuar drejt nevojat e fëmijëve. Baballarët kryesisht përfshihen në çështjet që i shikojnë më të rëndësishme për t'u diskutuar si familje por nuk ndjekin problematikat e përditshme që ndjekin nënat.
- Fëmijët në përgjithësi i shikojnë prindërit midis stilit autoritar dhe pak liberal (lejues). Ata shprehen që më shumë i shohin në stilin autoritar dhe kjo lidhet me eksperiencat e fëmijërisë së tyre, rolet dhe modelet që ata kanë mësuar.
- Disa prej fëmijëve shprehen se janë të shqetësuar për shkak të trajtimit herë pas here si të vegjël në familje dhe kjo e vështirëson komunikimin me prindërit dhe ata nuk ndihen në pozita të barabarta për të diskutuar.
- Në përgjithësi fëmijët shprehen se prindërit kanë pritshmëri të larta për arsimin e tyre, ata duan që të vazhdojnë arsimin e lartë dhe madje edhe jashtë Shqipërisë në disa raste. Disa nga prindërit i shohin më shumë djemtë tek shkollat profesionale për shkak të rezultateve që kanë në mësimet. Ka dhe raste që orientimi në profesione bëhet edhe bazuar në gjininë apo dëshirat që kanë prindërit për fëmijët.

Komunikimi me prindërit

- Pjesa më e madhe e fëmijëve raportojnë që komunikojnë më shumë me nënën duke qenë se ajo është më shumë prezente në familje por, nga ana tjetër, e kanë më të lehtë që të flasin me atë sepse ndjehen të mirëkuptuar.
- Një pjesë e djemve flasin më shumë me baballarët duke qenë se edhe rolet që ata marrin në familje i shikojnë të ngjashme me ata. Në përgjithësi ata përfshihen në aktivitete të përbashkëta me baballarët,

oreintohen ndonjëherë dhe në fusha të ngjashme interesi, si futboli, makinat, shkolla, këshilla për jetën, etj.

- Disa nga fëmijët raportojnë që kalojnë një kohë të konsiderueshme online duke zvogëluar kohën që kalojnë me prindërit. Ka një pjesë të fëmijëve që nuk shprehen hapur me prindërit por në përgjithësi diskutojnë çështje shumë të përgjithshme dhe anashkalojnë thelbin e komunikimet me ta. Ata zgjedhin që të mos komunikojnë për problemet e tyre duke qenë se nuk duan që prindërit të mërzhiten. Fëmijët shprehen se ndihen më mirë kur diskutojnë me bashkëmoshatarët duke qenë se është një diskutim mes të barabartësh ku mungojnë kritikrat, fajësimet, gjykimet.
- Disa nga fëmijët shprehen se presin që prindërit të shprehin më shumë dashuri, vëmendje, të komunikojnë sa më shumë edhe atëherë kur mendohet që ata janë më shumë të dhënë pas bashkëmoshatarëve.

Diskutimi i çështjeve që kanë të bëjnë me seksualitetin dhe marrëdhëniet intime

- Shumica e fëmijëve raportojnë që nuk flasin me prindërit për çështje që kanë të bëjnë me seksualitetin dhe marrëdhëniet intime. Ata e kanë shumë të vështirë që të flasin me prindërit për këto tema, veçanërisht me babain.
- Pak nga fëmijët shprehen se diskutojnë me nënën por që kryesisht informacionet që ndajnë janë shumë sipërfaqësore nga të dy palët. Pra edhe në pak raste kjo temë në përgjithësi tenton të trajtohet shkarazi, të anashkalohet dhe të mos qëndrohet mjaftueshëm për të diskutuar për të.
- Disa nga fëmijët shprehen se kanë pritur që prindërit ta hapnin diskutimin për temat e seksualitetit, por në përgjithësi prindërit tentojnë më shumë që ta mbyllin komunikimin me paralajmërimet e ndryshme që u japin fëmijëve, me kufizimet e ndryshme që marrin ndaj tyre, me qëndrimet ekstreme kur diskutohet për çështje të tilla.
- Në shumicën e rasteve si prindërit dhe fëmijët akoma nuk janë gati për të komunikuar së bashku rreth çështjeve të seksualitetit. Duke qenë se komunikimi në familje për këto tema mungon ata zgjedhin që të diskutojnë me bashkëmoshatarët sepse ata në përgjithësi kanë interes për këto çështje. Komunikimi me bashkëmoshatarët raportohet më i lehtë duke qenë se ata kanë qëndrime më lejuese dhe jo gjykuese. Kur kanë motra apo vëllezër më të mëdhenj në familje ata flasin me ato/ ata për çështje të tilla dhe kjo kthehet edhe në një lehtësi për prindërit

që nuk ndihen gati që të dikutojnë me fëmijët.

Ndëshkimet e prindërve

- Shumë nga fëmijët raportojnë që konfliktet e prindërve në lidhje me përdorimin e telefonit, kufizimin e kohës që shpenzojnë me shokët/shoqet, mund të përfaqësojnë përpjekjet e prindërve për të kufizuar dhe kontrolluar djemtë dhe vajzat e tyre adoleshente. Konflikte të tilla në dukje të zakonshme mund të jenë “sinjale” për shqetësime mbi çështje më komplekse dhe të ndjeshme që përfshijnë besimin, pavarësinë, modelet e prindërimit, ndikimet e bashkëmoshatarëve.
- Për disa nga prindërit është më e lehtë që të vendosin ndëshkime për vajzat, djemtë ndëshkohen më rrallë. Vajzat kontrollohen më shumë për orarin dhe prindërit tentojnë që t'i kufizojnë dhe mbajnë nën kontroll më shumë sesa djemtë. Vajzat raportojnë që prindërit janë më të ashpër, kanë rregulla shumë më strikte dhe vendosin kufizime në mënyrë të vazhdueshme ndaj tyre sesa ndaj djemve.
- Disa nga fëmijët raportojnë që prindërit i kanë ndëshkuar më shumë kur kanë qenë të vegjël dhe në disa raste kanë përdorur goditje, shuplaka e shoqëruar edhe me presion psikologjik apo kërcënime, por që kanë ardhur duke u zbehur duke qenë se fëmijët tani janë më të rritur.

Koha e kaluar me prindërit gjatë karantinës për shkak të COVID-19

- Koha e izolimit ka krijuar mundësinë që antarët e familjes të shpenzojnë më shumë kohë së bashku dhe të diskutojnë për tema të ndryshme. Fëmijët shprehen se gjatë izolimit kanë patur kohë më shumë që të luajnë letra, domino, lojë mos u nxe, të shohin televizor së bashku, të gatujnë.
- Një pjesë e fëmijëve shprehen se qëndrimi në karantinë ka bërë që të rritet komunikimi me babain dhe të kalojnë më shumë kohë së bashku. Ata janë të kënaqur që e kanë patur këtë mundësi që ta shohin babain edhe në role të tjera në familje dhe të kenë mundësi që të diskutojnë më shumë me të.
- Komunikimet e prindërve gjatë izolimit kanë qenë të fokusuara në informimin e fëmijëve mbi COVID-19, masat parandaluese dhe të kujdesit që ata duhet të kenë për të mbrojtur veten por dhe anëtarët e tjerë të familjes. Fëmijët shprehen që prindërit në disa raste kanë shprehur më shumë shqetësim për shëndetin e fëmijëve për shkak të situatës së krijuar nga pandemia.

d) Gjetjet nga intervistat e realizuara me prindërit dhe profesionistët

Perceptimet e prindërve dhe profesionistëve për stilet e prindërimit

- Prindërit shprehen se marrëdhënia prindër-fëmijë sot është më e fortë, se më parë vendoste prindi, ndërsa sot fëmija komunikon më shumë me prindërit dhe marrëdhënia e tyre është më dinamike duke qenë se edhe fëmijët në disa raste kanë mundësinë të shprehin mendimet e tyre.
- Një pjesë e prindërve raporton që prindërimi i fëmijëve djem dhe vajza është i ndryshëm. Prindërit në përgjithësi e pranojnë që janë më kufizues me vajzat sesa me djemtë. Shpesh herë kjo vjen edhe për shkak të mentalitetit me të cilin janë rritur apo kulturës, normave në zonat ku ata jetojnë. Frikërat më të mëdha janë për fëmijët vajza, prandaj prindërit në përgjithësi tentojnë që t'i kontrollojnë dhe të mos i lejojnë që të dalin me shokë/shoqe, të mos qëndrojnë jashtë deri vonë, si djemtë. Prindërit janë më pak tolerantë ndaj sjelljeve problematike që mund të krijojnë vajzat krahasuar me djemtë.
- Frikërat që prindërit perceptojnë për djemtë lidhen me shoqërimin me fëmijë problematikë, si i shpenzojnë lekët që marrin në familje, shoqëria në shkollë, nëse lënë orët e mësimi, mos konsumojnë cigare apo drogë, rezultatet në mësimet që lidhen me atë që fëmija të marrë një shkollë, një zanat. Frikërat që prindërit perceptojnë për vajzat lidhen me atë që vajza tëmos marrë rrugë të keqe, merakun që të mos të përflitet në komunitet, mos ka një sjellje të keqe, shoqëria dhe disiplina në shkollë.
- Sipas profesionistëve prindërit vazhdojnë të interesohen për fëmijët për notat, sjelljen, frekuentimin në shkollë dhe nuk tentojnë të zbresin edhe në nivele të tjera të nevojave dhe situatave me të cilat mund të përballen fëmijët, si marrëdhënie të hershme seksuale, rreziku i shfrytëzimit apo trafikimit të fëmijëve, shantazhet në rrjetet sociale, rreziku i bullizmit midis bashkëmoshatarëve, përdorimi i rrjeteve online të sigurta dhe rreziqeve që lidhen me internetin.
- Disa nga prindërit tregojnë gjatë intervistave se ata shpesh janë të ngujuar midis vlerave tradicionale dhe asaj që po imponohet në shoqërinë moderne si standard kur bëhet fjalë për prindërit dhe rritjen e fëmijëve. Prindërit gjithashtu duket sikur janë jo të qartë në lidhje me vlerat që duhet të promovohen dhe ndërtohen tek adoleshentët që po perceptojnë ndryshime të rëndësishme midis brezave.

Rolet e prindërve në familje

- Nënata në përgjithësi pranojnë që rolet e tyre janë më shumë të lidhura me kujdesin për fëmijën, gatimin, pastrimin, ndjekjen për shkollën dhe mësimet. Roli i baballarëve në familje përqendrohet në sigurimin e nevojave themelore, përmes sigurimit të të ardhurave.
- Baballarët perceptohen si më autoritarë në familje dhe në disa raste tentojnë që t'u qëndrojnë larg fëmijëve pasi kjo sipas tyre ruan më shumë autoritetin. Nënata shprehen se flasin dhe komunikojnë më shumë me fëmijët. Baballarët perceptohen si më të kufizuar në komunikim, më hijerëndë me fëmijët.
- Sipas profesionistëve koha që prindërit kalojnë me fëmijët po vjen duke u zvogëluar, sepse vëmendja dhe nevoja më e madhe për plotësimin e kushteve financiare të familjes, ka zvogëluar kohën cilësore që familja kalon së bashku.
- Profesionistët në përgjithësi rapotojnë që prindërit flasin pak ose nuk flasin fare për rolet gjinore dhe seksualitetin. Informacionet dhe modelet mbi të cilat prindërit edukojnë fëmijët në familje nuk mbështeten mbi rolet e barabarta gjinore. Familja vazhdon të edukojë që vajzat dhe djemtë janë të ndryshëm dhe kjo përkthehet edhe në rolet e ndryshme që ato/ata kanë në familje, pritshmëritë e prindërve dhe format e edukimit dhe komunikimit të ndryshme për djemtë dhe vajzat.

Përfshirja e prindërve në aktivitete të ndryshme

- Shumica e prindërve shprehen që nuk flasin me fëmijët për çështje që kanë të bëjnë me seksualitetin, shëndetin seksual dhe riprodhues. Arsyet që ata përmendin lidhen me atë që e kanë të vështirë që të hapin tema të tilla me fëmijën, edhe prindërit e tyre nuk kanë diskutuar për çështje të tilla, janë çështje për të cilat fëmijët duhet ta marrin informacionin nga shkolla, mësuesit, fëmijët nuk kanë probleme të tilla, etj.
- Një pjesë e prindërve shprehen se nuk janë të informuar që të diskutojnë për fenomenin e dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore. Fëmijët i marrin më shumë këto informacione nga shkolla dhe rrjete të ndryshme sociale. Profesionistët e ndryshëm të shkollave shprehen që këto tema janë me interes për fëmijët dhe ata kanë mungesë informacioni.
- Sipas profesionistëve pjesëmarrja dhe kontributi i prindërve në shkolla

vjen duke u zvogëluar me rritjen e fëmijës, duke qenë se mendojnë që fëmija është më i rritur dhe mund të përballet vetë me situata të ndryshme në shkollë.

- Sipas profesionistëve mungesa e komunikimit të thelluar dhe të vazhdueshëm, mos ndalimi për të trajtuar trauma të fëmijërisë, të mos kushtuarit vëmendje shëndetit mendor dhe gjendjes emocionale të fëmijës për t'i njohur, shprehur dhe për t'i trajtuar emocionet, bën që fëmijët të zhvillojnë problematika të ndryshme.
- Megjithëse adoleshenca është një periudhë e shënuar nga një dëshirë më e madhe për autonomi dhe pavarësi, fëmijët kanë nevojë për monitorimin/ndjekjen efektive të prindërve që është një faktor i rëndësishëm i besimit reciprok në marrëdhënien prind-fëmijë.

IV. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Konkluzionet.

- Pavarësisht stilit të prindërimit që përdorin, kur flitet për fëmijët djem dhe vajza në të njëjtën familje, ka një tendencë për të diferencuar trajtimin e tyre pikërisht për shkak të gjinisë. Për shembull fëmijët vajza kufizohen më shumë për të dalë jashtë, për të qendruar vonë, apo për të përdorur mjetet e komunikimit, krahasuar me fëmijët djem, edhe nëse vajzat janë fëmija i parë. Po kështu, ndaj vajzave ka një kërkesë më të madhe llogarie për t'u përfshirë në punët e shtëpisë krahasuar me të njëjtën kërkesë për vëllezërit më të mëdhenj apo më të vegjël.
- Ka një tendencë për të përdorur më shumë stilin autoritativ (demokratik) të prindërimit, kjo më së shumti në grupmoshën 25-44 vjeçare të prindërve. Megjithatë edhe nëse prindërit kanë këtë stil bazë prindërimi, ka dallime gjinore për shembull në dimensionin e pavarësisë që u jepet vajzave kundrejt djemve, ku kufizimet shihen të lidhura më së shumti me çështje të nderit, mentalitetit dhe sjelljes model që shoqëria pret nga vajzat.
- Dallimet gjinore në marrëdhëniet prind-fëmijë janë më të dukshme kur bëhet fjalë për rolet dhe ndarjen gjinore të punës në familje; vlerësimit të lartë të kontributit të baballarëve në lidhje me sigurimin e të ardhurave dhe të mirave materiale, por lënia në hije e të njëjtit kontribut të dhënë nga nëna; mungesës së diskutimit mbi çështje që lidhen me shëndetin seksual dhe riprodhues apo marrëdhëniet intime të fëmijëve, etj.
- Në një numër të konsiderueshëm të familjeve në Shqipëri, figura e babait është më së shumti e distancuar nga aspektet e përditshme të rritjes dhe edukimit dhe pozicionohet kryesisht në sigurimin e të ardhurave. Është nëna ajo që gjendet më shumë pranë fëmijëve, ndonëse kur pyeten, fëmijët vajza e djem dëshirojnë të kalojnë më shumë kohë me babain e nënën së bashku. Nga ana tjetër, jo në pak raste, edhe kur kalojnë kohë bashkërisht me njërin apo të dy prindërit e tyre, kjo kohë jo gjithmonë është produktive dhe diskutime mbi aspekte të caktuara të rritjes dhe edukimit janë të vakëta, ose edhe mungojnë tërësisht.

- Siç e pohojnë dhe profesionistët e përfshirë në studim, stili i prindërimit ndikon në zhvillimin emocional dhe të sjelljes së fëmijëve. Mënyra se si prindërit u përgjigjen emocioneve negative të fëmijëve ndikon në mënyrën se si fëmijët përballen me emocionet e tyre në të ardhmen. Prindërit që u përgjigjen emocioneve negative të fëmijëve në një mënyrë që është mbështetëse, nëpërmjet përdorimit të përgjigjeve të përqendruara tek problemi, i ndihmojnë fëmijët të bëhen më të aftë nga ana shoqërore dhe emocionale.
- Jo në pak raste, prindërit vijnë të përdorin ndëshkimin, edhe fizik, të fëmijëve për sjellje të papëlqyeshme nga ana e tyre. Kjo mënyrë ndëshkimi, ndonëse njihet për pasojat negative në rritjen e fëmijës dhe zhvillimin e personalitetit të tij, ze vend për një periudhë të konsiderueshme të fëmijërisë, deri pothuajse në përfundim të adoleshencës.

Rekomandimet

- Diskutimi dhe dhënia e njohurive rreth stileve të prindërimit dhe sjelljeve e dimensioneve karakterizuese të tyre, është domosdoshmëri, me qëllim që prindërit të njohin dhe kuptojnë realisht pasojat e stilit të tyre të prindërimit në mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve.
- Është e nevojshme që të punohet me programe dhe klasa të prindërimit të mirë, nëpërmjet të cilave të mund të transmetohet të paktën informacioni i duhur tek prindërit e rinj, për të reflektuar ndryshimet e duhura dhe për të përzgjedhur stilin më të përshtatshëm të prindërimit. Ngritja e qendrave të këshillimit paramartesor pranë Zyrave të Gjendjes Civile dhe detyrimi i çifteve të reja për të marrë pjesë në programe të këshillimit për prindërimin e mirë, përpara lidhjes së martesës, do të ishte një mundësi e mirë, për të përparuar në lidhje me informimin në këtë drejtim.
- Një rol të rëndësishëm këtu mund të luajnë edhe institucionet shëndetësore sidomos në momentin përpara ardhjes në jetë të fëmijëve (Konsultoret e Nënave dhe Fëmijëve për të dhënë një informacion më të zgjeruar mbi rolin e të dy prindërve në mirërritje dhe edukim). Gjithashtu institucionet arsimore, sidomos nëpërmjet zbatimit në mënyrën e duhur të qasjes së “Shkollave si qendra komunitare”, mund dhe duhet të japin shumë më tepër informacion në këtë drejtim. Bashkëpunimi edhe me Shërbimin Social Shtetëror, me shërbimet e përkujdesit shoqëror në nivel të vetëqeverisjes vendore (sidomos

me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, Koordinatorët Vendorë kundër Dhunës në Familje, etj), si dhe me organizatat e shoqërisë civile ofruese të shërbimeve, apo edhe me institucionet fetare, gjithashtu do të ishte shumë i rëndësishëm për të adresuar në mënyrën e duhur marrëdhëniet e shëndetshme prind – fëmijë.

- Një tjetër ndërhyrje e koordinuar që do të sillte efekte pozitive në përmirësimin e prindërimit në tërësi në Shqipëri, ka të bëjë me njohjen dhe zbatimin në mënyrën e duhur të legjislacionit për të drejtat e punëmarrësve dhe sidomos të baballarëve për të përfituar lejen e kujdesit të paslindjes, lejen për kujdesin prindëror, etj. Një rol të rëndësishëm këtu luan bashkëpunimi i ministrive përgjegjëse me punëdhënësit e sidomos me sektorin privat, për nxitjen e politikave miqësore ndaj familjes në vendin e punës (p.sh. balancimit të jetës profesionale me atë personale, evidentimi i modeleve pozitive për baballarët, nxitja e tyre për të evidentuar modelet e prindërimit, etj.)
- “Të mësojmë të komunikojmë!” Komunikimi, ndonëse thelbësor në ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme familjare e shoqërore, duket se është një pikë e dobët në marrëdhëniet prind-fëmijë, ndaj dhe duhet të merren masa për adresimin e këtij problemi. Prindërit dhe fëmijët duhet të mësojnë se komunikimi efektiv është zgjidhja kryesore dhe më e mira e të gjitha situatave dhe problemeve që çënojnë marrëdhëniet mes tyre. Ky komunikim nuk duhet të kufizohet vetëm në disa drejtime dhe nuk duhet të fillojë në përfundim të adoleshencës, por që përpara sesa fëmija të vijë në jetë.
- Familja ka një rol të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve mbi çështjet e seksualitetit dhe edukimit gjinor. Prindërit duhet të fillojnë edukimin e fëmijëve që kur ata janë më të vegjël me qëllim që fëmija ta përvetësojë gradualisht këtë informacion, që më pas do të përforcohet edhe nga shkolla.
- Edukimi i prindërve për rolet gjinore të barabarta të djemve dhe vajzave, stereotipet gjinorë, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje, seksualitetin, marrëdhëniet e shëndetshme, etj., do të ndihmojë që prindërit të jenë më të fuqizuar për ndarjen e informacioneve të tilla me fëmijët dhe për zvogëlimin e rreziqeve me të cilat mund të përballen fëmijët.
- Përfshirja e prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre adoleshentë

duhet të inkurajohet dhe praktikohet. Modelet dhe praktikat e mira të prindërimit duhet të promovohen me qëllim që të shërbejnë edhe si modele edhe për prindërit e tjerë. Prindërit duhet të pajisen me informacion të saktë rreth seksualitetit dhe të informohen rreth qasjeve të duhura të mënyrave të komunikimit për seksualitetin me fëmijët.

- Shkollat duhet të punojnë më shumë me prindërit duke iu siguruar informacionin e nevojshëm për të rritur përparimin arsimor të fëmijëve të tyre dhe mundësitë e të mësuarit, me qëllim që të rritet kontributi që prindërit sjellin në shkollë në lidhje me nevojat e fëmijëve.
- Të zhvillohen më shumë aktivitete që kanë në fokus rritjen e pjesëmarrjes së baballarëve në shkolla me qëllim që të rrisin prezencën e tyre në aktivitetet e ndryshme të fëmijëve në shkollë.
- Fëmijët duhet të informohen, fuqizohen dhe të inkurajohen për të identifikuar në mënyrë proaktive situatat e mundshme aty ku ata janë duke e vënë veten në rrezik dhe të mendojnë për mënyra se si të shmangin situata të tilla.
- Duhet të shmanget ndëshkimi fizik dhe elementë të tjerë të dhunshëm në sjelljet që prindërit përdorin si pjesë të stilit të tyre të prindërimit. Asgjë e mirë nuk mund të vijë nga asnjë formë dhune e ushtruar, pasi dhuna gjeneron dhunë dhe është një sjellje e mësuar, për mostransmetimin e të cilës ndryshimi i modeleve prindërore luan një rol të jashtëzakonshëm.
- Angazhimi i burrave dhe djemve të cilët sjellin modele pozitive përmes sjelljeve dhe qëndrimeve të tyre kundër stereotipeve gjinore dhe roleve tradicionale, si dhe të cilët janë kundër dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore, është domosdoshmëri.
- Prindërimi i mirë, ndërtimi i marrëdhënieve të shëndosha familjare dhe zvogëlimi i dallimeve gjinore në mënyrën e rritjes dhe edukimit të fëmijëve, duhet të parashikohen si pjesë e planeve të veprimit kombëtare e vendore, së bashku me masat e tjera për adresimin e formave të ndryshme të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

V. REFERENCA

- Ashley Blakely Kimble (2009) Stilet e prindërimit dhe rikonceptimi e validimi i pyetësorit mbi dimensionet e tyre (The parenting styles and dimensions questionnaire: a reconceptualization and validation). https://www.academia.edu/30316236/The_Parenting_Styles_and_Dimensions_Questionnaire_PSDQ
- <https://www.familjadheshendeti.com/10-keshillat-pozitive-per-prinder/>
- <https://sciencing.com/slovins-formula-sampling-techniques-5475547.html>
- <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/concepts-and-definitions>
- <https://charter-equality.eu/>
- <http://femijetetiranes.al/wp-content/uploads/2019/05/Stilet-e-prinderimit-1.pdf>
- https://nccsalbania.files.wordpress.com/2017/10/manual_prinderimi-i-adoleshenteve-final_3-tetor-2017.pdf
- Creswell, j. (2003). Research design: Qualitative, quantitative, and mixed methods approaches. Thousand Oaks, CA: Sage.
- Creswell, J.W. (2008). Research design: qualitative, quantitative, and mixed methods approach. 3rd edn. London: Sage Publications.
- Hennink, M., Hutter, I., dhe Bailey, A. (2013). Qualitative Research Methods. London: Sage Publicat

VI. INSTRUMENTET KËRKIMORË

VI.a Pyetësi për prindërit

DALLIMET GJINORE NË PRINDËRIM DHE NDIKIMI I TYRE NË MARRËDHËNIEN PRIND – FËMIJË, NË SHQIPËRI

(Pyetësi për prindërit)

KODI: _____

FORMULAR MIRATIMI INDIVIDUAL

Qendra “ACT for Society” po përgatit një studim mbarëkombëtar i cili ka për qëllim të analizojë stilet e prindërimit, dallimet gjinore të lidhura me to si dhe ndikimin në marrdhëniet prind - fëmijë. Në këtë kuadër do të mblidhet informacion si nga të rejat dhe të rinjtë e grupmoshës 16-18 vjeç ashtu edhe nga prindërit e grupmoshës 20-64 vjeç, përmes instrumentave të ndryshëm kërkimorë (pyetësorë, grupe të fokusuara dhe intervista të thelluara). Informacioni me pyetësorë është menduar të mblidhet nga afërsisht 813 të reja dhe të rinj, kryesisht nxënës dhe nxënës të shkollave të mesme, si dhe nga afërsisht 1623 prindër (nëna dhe baballarë), në 12 qarqet e vendit. Ju jeni zgjedhur rastësisht për të marrë pjesë në këtë studim. Qendra “ACT for Society” ju siguron se të gjitha përgjigjet tuaja do të mbahen rreptësisht të fshehta dhe në to do të ketë akses vetëm grupi i eksperteve që do të përgatisin studimin. Emri dhe adresa juaj nuk do të shkruhen në pyetësor dhe nuk do të mbahen në ndonjë regjistër tjetër të dhënash. Informacioni do të analizohet i grupuar dhe kur rezultatet e këtij studimi të publikohen apo diskutohen në konferenca, identiteti juaj nuk do të zbulohet. Pyetësi përmban disa pjesë dhe në secilën prej tyre janë të shënuara udhëzimet për plotësimin e përgjigjeve. Nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara, ju duhet të zgjidhni atë alternativë apo përgjigje që më së miri ju përshkruan juve. Përpara plotësimit të pyetësorit duhet të lexoni me kujdes pyetjen dhe nëse keni paqartësi mund të pyesni mbikëqyrësin/mbikëqyrësen, i cili/e cila disponon të gjithë informacionin për t’ju sqaruar në lidhje me studimin dhe pyetjen që mund të keni. Disa nga pyetjet mund të jenë të vështira apo tepër personale për t’u përgjigjur, por pjesëmarrëse dhe pjesëmarrës të tjerë në të njëjtin studim e kanë vlerësuar të dobishme

bërjen e pyetjeve të tilla. Pjesëmarrja juaj është tërësisht vullnetare, por përvojat tuaja mund të jenë shumë të dobishme për prindërit e tjerë në Shqipëri. Theksojmë edhe një herë që, është e drejta juaj të vendosni nëse dëshironi apo jo të jeni pjesë e studimit. Plotësimi i pyetësorit kërkon afërsisht **20 minuta** kohë.

A keni ndonjë pyetje?

A jeni dakord të përfshiheni në studim me dëshirën dhe pëlqimin tuaj të plotë?

Mbikëqyrësi/mbikëqyrësja duhet të plotësojë një nga alternativat në vijim, në varësi të përgjigjes së personit që po ftohet të marrë pjesë në studim:

Është dakord (falenderojeni dhe jepini pyetësorin të fillojë plotësimin)

Nuk është dakord (falenderojeni dhe përfundoni takimin)

Për t'u plotësuar nga mbikëqyrësi/mbikëqyrësja:

Unë _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se ia lexova të plotë

formularin e dhënies së miratimit personit të ftuar për të marrë pjesë në studim dhe iu përgjigja të gjitha pyetjeve të saj/tij, përpara marrjes së miratimit.

Nënshkrimi _____ Data: _____

¹Vendosja e Kodit kryhet nga mbikëqyrësi/mbikëqyrësja. Kodi për pyetësorët e plotësuar përmban emrin e qarkut, inicialet e bashkisë, zonës dhe gjinisë së prindit.

Pra, nëse pyetësori po plotësohet nga një nënë në Pogradec, në një njësi administrative rurale, atëhere Kodi përkatës është: **Korçë, PG, R - N**.

Nëse pyetësori po plotësohet në Shkodër nga një baba, në një njësi administrative urbane, atëhere kodi është: **Shkodër, SH, U - B**

Seksioni 1: Të dhëna të përgjithshme demografike

Lutemi, lexoni me kujdes pyetjet dhe qarkoni alternativën që ju përshtatet më së miri. Nëse ka pyetje që kanë më shumë se një përgjigje, qarkojini të gjitha ato alternativa që ju përshtaten

1. Gjinia:

1. Mashkull
2. Femër
3. Tjetër

2. Mosha:

- 1.20- 24 vjeç
- 2.25– 29 vjeç

- 3.30- 34 vjeç
- 4.35- 39 vjeç
- 5.40 – 44 vjeç
- 6.45 – 49 vjeç
- 7.50 – 54 vjeç
- 8.55 – 59 vjeç
- 9.60 – 64 vjeç

3. Besimi fetar:

- 1.Ateist/e
- 2.Bektashi/e
- 3.Katolik/e
- 4.Mysliman/e
- 5.Ortodoks/e
- 6.Tjetër (plotëso) _____
- 7.Pa përgjigje

4. Etnia:

- 1.Bullgar/e
- 2.Boshnjak/e
- 3.Grek/e
- 4.Egjiptjan/e
- 5.Maqedonas/e
- 6.Rom/e
- 7.Shqiptar/e
- 8.Vlleh/e
- 9.Tjetër (plotëso) _____
- 10.Pa përgjigje

5. Aftësia e kufizuar:

Nëse keni ndonjë nga vështirësitë në vijim, zgjidhni alternativën e përgjigjes që ju përshtatet më mirë (shënoni me “X”)		1 . Jo	2 . Pak	3 . Shumë
5.1	A keni vështirësi të shihni, edhe nëse mbani syze?			
5.2	A keni vështirësi dëgjimi, edhe nëse përdorni një aparat dëgjimi?			
5.3	A keni vështirësi në ecje apo të ngjisni shkallët?			
5.4	A keni vështirësi për të mbajtur mend apo për t’u përqendruar?			
5.5	A keni vështirësi me kujdesin ndaj vehtes (mbajtja e higjienës, veshja)?			
5.6	A keni vështirësi në komunikim (të kuptoni ose t’ju kuptojnë të tjerët)?			

6. Cili është niveli juaj arsimor?

1. I/e pa arsimuar
2. Fillor
3. Tetë/Nëntë vjeçar
4. I mesëm
5. I lartë
6. Pas universitar (plotëso) _

7. Cili është statusi juaj aktual i punësimit? _

1. Pa punë
2. Punësuar me kohë të plotë
3. Punësuar me kohë të pjesshme
4. Vetëpunësuar
5. Me leje lindjeje (për nënat)/ me leje të kujdesit pas lindjes (për baballarët)
6. Pension
7. Tjetër (plotëso) _

8. Cila është aktualisht gjendja juaj civile? __

1. Martuar ligjërisht me një burrë
2. Martuar ligjërisht me një grua
3. Bashkëjetoj me një burrë
4. Bashkëjetoj me një grua
5. I/e divorcuar (ligjërisht)
6. I/e ndarë (veçuar por pa zgjidhur martesën në gjykatë)
7. I/e ve
8. I/e divorcuar dhe bashkëjetoj me një grua/burrë tjetër
9. Tjetër (plotëso)

9. Si do e përshkruanit statusin ekonomik të familjes suaj?

1. Familje me të ardhura të pamjaftueshme
2. Familje me të ardhura të pakëta
3. Familje me të ardhura të mjaftueshme
4. Familje me të ardhura të shumta
5. Pa përgjigje

10. Nga sa anëtarë(e) përbëhet familja juaj?

1. Dy
2. Tre

- 3.Katër
- 4.Më shumë se katër

**11. Me cilët nga personat më poshtë jetoni në të njëjtën shtëpi?
(Qarkoni më shumë se një përgjigje)**

- 1.Bashkëshortin/en
- 2.Bashkëjetuesin/en
- 3.Fëmijët biologjikë vajza (sa ____) dhe djem (sa ____)
- 4.Fëmijët e birësuar vajza (sa ____) dhe djem (sa ____)
- 5.Fëmijët e bashkëshortit(es)/bashkëjetuesit(es) vajza (sa ____) dhe djem (sa ____)
- 6.Prindërit e mi (____ Nëna ____ Babai)
- 7.Prindërit e bashkëshortit/bashkëshortes apo bashkëjetuesit/es (____ Nëna ____ Babai)
- 8.Të afërm të tjerë (specifiko lidhjen dhe numrin)_____

Seksioni 2 – Stilet e prindërimit

Në këtë pjesë të pyetësorit eksplorohen qëndrimet dhe sjelljet tuaja si prindër (biologjikë apo birësues) të fëmijëve dhe marrdhëniet që keni me ta, duke përfshirë edhe situatat kur jeni martuar apo bashkëjetoni me dikë tjetër pas ndarjes (apo humbjes së jetës) së prindit tjetër me të cilin keni sjellë në jetë apo keni birësuar fëmijët me të cilët tashmë jetoni. Po kështu, përfshihet dhe marrdhënia që ju keni me fëmijët e bashkëshortit(es) apo bashkëjetuesit(es) tuaj, nëse keni një situatë të tillë. Lutemi në tabelën në vijim të lexoni me kujdes pyetjen dhe plotësoni nën secilin rrjesht përkatës për “veten tuaj” dhe “babain apo nënën” biologjik/e apo birësues/e të fëmijës, si dhe për “bashkëshortin(en) / bashkëjetuesin(en) tuaj” (nëse jeni në një situatë të tillë), duke zgjedhur se sa shpesh e kryen apo jo secili prej jush sjelljen e përshkruar.

12	Stili i prindërimit		Gjithmonë	Shpesh	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	Nuk aplikohet
1	E inkurajoj fëmijën të flasë rreth shqetësimeve të fëmijërisë	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
2	U përgjigjem nevojave dhe shqetësimeve të fëmijës	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
3	E inkurajoj dhe i krijoj mjedis të përshtatshëm kur fëmija është i mërzitur	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
4	I jap vlerësim (p.sh. e çoj diku, i jap para) kur fëmija sillet mirë	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
5	Kaloj momente të ngrohta dhe të qeta me fëmijën	Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
		Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
1.	E sqaroj fëmijën se përse duhet t'u bindet rregullave	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						

2	E ndihmoj fëmijën të kuptojë më mirë sjelljen e tij, duke e inkurajuar të flasë rreth pasojave të veprimeve të tij	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
3	I shpjegoj fëmijës pasojat e sjelljes së tij	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
4	Theksoj cilat janë arsyet për çdo rregull që vendos	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
5	I shpjegoj fëmijës se si ndihem kur ai sillet mirë ose keq	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
1	Tregoj respekt për opinionet e fëmijës duke e inkurajuar atë të shprehë opinionet e tij	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
2	E inkurajoj fëmijën të shprehë lirisht edhe nëse nuk është dakord me mendimin e prindërve	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						

3	E lejoj fëmijën të japë kontributin e tij në vendosjen e rregullave brenda familjes	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
4	I marr në konsideratë dëshirat e fëmijës përpara sesa t'i kërkoj atij të bëjë diçka	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
5	I marr në konsideratë preferencat e fëmijës përpara sesa të bëj plane për familjen	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
1	Përdor ndëshkimin fizik si mënyrë për disiplinimin e fëmijës	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
2	I jap një shuplakë vitheve fëmijës kur nuk bindet	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
3	I jap ca shpulla të mira fëmijës kur sillet keq	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
4	E mbërthej / e shkund fëmijën kur nuk bindet	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						

1	Shpërthej me zemërim kundrejt fëmijës	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
2	Bërtas ose ulërv kur fëmija sillet keq	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
3	E kritikoj fëmijën që të përmirësohet	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
4	E kritikoj kur sjellja e fëmijës nuk është ajo që pres apo konsideroj të duhurën	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
1	E ndëshkoj fëmijën duke i hequr privilegje të caktuara pa i dhënë fare, ose duke i dhënë shumë pak shpjegime	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
2	Përdor kërcënimin si ndëshkim duke mos dhënë asnjë justifikim ose duke dhënë shumë pak justifikim	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						

3	E ndëshkoj fëmijën duke e mbyllur vetëm diku pa i dhënë asnjë shpjegim ose duke i dhënë fare pak shpjegim	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
4	Nëse fëmija kërkon shpjegim se përse duhet të bierë dakord me diçka i përgjigjem duke i thënë “Sepse kështu them unë, ose sepse unë jam prindi yt dhe dua të veprosh kështu!”	Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
		Unë						
1	Vendos (them) ndëshkime për fëmijën por nuk i zbatoj ato	Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
2	E kërcënoj fëmijën me shumë më tepër ndëshkim, sesa i jap në të vërtetë	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
3	Dorëzohem përpara fëmijës kur ai shkakton ndonjë gurgule / trazirë / rrëmuje	Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
		Unë						
4	E kam shumë të vështirë ta dispiplinoj fëmijën	Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						

5	E mësoj keq fëmijën me llastimet që i bëj	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
1	Kaloj kohë cilësore me fëmijën (i lexoj libra, luajmë, bëjmë mësimet, etj)	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
2	Flas me fëmijën tim mbi shëndetin e tij seksual dhe riprodhues	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
3	Flas me fëmijën mbi marrëdhëniet e tij intime	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
4	I jap fëmijës informacion mbi dhunën në familje dhe shoqëri si dhe format e saj	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						
5	E lejoj fëmijën të vishet sipas dëshirës	Unë						
		Babai/nëna (biologjik/e apo birësues/e) e fëmijës						
		Bashkëshorti(ja)/bashkëjetuesi(ja) im(e)						

Faleminderit që morët pjesë në studimin tonë!

VI.b Pyetësi për fëmijët

DALLIMET GJINORE NË PRINDËRIM DHE NDIKIMI I TYRE NË MARRËDHËNIEN PRIND – FËMIJË, NË SHQIPËRI

(Pyetësi për të rejtat dhe të rinjtë)

KODI² : _____

FORMULAR MIRATIMI INDIVIDUAL

Qendra “ACT for Society” po përgatit një studim mbarëkombëtar i cili ka për qëllim të analizojë stilet e prindërimit, dallimet gjinore të lidhura me to si dhe ndikimin në marrëdhëniet prind-fëmijë. Në këtë kuadër do të mblidhet informacion si nga të rejtat dhe të rinjtë e grupmoshës 15-19 vjeç ashtu edhe nga prindërit e grupmoshës 20-64 vjeç, përmes instrumentave të ndryshëm kërkimorë (pyetësorë, grupe të fokusuara dhe intervista të thelluara). Informacioni me pyetësorë është menduar të mblidhet nga afërsisht 813 të reja dhe të rinj, kryesisht nxënëse dhe nxënës të shkollave të mesme, si dhe nga afërsisht 1623 prindër (nëna dhe baballarë), në 12 qarqet e vendit. Ju jeni zgjedhur rastësisht për të marrë pjesë në këtë studim, por duhet të dini se përpara kontaktimit me ju, kemi komunikuar dhe marrë leje me shkrim nga prindërit tuaj, të cilët pohojnë se janë dakord që ju të jenë pjesë e këtij studimi, nëse edhe ju vetë jeni dakord. Qendra “ACT for Society” ju siguron se të gjitha përgjigjet tuaja do të mbahen rreptësisht të fshehta dhe në to do të ketë akses vetëm grupi i eksperteve që do të përgatisin studimin. Emri dhe adresa juaj nuk do të shkruhen në pyetësor dhe nuk do të mbahen në ndonjë regjistër tjetër të dhënash. Informacioni do të analizohet i grupuar dhe kur rezultatet e këtij studimi të publikohen apo diskutohen në konferenca, identiteti juaj nuk do të zbulohet. Pyetësorët do të ruhen në vend të sigurt për një periudhë 1 vjeçare, deri në shkurt 2021 dhe mbas kësaj periudhe do të asgjësohen. Pyetësi përmban disa pjesë dhe në secilën prej tyre janë të shënuara udhëzimet për plotësimin e përgjigjeve. Nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara, ju duhet të zgjidhni atë alternativë apo përgjigje që më së miri ju përshtatet juve. Përpara plotësimit të pyetësit duhet të lexoni me kujdes pyetjen dhe nëse keni paqartësi mund të pyesni mbikëqyrësin/mbikëqyrësen, i cili/e cila disponon të gjithë informacionin për t’ju sqaruar në lidhje me studimin dhe pyetjen që mund të keni. Disa nga pyetjet mund të jenë të vështira apo tepër personale për t’u përgjigjur,

por pjesëmarrëse dhe pjesëmarrës të tjerë në të njëjtin studim e kanë vlerësuar të dobishme bërjen e pyetjeve të tilla. Pjesëmarrja juaj është tërësisht vullnetare, por përvojat tuaja mund të jenë shumë të dobishme për të tjera/tjerë të reja e të rinj në Shqipëri. Theksojmë edhe një herë që, pavarësisht se prindërit tuaj e kanë dhënë pëlqimin dhe lejen që ju të përfshiheni, është e drejta juaj të vendosni nëse dëshironi apo jo të jeni pjesë e studimit. Plotësimi i pyetësorit kërkon afërsisht **20 minuta** kohë. A keni ndonjë pyetje?

A jeni dakord të përfshiheni në studim me dëshirën dhe pëlqimin tuaj të plotë?

Mbikëqyrësi/Mbikëqyrësja duhet të plotësojë një nga alternativat në vijim, në varësi të përgjigjes së personit që po ftohet të marrë pjesë në studim:

☐ Është dakord (falenderojeni dhe jepini pyetësorin të fillojë plotësimin)

☐ Nuk është dakord (falenderojeni dhe përfundoni takimin)

Për t'u plotësuar nga mbikëqyrësi/mbikëqyrësja:

Unë _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se ia lexova të plotë formularin e dhënies së miratimit personit të ftuar për të marrë pjesë në studim dhe iu përgjigja të gjitha pyetjeve të saj/tij, përpara marrjes së miratimit.

Nënshkrimi _____ Data: _____

²Vendosja e Kodit kryhet nga mbikëqyrësi/mbikëqyrësja. Kodi për pyetësorët e plotësuar përmban emrin e qarkut, inicialet e bashkisë, zonës dhe gjinisë së fëmijës

Pra, nëse pyetësori po plotësohet nga një vajzë në Pogradec, në një njësi administrative rurale, atëhere Kodi përkatës është: **Korçë, PG, R - V**

Nëse pyetësori po plotësohet në Shkodër nga një djalë, në një njësi administrative urbane, atëhere kodi është: **Shkodër, SH, U - D**

Seksioni 1: Të dhëna të përgjithshme demografike

Lutemi, lexoni me kujdes pyetjet dhe qarkoni alternativën që ju përshtatet më së miri. Nëse ka pyetje që kanë më shumë se një përgjigje, qarkojini të gjitha ato alternativa që ju përshtaten

1.Gjinia:

1.Mashkull

2.Femër

3.Tjetër

2.Mosha:

- 1.15 vjeç
- 2.16 vjeç
- 3.17 vjeç
- 4.18 vjeç
- 5.19 vjeç

3.Si do e përshkruanit statusin ekonomik të familjes suaj?

- 1.Familje me të ardhura të pamjaftueshme
- 2.Familje me të ardhura të pakëta
- 3.Familje me të ardhura të mjaftueshme
- 4.Familje me të ardhura të shumta
- 5.Pa përgjigje

4.Nga sa anëtarë(e) përbëhet familja juaj?

- 1.Dy
- 2.Tre
- 3.Katër
- 4.Më shumë se katër

5.Me cilët nga personat më poshtë jetoni në të njëjtën shtëpi? (Qarkoni më shumë se një përgjigje)

- 1.Nëna
- 2.Babai
- 3.Motra (sa ____)
- 4.Vëllai (sa ____)
- 5.Gjyshja
- 6.Gjyshi
- 7.Të afërm të tjerë (specifiko lidhjen dhe numrin)_____
- 8.Bashkëshorti/bashkëjetuesi i nënës
- 9.Bashkëshortja/bashkëjetuesja e babait

6.Cili është statusi i marrdhënies së prindërve tuaj biologjikë?

- 1.Të martuar
- 2.Bashkëjetojnë
- 3.Të divorcuar
- 4.Nëna e ve

5. Babai i ve
6. Nuk e di, jetoj me prindërit adoptues

7. Nëna juaj (biologjike apo adoptuese) është/ka qenë e punësuar pjesën më të madhe të kohës që nga lindja juaj?

1. Jo
2. Po, me kohë të plotë
3. Po, me kohë të pjesshme
4. Nuk kam përgjigje (kam jetuar me babain/dikë tjetër)

8. Babai juaj (biologjik apo adoptues) është/ka qenë i punësuar pjesën më të madhe të kohës që nga lindja juaj?

1. Jo
2. Po, me kohë të plotë
3. Po, me kohë të pjesshme
4. Nuk kam përgjigje (kam jetuar me nënën/dikë tjetër)

Seksioni 2 - Pyetje rreth marrdhënieve me prindërit

Në këtë pjesë të pyetësorit eksplorothen marrdhëniet dhe ndjesitë tuaja rreth prindërve (biologjikë apo adoptues). Lutemi të plotësoni për secilën nga pyetjet në vijim alternativën e përgjigjes që është më e përshtatshme për ju, duke shënuar me “X” në kolonën përkatëse.

9	Marrdhënia me prindërit	1. Të dy prindërit	2. Nëna	3. Babai	4. Asnjë prej tyre
9.1	Me cilin prind kaloni më shumë kohë?				
9.2	Me cilin prind jeni ndjerë më afër gjatë rritjes suaj?				
9.3	Cili nga prindërit është përkujdesur më shumë gjatë rritjes suaj (për t’ju ushqyer, çuar në shkollë, bërë mësimet, etj)				
9.4	Cili nga prindërit ju ka ndëshkuar (apo ju ndëshkon) më së shumti?				
9.5	Me cilin nga prindërit keni luajtur më shumë në fëmijëri?				
9.6	Cili nga prindërit ka kaluar më shumë kohë cilësore me ju (ju ka lexuar, treguar përralla, keni biseduar, shëtitur...etj)				
9.7	Me cilin nga prindërit ndjeheni më të afërt sot për të diskutuar mbi shqetësimet tuaja personale?				

9.8	Cili nga prindërit ju ka folur në fëmijëri për trupin tuaj dhe zhvillimin tuaj biologjik?				
9.9	Me cilin nga prindërit diskutoni më shumë sot mbi shëndetin tuaj seksual dhe riprodhues?				
9.10	Me cilin nga prindërit komunikoni më shumë sot?				
9.11	Me cilin nga prindërit mendoni se keni më shumë cilësi të përbashkëta?				
9.12	Me cilin nga prindërit dëshironi të kaloni më shumë kohë sot?				
9.13	Cili nga prindërit ju godet (me shuplakë, grusht, sende të forta, etj)?				
9.14	Cili nga prindërit ju jep informacion mbi dhunën që mund të ndodhë në familje apo shoqëri dhe format e saj?				

10. Si mund t'i përshkruani marrëdhëniet tuaja me bashkëjetuesin(en) apo bashkëshortin(en) e nënës apo të babait tuaj (përgjigjuni vetëm nëse prindërit tuaj janë të divorcuar apo nëse njëri prej tyre ka ndërruar jetë dhe prindi tjetër është martuar apo bashkëjeton, pra vetëm nëse aplikohet për ju ose lereni bosh)

- 1.Shumë të mira
- 2.Normale
- 3.Të ftohta
- 4.Nuk komunikoj/nuk i takoj fare

11.A diskutoni për shqetësimet tuaja personale me bashkëjetuesin (en) apo bashkëshortin(en) e nënës apo të babait tuaj? (përgjigjuni vetëm nëse aplikohet për ju ose lereni bosh)

